



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:054354

Datë: 27.10.2023

Numri i dokumentit: 05661137

PS.nr.23/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Mentor Bajraktari – kryetar i trupit gjykues, Musa Konxheli dhe Kujtim Krasniqi – anëtar të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Nazif Fetahu, në lëndën penale ndaj të akuzuarve: **Z S, B N, M M, A M, dhe A H**, për shkak të veprave penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.3 e lidhur me nenet 31 dhe 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹ dhe Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, ndaj të akuzuarve: **O K, R M, D S, D K, J D, Z B dhe A P** për shkak të veprave penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, ndaj të akuzuarve: **Z R, R K, V T, B T, L V, B M, B L**, për shkak të veprave penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarit **N B**, për shkak të veprave penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në vazhdimësi nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës², me numër PPS.nr.32/18, të datës 08.05.2020, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të shtetit nga PSRK, të akuzuarve si dhe mbrojtësve të tyre avokatëve: Ahmet Gjinovci nga Prishtina, Dobrica Lazic nga Graçanica, Albana Kelmendi, Naim Rudari që dy nga Prishtina, Nebojsa Vlajic nga Mitrovica, Jovana Filipovic nga Graçanica, Arlinda Avdimetaj – Fejzullahu nga Prishtina, Ljubomir Pantovic, Milos Delevic që të dy nga Mitrovica, Asdren Hoxha Prishtina, Zehra Verbovci, Vehbi Beqiri që të dy nga Mitrovica, Zhivojin Jukanoviq, Isa Salihi, Mimoza Zabeli Sinani, Ali Rexha që të gjithë nga Prishtina, Srdjan Mitrovic nga Mitrovica, Fatlume Korqa Sekiraqa nga Prishtina, Predrag Miljkovic, Musa Damati që të dy nga Mitrovica, **me datë 27.10.2023** mori dhe publikisht shpalli këtë:

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK-së), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

² Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, (Në tekstin e mëtejme PSRK-së)

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

1. Z S, nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në fshatin ..., Komuna e Zubin Potokut, tani me vendbanim në fshatin ... Komuna e Leposavicit, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer fakultetin, i gjendjes së mesme ekonomike, ..., serb – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datën 04.10.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 05.10.2019 deri me datën 04.12.2019.

2. B N, me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., e lindur më datën ... në Mitrovicë, me banim në fshatin Ibarska Sllatinë, Komuna e Leposavicit, e shkurorëzuar, ka kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtare e Policisë së Kosovës, serbe – shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 12.08.2020.

3. A H, me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën në Mitrovicë, ku edhe banon në Lagjen e Boshnjakëve, në rrugën "...", p.n, i martuar, baba ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, boshnjak – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri më datën 20.08.2020.

4. A M, nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në ..., ku edhe tani banon në rrugën "...", p.n, i martuar, baba i ... fëmijëve, ka kryer fakultetin juridik, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datën 26.06.2020 dhe në arrest shtëpiak nga data 27.06.2020 deri me datën 25.08.2020.

5. M M, nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në fshatin ..., Komuna e Leposaviqit, tani me vendbanim në Mitrovicën e Veriut, nën rrugën "...", nr. ose "...", nr...., i martuar babë i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, serb – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datën 20.08.2020.

6. O K, nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në ... të Republikës së Kroacisë, tani me vendbanim në Mitrovicën e Veriut, në rrugën "...", ose "...", i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, pjesëtar i Policisë së Kosovës, serb – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 20.08.2020.

7. R M, me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në Mitrovicë, ku edhe tani banon në Lagjen e Boshnjakëve, në rrugën "...", nr.. ose "...", nr..., i martuar, babë i pesë (5) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendje së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, boshnjak – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ..., ka qenë në

paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 15.10.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 16.10.2019 deri me datë 30.12.2019.

8. D S, me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ... e gjinisë ... i lindur më ... në Mitrovicë, me vendbanim në fshatin Rudar i Madh, rruga “...” pa.nr., Komuna Zveçan, i martuar, babë i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, serb - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 05.11.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 06.11.2019 deri me datën 05.01.2019.

9. D K, me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ... e gjinisë ..., i lindur më ... në Zubin Potok, ku edhe tani banon në rrugën “...”, i martuar, baba i një (1) fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, serb - shtetas i Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, me numër personal: ..., ka qenë në paraburgim nga data 30.05.2019 deri me datë 12.08.2020.

10. J D, nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., e lindur më datën ... në Mitrovicë, tani me vendbanim në fshatin ...– Ibarska Slatina, Komuna Leposavic, e martuar, nënë e dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtare e Policisë së Kosovës, serbe - shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal: ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 25.06.2020 dhe në arrest shtëpiak nga data 26.06.2020 deri me datë 25.08.2020.

11. Z. B., me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më në Mitrovicë, ku edhe tani banon, në rrugën “...” nr.13, i martuar, baba i katër (4) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtare e Policisë së Kosovës, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., pjesëtar i Policisë së Kosovës, ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 10.10.2019 dhe arrest shtëpiak nga data 11.10.2019 deri me datë 10.12.2019.

12. A P, nga i ati ... e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në Mitrovicë, ku edhe tani banon lagjen “...”, rruga “...” hyrja A ..., i martuar, baba i një (1) fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 25.06.2020 dhe në arrest shtëpiak nga data 26.06.2020 deri me datë 25.08.2020.

13. Z R, me nofkën ..., nga i ati ..., dhe e ëma .., e gjinisë ..., i lindur më datën në fshatin Kajkovë, Komuna e Leposaviq, ku edhe tani banon, i martuar, ka të kryer Fakultetin për Menaxhement, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, serb – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ..., ka qenë në paraburgim nga data 24.10.2019 deri me datë 12.08.2020

14. R K, me nofkën ..., nga i ati R., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në Mitrovicë, ku edhe tani banon në lagjen e Boshnjakëve” p.n, beqar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, boshnjak – shtetas i Republikës së

Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 11.10.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 12.10.2019 deri me datë 11.08.2020.

15. V T, me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në Istog, me banim në fshatin Suhogërllë, Komuna e Skenderajt, i martuar, babë i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, serb – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 30.05.2019 deri me datë 25.06.2020 dhe në arrest shtëpiak nga data 26.06.2020 deri me datë 25.08.2020.

16. B T, nga i ati ... dhe e ëma ... e gjinisë ..., e lindur me datën në fshatin ..., komuna e Zubin Potokut, ku edhe tani banon, e martuar, nënë e dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtare e Policisë së Kosovës, serbe – shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 29.05.2019 deri me datë 25.06.2020 dhe në arrest shtëpiak nga data 26.06.2020 deri me datë 25.08.2020.

17. L V, nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur me datën në Mitrovicë, tani me vendbanim në Mitrovicën e Veriut, në rrugën "...", nr.92, i ve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, pjesëtar i PK-së, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ..., ka qenë në paraburgim nga data 24.10.2019 deri me datë. 20.08.2020.

18. B M, me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më ... në fshatin Dobërllukë, komuna e Vushtrrisë ku edhe tani banon, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, pjesëtar i Policisë së Kosovës, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 18.10.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 19.10.2019 deri me datë 18.12.2019.

19. B L, me nofkën ..., nga i ati ..., e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më datën ... në Rashkë, Republika e Serbisë, tani me vendbanim në komunën e Leposavicit, në rruëgën "...", ..., i martuar, babë i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, serb – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ... ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 20.08.2020.

20. N G, nga i ati ..., dhe e ëma ..., e gjinisë ..., i lindur më ... në Prizren, tani me banim në Mitrovicën e Veriut në rrugën "...", ..., i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë, i gjendje të mesme ekonomike, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, serb – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., ka qenë në paraburgim nga data 24.10.2019 deri me datë 08.07.2020.

A. PJESA GJYKUESE

I.

Të akuzuarit:

- 1. Z S;**
- 2. B N;**

3. M M;
4. A M;
5. A H:

JANË FAJTOR

Sepse që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, të akuzuarit në bashkëkryerje edhe me të pandehurin D V i cili gjendet në arrati, në cilësinë e personave zyrtar si zyrtar policor, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje kanë keqpërdorur detyrat zyrtare, nuk i kanë kryer detyrat e përcaktuar me ligj dhe nuk i kanë përmbushur autorizime e tyre zyrtare, me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, në atë mënyrë që i akuzuari Z S në cilësinë e Komandantit të Stacionit, e akuzuara B N në cilësinë e udhëheqëses së ndërrimit dhe të akuzuarit M M, A M, dhe A H, në cilësinë e policëve patrullues, në kuadër të ndërrimit "A" të SPMK në Zubin Potok, kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare dhe autorizimet ashtu që derisa kanë qenë në detyrë zyrtare dhe ishin përgjegjëse për të mbikëqyrë rrugët e brezit kufitar, kanë bashkëpunuar me të pandehurve D I, B R D D , M R, M R, Z V dhe persona të tjerë kontrabandues si transportues të mallrave duke ju lejuar dhe mundësuar kontrabandimin e mallrave të ndryshëm si kafshë, derivate, pije alkoolike dhe joalkoolike, dhe mallra ushqimor nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, nëpërmjet rrugëve ilegale, ashtu që ju kanë mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm pasi që të njëjtit i'u kanë shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, ku për kalimin e automjeteve me mallra kanë pranuar – marrë shuma të ndryshme të parave nga kontrabanduesit për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, sipas tarifave të vet përcaktuara nga 20 Euro për vetura të vogla, 30 – 60 Euro për furgona dhe 100 – 150 Euro për çdo kamion, me ç'rast kanë përfituar për vete, ju mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm kontrabanduesve dhe kanë shkaktuar edhe dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovës.

Me këto veprime në kanë kryer veprën penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2, nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së³.

II.

Të akuzuarit:

1. R M;
2. J D;
3. Z B;
4. A P.

JANË FAJTOR

³ Sipas pikës I.të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

Sepse që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, të akuzuarit në bashkëkryerje, në cilësinë e personave zyrtar si zyrtar policor, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje kanë keqpërdorur detyrat zyrtare, nuk i kanë kryer detyrat e përcaktuar me ligj dhe nuk i kanë përmbushur autorizime e tyre zyrtare, me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, në atë mënyrë që i akuzuari R M, J D, Z B, A P, në cilësinë e policëve patrullues në kuadër të ndrrimit "B", të SPMK në Zubin Potok, kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare dhe autorizimet ashtu që derisa kanë qenë në detyrë zyrtare dhe ishin përgjegjëse për të mbikëqyrë rrugët e brezit kufitar, kanë bashkëpunuar me të pandehurve D I, B R, D D , M R, M R, Z V dhe persona të tjerë kontrabandues si transportues të mallrave duke ju lejuar dhe mundësuar kontrabandimin e mallrave të ndryshëm si kafshë, derivate, pije alkoolike dhe joalkoolike, dhe mallra ushqimor nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, nëpërmjet rrugëve ilegale, ashtu që ju kanë mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm pasi që të njëjtit i'u kanë shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, ku për kalimin e automjeteve me mallra kanë pranuar – marrë shuma të ndryshme të parave nga kontrabanduesit për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, sipas tarifave të vet përcaktuara nga 20 Euro për vetura të vogla, 30 – 60 Euro për furgona dhe 100 – 150 Euro për çdo kamion, me ç'rast kanë përfituar për vete, ju mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm kontrabanduesve dhe kanë shkaktuar edhe dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovës.

Me këto veprime në kanë kryer veprën penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2, nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së⁴.

III.

Të akuzuarit:

- 1. R K;**
- 2. V T;**
- 3. B M;**
- 4. B L.**

JANË FAJTOR

Sepse që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, të akuzuarit në bashkëkryerje, në cilësinë e personave zyrtar si zyrtar policor, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje kanë keqpërdorur detyrat zyrtare, nuk i kanë kryer detyrat e përcaktuar me ligj dhe nuk i kanë përmbushur autorizime e tyre zyrtare, me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, në atë mënyrë që i akuzuari R K, V T, B M, B L, në cilësinë e policëve patrullues në kuadër të ndërrimit "C", të SPMK në Zubin Potok, kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare dhe autorizimet ashtu që derisa kanë qenë në detyrë zyrtare dhe ishin përgjegjëse për të mbikëqyrë rrugët e brezit kufitar, kanë bashkëpunuar me të pandehurve D I, B R, D D , M R, M R, Z V dhe persona të tjerë kontrabandues si transportues të

⁴ Sipas pikës III. të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

mallrave duke ju lejuar dhe mundësuar kontrabandimin e mallrave të ndryshëm si kafshë, derivate, pije alkoolike dhe joalkoolike, dhe mallra ushqimor nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, nëpërmjet rrugëve ilegale, ashtu që ju kanë mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm pasi që të njëjtit i'u kanë shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, ku për kalimin e automjeteve me mallra kanë pranuar – marrë shumën të ndryshme të parave nga kontrabanduesit për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, sipas tarifave të vet përcaktuara nga 20 Euro për vetura të vogla, 30 – 60 Euro për furgona dhe 100 – 150 Euro për çdo kamion, me ç'rast kanë përfituar për vete, ju mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm kontrabanduesve dhe kanë shkaktuar edhe dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovës.

Me këto veprime në kanë kryer veprën penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2, nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së⁵.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 6, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 45, 62 par.1 dhe 2 nënpar.2.3, 65 par.1, 73, 74, 83 si dhe nenit 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale⁶, të akuzuarit i:

G J Y K O N

• **Për pikën I.të dispozitivit të aktgjykimit:**

- 1. Të akuzuarin Z S, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tre (3) vite, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datën 04.10.2019 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 05.10.2019 deri me datën 04.12.2019.**
- 2. Të akuzuarën B N, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vite e tre (3) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 12.08.2020.**
- 3. Të akuzuarin M M, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vit e dhjetë (10) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datën 20.08.2020.**
- 4. Të akuzuarin A M, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vite, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datën 26.06.2020 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 27.06.2020 deri me datën 25.08.2020.**

⁵ Për pikën V të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

⁶Kodi i Procedurës Penal (Në tekstin e mëtejshëm KPP-së), nr.08/L-032, i datës 14.07.2022, i cili ka hyrë në fuqi më 18.02.2023.

5. **Të akuzuarin A H, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vite**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga në paraburgim nga data 28.05.2019 deri më datën 20.08.2020.

• **Për pikën II.të dispozitivit të aktgjykimit:**

1. **Të akuzuarin R M, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vite**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 15.10.2019 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 16.10.2019 deri me datë 30.12.2019.
2. **Të akuzuarën J D, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vit e dhjetë (10) muaj**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 25.06.2020 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 26.06.2020 deri me datë 25.08.2020.
3. **Të akuzuarin Z B, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vit e tetë (8) muaj**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 10.10.2019 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 11.10.2019 deri me datë 10.12.2019.
4. **Të akuzuarin A P, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vit e tetë (8) muaj**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 25.06.2020 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 26.06.2020 deri me datë 25.08.2020.

• **Për pikën III.të dispozitivit të aktgjykimit:**

1. **Të akuzuarin R K, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vite**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 11.10.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 12.10.2019 deri me datë 11.08.2020.
2. **Të akuzuarin V T, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 30.05.2019 deri me datë 25.06.2020 dhe në arrest shtëpiak nga data 26.06.2020 deri me datë 25.08.2020.
3. **Të akuzuarin B M, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim ka qenë në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 18.10.2019 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 19.10.2019 deri me datë 18.12.2019.

4. **Të akuzuarin B L, ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj**, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2019 deri me datë 20.08.2020.

Të akuzuarve iu shqiptohet;

D Ë N I M I P L O T Ë S U E S E S

Ashtu që të akuzuarve: Z S, B N, M M, A M, A H, R M, J D, Z B, A P, R K, V T, B M, B L, **I U N D A L O H E T U S H T R I M I I F U N K S I O N E V E N Ë A D M I N I S T R A T Ë N P U B L I K E O S E N Ë S H È R B I M I N P U B L I K**, secilit veç e veç në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, pas mbajtjes së dënimeve me burgim të shqiptuar sipas këtij aktgjykimi.

DETYROHEN të akuzuarit e lartpërmendur që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumën prej pesëqind (200) Euro, si dhe në emër të programin për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej njëqind (100) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

B. PJESA LIRUESE

IV.

Të akuzuarit:

- 1. O K;**
- 2. D S;**
- 3. D K.**

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së;

L I R O H E N N G A A K U Z A

Që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, të pandehurit në bashkëkryerje, në cilësinë e personave i zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje nuk kanë kryer detyrat të përcaktuar me ligj dhe nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare të tyre me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër në atë mënyrë që i pandehuri O K në cilësinë e udhëheqësit të ndërrimit, dhe të akuzuarit R M, D S, D K, J D, Z B, B M, A P, në cilësinë e policëve patrollues në kuadër të ndërrimit "B", të SPMK në Zubin Potok, kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare dhe autorizimet duke lejuar dhe mundësuar kontrabandimin e mallrave të ndryshëm si kafshë, derivate, pije alkoolike dhe joalkoolike dhe mallra ushqimor nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, nëpërmjet rrugëve ilegale derisa kanë qenë në detyrë zyrtare duke mbikëqyrë rrugët e brezit kufitar, ashtu që ju kanë mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm të pandehurve D I, B R, D D, M R, M R, Z V dhe persona të tjerë si transportues të mallrave, duke i'u shmangur kontrollit doganor

dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, me ç'rast i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovë.

Këso dore kishin për të kryer veprën penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2, nënpar.2.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së⁷.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

V.

Të akuzuarit:

1. Z R;
2. B T;
3. L V;

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së;

L I R O H E N N G A A K U Z A

Që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, të pandehurit në bashkëkryerje, në cilësinë e personave i zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje nuk kanë kryer detyrat të përcaktuara me ligj dhe nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare të tyre me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër në atë mënyrë që i pandehuri Z R në cilësinë e udhëheqësit të ndërrimit, dhe të pandehurit K S, R K, V T, B T, L V, B M, B L, në cilësinë e policëve patrullues në kuadër të ndërrimit "C", të stacionit të SPMK, kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare dhe autorizimet duke lejuar dhe mundësuar kontrabandimin e mallrave të ndryshëm si kafshë, derivate, pije alkoolike dhe joalkoolike dhe mallra ushqimorë nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, nëpërmjet rrugëve ilegale derisa kanë qenë në detyrë zyrtare duke mbikëqyrë rrugët e brezit kufitar, ashtu që ju kanë mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm të pandehurve D I, B R, D D, M R, M R, Z V dhe persona të tjerë si transportues të mallrave duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, me ç'rast i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovë.

Këso dore kishin për të kryer veprën penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2, nënpar.2.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së⁸.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

⁷ Sipas pikës III të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

⁸ Sipas pikës V të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

C. PJESA REFUZUSE

VI.

Ndaj të akuzuarve;

- 1. Z S;**
- 2. B N;**
- 3. M M;**
- 4. A M;**
- 5. A H.**

Në kuptim të nenit 362 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së;

REFUZOHET AKUZA

Që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, të pandehurit në bashkëkryerje në cilësinë e personave zyrtar me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, kanë marrë – pranuar para, në atë mënyrë që ata si persona zyrtar të veprojnë ose të mos veprojnë, në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, ashtu që nga të pandehurit D I, B R, D D , M R, M R, Z V dhe personave të tjerë si transportues të mallrave, për kalimin e automjeteve me mallra duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, kanë pranuar – marrë shuma të ndryshme të parave për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, dhe atë për çdo automjet nga 20 € deri në 100€ apo 150 €, e që një pjesë e këtyre parave e kanë marrë për vete, ndërsa pjesa tjetër është ndarë tek policët e ndërrimit, e që këtë shumë të parave e kanë marrë direkt nga ana e kontrabanduesve apo edhe në vende të caktuar, me ç'rast kanë përfituar shuma të konsiderueshme të parave dhe i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovë.

Këso dore kishin për të kryer veprën penale: Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së⁹.

- Për shkak të tërheqjes se prokurorit të shtetit të PSRK-së nga pika II e akuzës në shqyrtimin gjyqësor.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

VII.

Ndaj të akuzuarve:

- 1. O K;**
- 2. R M;**
- 3. D S;**

⁹Sipas pikës II të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

4. D K;
5. J D;
6. Z B;
7. A P.

Në kuptim të nenit 362 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së;

REFUZOHET AKUZA

Që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, të pandehurit në bashkëkryerje në cilësinë e personave zyrtar me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, kanë marrë – pranuar para, në atë mënyrë që ata si persona zyrtar të veprojnë ose të mos veprojnë, në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, ashtu që nga të pandehurit D I, B R, D D , M R, **M R**, Z V dhe personave të tjerë si transportues të mallrave, për kalimin e automjeteve me mallra duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, kanë pranuar – marrë shuma të ndryshme të parave për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, dhe atë për çdo automjet nga 20 € deri në 100€ apo 150 €, e që një pjesë e këtyre parave e kanë marrë për vete, ndërsa pjesa tjetër është ndarë tek policët e ndërrimit, e që këtë shumë të parave e kanë marrë direkt nga ana e kontrabanduesve apo edhe në vende të caktuar, me ç'rast kanë përfituar shuma të konsiderueshme të parave dhe i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovë.

Këso dore kishin për të kryer veprën penale: Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së¹⁰.

- Për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit të PSRK-së nga pika IV e akuzës në shqyrtimin gjyqësor.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

VIII.

Ndaj të akuzuarve:

1. Z R;
2. R K;
3. V T;
4. B T;
5. L V;
6. B M
7. B L.

¹⁰ Sipas pikës IV të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

Në kuptim të nenit 362 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së;

REFUZOHET AKUZA

Që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, të pandehurit në bashkëkryerje në cilësinë e personave zyrtar me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, kanë marrë – pranuar para, në atë mënyrë që ata si persona zyrtar të veprojnë ose të mos veprojnë, në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, ashtu që nga të pandehurit D I, B R D D , M R, M R, Z V dhe personave të tjerë si transportues të mallrave, për kalimin e automjeteve me mallra duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, kanë pranuar – marrë shuma të ndryshme të parave për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, dhe atë për çdo automjet nga 20 € deri në 100€ apo 150 €, e që një pjesë e këtyre parave e kanë marrë për vete, ndërsa pjesa tjetër është ndarë tek policët e ndërrimit, e që këtë shumë të parave e kanë marrë direkt nga ana e kontrabanduesve apo edhe në vende të caktuar, me ç'rast kanë përfituar shuma të konsiderueshme të parave dhe i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovës.

Këso dore kishin për të kryer veprën penale: Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së¹¹.

- Për shkak të tërheqjes se prokurorit të shtetit të PSRK-së nga pika VI e akuzës në shqyrtimin gjyqësor.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

IX.

Ndaj të akuzuarit N B

Në kuptim të nenit 362 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

Që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, i pandehuri, në cilësinë e personit zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje nuk ka kryer detyrat e përcaktuar me ligj dhe nuk e ka përmbushë detyrën zyrtare të tij me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër në atë mënyrë që i pandehuri N B në cilësinë e udhëheqësit të ndërrimit, në kuadër të ndërrimit "D", të stacionit të SPMK në Zubin Potok, ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare dhe autorizimet duke lejuar dhe mundësuar kontrabandimin e mallrave të ndryshëm si kafshë, derivate, pije alkoolike dhe joalkoolike dhe mallra ushqimor nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, nëpërmjet rrugëve ilegale derisa ka qenë në detyrë zyrtare duke mbikëqyrë rrugët e brezit kufitar, ashtu që ju ka mundësuar përfitim pasuror të

¹¹ Sipas pikës VI të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

kundërligjshëm të pandehurve D I, B R D D , M R, M R, Z V dhe persona të tjerë si transportues të mallrave duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, me ç'rast i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovë.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2, nënpar.2.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së¹².

- Për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit të PSRK-së nga pika VII e akuzës në shqyrtimin gjyqësor.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

X.

Ndaj të akuzuarit N B;

Në kuptim të nenit 362 par.1, nënpar.1.1 të KPP-së;

REFUZOHETAKUZA

Që nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, në vazhdimësi, i pandehuri në cilësinë e personit zyrtar me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ka marrë – pranuar para, në atë mënyrë që ai si person zyrtar të veprojë ose të mos veprojë, në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, ashtu që nga të pandehurit D I, B R D D , M R, M R, Z V dhe personave të tjerë si transportues të mallrave, për kalimin e automjeteve me mallra duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, ka pranuar – marrë shuma të ndryshme të parave për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tij zyrtare, dhe atë për çdo automjet nga 20 € deri në 100€ apo 150 €, e që këtë shumë të parave e ka marrë direkt nga ana e kontrabanduesve apo edhe në vende të caktuar, me ç'rast ka përfituar shuma të konsiderueshme të parave dhe i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovë.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale: Marrja e Ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur 81 të KPRK-së¹³.

- Për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit të PSRK-së nga pika VII e akuzës në shqyrtimin gjyqësor.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

¹² Sipas pikës VII të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

¹³ Sipas pikës VIII të aktakuzës së PSRK-së, me numër PPS.nr.32/18, të datës 18.05.2020.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj gjykate me datën 18.05.2020 ka ngritur aktakuzën me numër PPS.nr.32/2018, të datës 18.05.2020, ndaj të akuzuarve Z S, B N, M M, A M, dhe A H, për shkak të veprave penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.3 e lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, ndaj të akuzuarve: O K, R M, D S, D K, J D, Z B, B M dhe A P për shkak të veprave penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, ndaj të akuzuarve: Z R, K S R K, V T, B T, L V, B M, B L, për shkak të veprave penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarit N B, për shkak të veprave penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfetit në vazhdimësi nga neni 428 par.2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarve I J, A I, F I, B U, N J, Xh J, M J, N B, B M, J M dhe S I, për shkak të veprës penale: Kontrabandë me mallra në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 317 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së, ndërsa për të akuzuarit N J, F I dhe K S edhe për shkak të veprës penale: mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Pas ngritjes së aktakuzës është caktuar dhe mbajtur shqyrtimi fillestar, më datën 16.06.2020 në Departamentin e Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilën seancë të akuzuarit nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë ngarkuar me aktakuzë, ndërsa të akuzuarit K S dhe Nt J kanë pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, me ç'rast gjykata të akuzuarit të cilët nuk kanë pranuar fajësinë dhe mbrojtësit e tyre i ka udhëzuar se jo më shumë se tridhjetë (30) ditë, ata duhet të parashtrajnë kundërshtimet përkitazi me pranueshmerinë e provave në mbështetje të nenit 249 par.1 të KPP-së dhe kërkesat për hedhjen e aktakuzës në rast se ekzistojnë arsyet nga neni 250 par.1 të KPP-së.

Mbrojtësit e të akuzuarve brenda afatit ligjor kanë paraqitur kundërshtimet ndaj provave dhe kërkesat për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, ka nxjerr aktvendimin PS.nr.20/2020, i datës 20.08.2020, lidhur me kundërshtimin e provave dhe kërkesat për hudhje të aktakuzës në harmoni me nenin 249 dhe 250 të KPP-së, në çështjen penale ndaj të akuzuarve të lartcekur, me

të cilin ka aprovuar pjesërisht kundërshtimet ndaj provave të ushtruara nga mbrojtësit e të akuzuarve: Z S, av.Ahmet Gjinovci, O K, av.Jovana Filipoviq, B N, av. Dobrica Laziq, D K, av.Agim Lushta, J M, av.Durim Osmani, N B, av.Sylejman Klinaku, N J, av.Ali Beka, S I, av.Arlind Jupolli, Xh J, av.Betim Shala, B U, av.Valdet Kadriu, B M, av.Halil Palaj dhe F I, av.Alban Makolli – Provat e theksuara në aktakuzë si raportet e përgjimeve - transkriptet e bisedave të urdhëruara nga gjykata si dhe do prove tjetër e siguruar përmes aplikimit të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit deri me datë 06.05.2019 në raport me të pandehurin: Z S, Z R, O K, B N, D K, B U, A I, F I, N J, N B, , XH V, S I dhe J M, shpallen prova të papranueshme dhe përjashtohen nga shkresat e lendes. Dhe atë: Provat e nxjerra nga Urdhëresa PPRKR.nr.282/18, e datës 15.02.2019, si dhe Urdhëresa PPRKR.nr.282/18, e datës 16.04.2019, të lëshuara nga Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Renda, në lidhje me Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit të cekura si në këto urdhëresa: Vëzhgimi i fshehte fotografik ose me video, Monitorimi i fshehte i bisedave, Hetimi i fshehtë, Shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, Blerje e simuluar dhe Simulim i veprës së korrupsionit, në raport me të akuzuarit Z S, Z R. O K, B N dhe D K, që nga data 15.02.2019 deri me date 06.05.2019, konform nenit 249 par. 1 pika 1.1 të KPPK-se, shpallen prova të papranueshme dhe përjashtohen nga shkresat e lendes. Provat e nxjerra nga Urdhëresa PPRKR.nr.282/18 e datës 21.01.2019 dhe PPRKR.nr.282/18 të datës 15.02.2019, në lidhje me Masën e fshehte teknike të vëzhgimit dhe hetimit: Përgjimi i telekomunikimeve, në raport me të pandehurin B U, A I, F I, N J, N B, B M, XH V, S I dhe J M, që nga data 21.01.2019 deri me date 06.05.2019, shpallen prova të papranueshme dhe përjashtohen nga shkresat e lendes, konform nenit 249 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së. Pretendimet e tjera të mbrojtësve në raport me kundërshtimin e provave janë refuzuar si të pabazuara. II. Konform nenit 250 par.3 të KPPK-së: refuzohen si të pabazuara kërkesat për hudhje të aktakuzës të ushtruara nga mbrojtësit e të pandehurve: av.Ahmet Ginovci, av.Dobrica Laziq, av.Zeqir Maxhuni, av.Naim Rudari, av.Nebojsa Vlajiq, av.Jovana Filipoviq, av.Adelina Hoxha-Shabani, av. Ljubomir Pantoviq, av.Agim Lushta, av.Asdren Hoxha, av.Rame Dreshaj, av.Vilastimir Petrovq, av.Vehbi Beqiri, av.Dejan Vasiq, av.Isa Salih, av. Halil Derguti, av.Ali Rexha, av.Srdjan Mitrovq, av.Fatlume Korqa Sekiraga, av.Miro Deleviq, av.Musa Damati, Av.Mahmut Halimi, av.Arsim Bilalli, av.Durim Osmani,av.Syleiman Klinaku, av.AliBeka, ay.Arlind Jupolli, av.Betim Shala, av.Valder Kadriu, av.Halil Palaj dhe av.Alban Makolli konform nenit 250 par.3 të KPP-së, ashtu që kundër këtij aktvendimi mbrojtësit e të akuzuarve kishte parashtruar ankesë, mirëpo me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër PN.S.nr.45/20, të datës 04.12.2020, janë refuzuar si të pa bazuara ankesat e mbrojtëseve, ndërsa Aktvendimi Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me numër PS.nr.20/20, të datës 20.08.2020, ishte vërtetuar.

Me aktvendimin e kësaj gjykate, me numër PS.nr.23/20, i datës 27.01.2021, është bërë **veçimi i procedurës dhe ndarja e lëndës** në çështjen penale PS.nr 23/20, ashtu që është vendosur që në vazhdim do të udhëhiqen procedurat e ndara për pikat e aktakuzës si në vijim: I, II, III, IV, V, VI, VII de VIII, të përfshirë të akuzuarit Z S, B N, M M, A M, de A H, O K, R M, D S, D K, J D, Z B, B M, A P, Z R, K S, R K, V T, B T, L V, B M, B L de N B, për shkak të veprave penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.3 dhe me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së dhe Marrja e Ryshfetit në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së si dhe K S edhe për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar

të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së. Ndërsa pikat IX, X,XI dhe XII, te përfshirë te akuzuarit I J A I, F I, B U, N J, XH V, M J, N B, B M, J M, S I, për shkak te veprës penale Kontrabandim me mallra në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 317 par.1 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, Nysret Jashari dhe F I për shkak të veprës penale Mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjithashtu me aktvendimet e kësaj gjykate PS.nr.23/20, të datës 24.10.2022 ndaj të akuzuarve K S dhe B M është **hedhur aktakuza** e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.32/18, e datës 18.05.2020 dhe është **Pushuar Procedura Penale**, për veprat penale për të cilat ishin ngarkuar sipas aktakuzës së PSRK-së numër PPS.nr.32/2018, të datës 18.05.2020, për shkak të **vdekjes së të akuzuarve të lartpërmendur**.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtime gjyqësore¹⁴, ashtu që shqyrtimi gjyqësor ka filluar më datën 25.10.2022 dhe ka përfunduar me datën 23.10.2023, ndërsa shpallja e aktgjykimit në këtë çështje është bërë me datën 27.10.2023. Gjatë seancave të shqyrtim gjyqësor kanë marrë pjesë përkatësisht akuzën e kanë përfaqur Prokurori e shtetit nga PSRK, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre.

Prokurori i shtetit nga PSRK Burim Çerkini, në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës dhe veprave penale për të cilit janë ngarkuar të akuzuarit, andaj edhe ka propozuar që të njëjtit të shpallen fajtor për veprat penale dhe të dënohen sipas ligjit.

Të gjithë të akuzuarit, përveç të akuzuarit B M në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë ngarkuar me aktakuzë, ndërsa B M e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat ishte ngarkuar me akuzë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 25.10.2022, trupi gjykues e kishte refuzuar pranimin e fajësisë të bëtë nga ana e të akuzuarit B M, për shkak se kishte vlerësuar se i akuzuari akuzohet për dy (2) vepra penale sipas pikës V dhe VI që janë të përcaktuara në aktakuzë, për të njëjtën periudhë kohore dhe përshkrimi i veprimeve inkriminuese tek këto dy pika për të akuzuarit ishin të ngjashme, prandaj kishte vlerësuar se është edhe në dobi të akuzuarit që të shqyrtohet çështja e fakteve sa i përket dy (2) veprave penale për te cilat akuzohej dhe se pranimi i fajësisë nuk është i plotë për shkak se gjykata kishte vlerësuar se aktakuza duhet të shqyrtohet në tërësi faktiket e saj ashtu që edhe sipas nenit 248 par.1 nënpar.1.4 të KPP-së është përcaktuar se: “kur aktakuza ka gabime faktike” pranimi i fajësisë mund të refuzohet të bërë nga ana e të akuzuarit, prandaj, gjykata ka konsideruar se nuk mund të bëhet pranimi i fajësinë në këtë fazë. Gjykata e kishte njoftuar të akuzuarin B M se sa i përket pranimit të fajësisë të bërë nga ana e tij, gjykata do ta merr për bazë se dhe benefitet që rrjedhin si rezultat i pranimit te fajësisë dhe benifiteve si Dëshmitar bashkëpunues nuk do të humbin edhe pse është refuzuar pranimi i fajësisë dhe të njëjtat do ti përfitojë në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, nëse shpallet fajtor dhe do të

¹⁴ Të gjitha procesverbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 311 par.1 të KPP-së, janë përpiluar me shkrim të cilat procesverbale gjenden në shkresa e lëndës ashtu që shqyrtimi gjyqësor nuk është regjistruar me audio ose video incizim për shkak të mungesës së këtyre pajisjeve në gjykatë në kohën kur janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor.

konsiderohet sikurse të ishte bërë pranimi i fajësisë sikurse në këtë fazë, ashtu që nëse ndryshon çështja e fakteve pranimi i fajësisë mund të bëhet deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësorë.

Në këtë çështje penale sipas aktakuzës cilësinë e dëshmitarëve bashkëpunues e kishin dëshmitarët – të akuzuarit Z S, B M, R K dhe Z B, mirëpo gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 14.02.2023 të akuzuarit – dëshmitarët Z S, R K dhe Z B, kanë deklaruar se nuk duan ta kenë cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues në këtë çështje penale dhe tërhiqen nga kjo cilësi e dëshmitarit bashkëpunues dhe deklaratat e tyre të dhëna në këtë cilësi. Prokurori i shtetit i PSRK-së Burim Çerkini, gjatë kësaj seance ka kërkuar që të lartpërmendurve t’iu hiqet statusi i dëshmitarëve bashkëpunues, sipas urdhrave të kësaj gjykate meqenëse të njëjtit kanë deklaruar se nuk duan ta kenë më këtë cilësi.

Gjykata, ka revokuar urdhrat e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të gjyqtarit të procedurës paraprake, me të cilët janë shpallur si dëshmitar bashkëpunues, dëshmitarët – të akuzuarit Z S, R K dhe Z B dhe ka vendosur që të njëjtit nuk do ta kenë cilësinë e dëshmitarëve bashkëpunues në këtë çështje dhe do ta kenë vetëm cilësinë e të akuzuarve meqë që të tre kane deklaruar se tërhiqen nga kjo cilësi dhe po ashtu ka qenë kërkesë e Prokurorit të Shtetit të PSRK-së, që të njëjtëve t’iu hiqet cilësia e dëshmitarëve bashkëpunues. Gjykata deklaratat e dëshmitarëve bashkëpunues Z S, R K dhe Z B, të dhëna pranë PSRK-se në cilësi të dëshmitarëve bashkëpunues i ka veçuar nga shkresat e lendes duke i mbyllur në një zarf të veçantë dhe ka vendosur që të njëjtat nuk do të përdoren si prova në këtë procedurë.

Prokurori i shtetit i PSRK-së Burim Çerkini, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 20.10.2023, para fjalës përfundimtare ka deklaruar se është një fazë tjetër e procedurës ku kemi të bëjmë me ndryshimin apo plotësimin e aktakuzës dhe ne si prokurori paraprakisht kemi dorëzuar një shkresë zyrtare në gjykatë përmes emalit, e që e njëjta ju ka shpërnda edhe avokateve mbrojtës e që ka të beje me ndryshimin e akuzës. Andaj deklaroj se konform neni 348 të KPP-së ne si Prokurori Speciale duke nisur nga rrjedhja e kësaj çështje penale dhe duke marrë parasysh rrethanat si në pjesën procedurale dhe materiale e që ka të bëjë me provat dhe rrjedhën kronologjike të këtij rasti, ne bëjmë ndryshimin e aktakuzës ashtu që pjesa që të bëjë me veprën penale marrje ryshfeti në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, e që në aktakuzë është parapare në dispozitivet II, IV, VI dhe VIII janë me numra romakë, ne si Prokurori tërhiqemi nga veprat penale të përcaktuar sipas pikave të akuzës për të gjithë të akuzuarit që janë akuzuar sipas këtyre pikave dhe mbesim pranë aktakuzës sipas dispozitivet I, III, V, VII të aktakuzës, ndaj të akuzuarve për veprat penale që ngarkohen sipas këtyre pikave, ndërsa për piken IX dhe X për këto raste vetëm ka përfunduar procedura – gjykimi. Dua të arsyetoj pse tërhiqemi nga vepra penale e Marrjes së ryshfetit: si arsye e pare janë provat në këtë çështje penale sepse duke u nisur nga kjo që kemi shqyrtuar këtu, ne nuk kemi pasur prova që e vërtetojnë shumë përtej dyshimit të bazuar mirë për këtë vepër penale sepse nuk kemi pasur prova direkte të dhënies apo marrjes së parave. Arsyeja e dytë është kronologjia e rastit nëse në si pjesëmarrës e dimë si ka filluar ky rast ky ka filluar se bashku me një rast tjetër e që gjate rrugës është ndarë. Ka të bëjë me rastin tek ne është nr.PPS 21/18 e që ka të bëjë me regjionin e Laposaviqit, ka qenë aksioni dhe procedura në fillim ka qenë e përbashkët me pas gjatë hetimeve në fund pas përfundimit të hetimeve është ndarë kjo procedurë dhe rasti që ka të bëjë me Laposaviqin kemi vendim të formës se prerë që ka qenë vendimi i

shkallës së parë, dytë dhe që ka kaluar edhe në shkallën e trete. Akuza ka qenë njëjtë me dy vepra penale të detyrës zyrtare, si kjo akuze dhe kemi pasur vendim që ka kalu vetëm keqpërdorimi dhe është hequr marrja e ryshfetit. Arsyeja tretë do e arsyetoj ne aspektin juridik, ku do te thotë është e karakterit subsidiar që d.m.th. kur nuk përmbushte as ndonjë element i veprës se veçantë ne kuadër te detyrës zyrtare, atëherë kemi mundësi te shkojmë me veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar, e cila është me gjithëpërfshirëse dhe parimi tjetër është që e kemi vlerësua se nuk mund te akuzohet një person për dy vepra penale te keqpërdorimit te detyrës zyrtare siç është bere në rastin konkret, kjo është si rrjedhoje edhe e vendimeve te gjykatave që ka te beje me rastin e Leposaviqit. Kjo ishte sa për ndryshimin e akuzës.

2. Fjala përfundimtare e palëve¹⁵

Prokurori i shtetit nga PSRK Burim Çerkini, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se: se mbetëm në tërësi pranë aktakuzës së ndryshuar, kualifikimit juridik dhe provave të prezantuara në aktakuzë. Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, pa mëdyshje është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës dhe atë në vazhdim dhe në bashkëkryerje Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nën par.2.2 lidhur me par.1 dhe nenet 81 dhe 31 të KPRK-së. Për të akuzuarin N B pas vlerësimit të të gjitha provave material dhe jo materiale, si ato jo kontestuese por edhe ato kontestuese, dëshmime dhe deklaratave nga ana e dëshmitarëve dhe mbrojtjes së të akuzuarit e të cilat janë shtjelluar përgjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është provuar se në veprimet e të akuzuarit N B, ekzistojnë elementet e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nën par.2.2 lidhur me par.1 dhe me nenin 81 të KPRK-së. Andaj, konform nenit 51 par.1 lidhur me nenin 262 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, në mungesë të provave tërhiqemi nga ndjekja penale për të akuzuarin N B. Tutje, ka shtuar se të akuzuarit e tjerë me mos pranimin e fajësisë për veprat penale për të cilët akuzohen është i orientuar në ikjen e përgjegjësisë juridiko-penale e që është në kundërshtim të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës e posaçërisht me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjendja faktike se të akuzuarit kanë kryer veprën penale duke vepruar sipas ndërrimeve të tyre dhe në bashkëpunim me të akuzuarit brenda të njëjtit ndërrim, në vazhdimësi, të akuzuarit në bashkëkryerje në cilësinë e personave zyrtar duke shfrytëzuar detyrën zyrtare apo autoritetit zyrtar, me dashje nuk kanë kryer detyrat e përcaktuara me ligj dhe nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër në atë mënyrë që disa të akuzuar në cilësinë e udhëheqësit të ndërrimit dhe të tjerët në cilësinë e policëve patrullues në kuadër të ndërrimeve ku kanë punuar në kuadër të SPMK, kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare dhe autorizimeve duke lejuar dhe mundësuar kontrabandimin e mallrave të ndryshme si kafshë, derivate, pije alkoolike dhe joalkoolike dhe mallra ushqimore nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, nëpërmjet rrugëve ilegale derisa kanë qenë në detyrë zyrtare duke mbikëqyrë rrugët e brezit kufitar, ashtu që kanë përfituar për vete përfitim pasuror të kundërligjshëm si dhe ju kanë mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm edhe personave të tjerë si transportues të mallrave duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, me ç'rast i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm buxhetit të Republikës së Kosovës. Si fakte jokontestuese nga

¹⁵ Prokurori i shtetit, si dhe mbrojtësit e të akuzuarve, fjalën përfundimtare trupit gjykues ia kanë dorëzuar në formë të shkruar të cilën e kanë elaboruar ndërsa të akuzuarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .

shqyrtimit gjyqësor janë nxjerr faktet se tani të gjithë akuzuarit për kohën për të cilën janë akuzuar kanë qenë në cilësinë e personave zyrtar, kanë punuar në Stacionin Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok. I pa kontestuar është fakti se disa nga të akuzuarit janë apo kanë qenë udhëheqës të ndërrimeve A, B, C, ndërsa pjesa tjetër kanë qenë qoftë zëvendës ndërrimi apo edhe polic patrullues në SPMK në Zubin Potok, dhe se epror i gjithë stacionin ka qenë tani i akuzuari Z S si komandant i stacionit. Fakt tjetër i pa kontestuar gjatë shqyrtimit gjyqësor është edhe fakti se në pjesën veriore të Kosovës, përgjatë kufirit me Serbinë, më saktësisht në fshatrat e brezit kufitar si Banjë, Bube dhe Uglarë, kanë ekzistuar rrugë ilegale ku edhe është zhvilluara kontrabanda e mallrave nëpër të cilat rrugë kontrabanduesit-transportuesit i kanë bartë mallrat e tyre në mënyrë ilegale jashtë pikave doganore me qëllim që të i'u ikin taksave të përcaktuara për kalimin e atyre mallrave. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor kontestuese ka qenë fakti i kryerjes së veprave penale nga ana e të akuzuarve, ku të njëjtit nuk pranojnë në asnjë moment ndërmarrjen e veprimeve të përshkruara si në dispozitiv të kësaj akuze, duke pretenduar se nuk e kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare dhe se nuk pranojnë faktin e ekzistimit të tarifave apo pranimit të tarifave të paracaktuara për kalimin e mallrave, por deklarojnë se punën zyrtare e kanë kryer me përgjegjësi duke shtuar se kanë procedura një numër të madh të rasteve të kontrabandës me mallra. Pretendimet e të akuzuarve përgjatë mbrojtjes së tyre janë të paqëndrueshme e kjo e vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues B M, i cili vërteton faktin se në rrugët ilegale zhvillohet kontrabandë, i njëjti ka qenë vet zyrtarë policor ku gjatë kryerjes së detyrave zyrtare ka bashkëpunuar me kolegët e tij tani të akuzuar ku kanë bërë veprime të kundërligjshme duke lejuar transportimin-kontrabandimin e mallrave në mënyrë ilegale nga Kosova për në Serbi dhe anasjelltas, si dhe për çdo transportim kanë pranuar edhe të mira material sipas tarifave të paracaktuara duke i'u mundësuar kontrabanduesve kalimin e mallit. Tarifat kanë funksionuar prej më shumë se dy vite kohë dhe se përafërsisht kanë qenë të ngjashme për të gjitha mallrat, duke filluar nga 50 deri 150 €uro. Paratë janë marrë qoftë direkt nga secili pjesëtar i secilit ndërrim, kanë marrë përmes personave të tjerë, e po ashtu edhe mënyra tjetër që personat i kanë lënë parat në vende të ndryshme p.sh në lokale, pompa të derivateve. Pas marrjes së parave qoftë nga personat apo nga vendet e ndryshme të njëjtat janë ndarë Brenda policëve që kanë punuar në të njëjtin ndërrim. Po ashtu, dëshmitari ka vërtetuar faktin se kjo metodë ka funksionuar si në ndërrimet ku ai vetë ka punuar ashtu edhe në ndërrimet e tjera. Specifikisht gjatë dëshmisë së tij përmend zyrtarët policor të ndërrimit A, B dhe C. Përveç kësaj më e rëndësishmja në këtë pjesë është se dëshmitari B M vërteton faktin se në të gjitha ndërrimet mënyra e komunikimit me zyrtarët policor ka qenë nëpërmes telefonave të veçantë, ku secili prej ndërrimeve ka pas numër të veçantë dhe aty policët në detyrë apo udhëheqësit e ndërrimeve kanë dhënë udhëzime se si kontrabanduesit të kalojnë me mallin e ngarkuar nëpër mes fshatrave, ku kanë kaluar pa asnjë kontroll. Dëshmitari bashkëpunues B M ka vërtetuar se në rrugët ilegale zhvillohet kontrabandë nga pothuajse kontrabanduesit e njëjtë të cilët janë marrë me transport të mallrave. Në këtë çështje penale përveç të akuzuarit B M, cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues e kanë pas edhe disa nga të akuzuarit e tjerë si Z S, Z B, R K, ku me kërkesën e tyre i'u është hequr kjo cilësi gjatë shqyrtimit gjyqësor. Arsyeja e tërheqjes së tyre nga cilësia e dëshmitarëve bashkëpunues në fazën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale si PSRK konsiderojmë që nuk e zbeh apo zvogëlon aftësinë provuese të tyre dhe vërtetimin e gjendjes faktike të paraqitur sipas dispozitivëve në aktakuzë. Andaj, gjykata me rastin e vendosjes në këtë çështje penale duhet që ti merr parasysh edhe këto të dhëna të cekura në dëshmitë e tyre si dhe ti krahason edhe me prova të tjera që në fund të jetë një vendim gjithëpërfshirës. Po ashtu, të njëjtën gjendje

faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor si në dispozitiv të akuzës, e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët anonim sipas shifrave D1 dhe F2 e që të dytë kanë qenë zyrtar policor dhe të njëjtit e kanë vërtetuar faktin se kontrabanda në veri ka funksionuar në atë mënyrë që ka pas bashkëpunim mes zyrtarëve policor si dhe kontrabandistëve. Dëshmia e këtyre dëshmitarëve janë të njëjta me dëshmitë e dëshmitarëve bashkëpunues si për ekzistim të tarifave të veçanta që janë paguar me rastin e kalimit të mallrave, ekzistimin e telefonave të veçantë të cilët kanë shërbyer për komunikim në mes të kontrabandistëve dhe zyrtarëve policor, mënyrën e dhënies së parave qoftë në dorë apo edhe në vende të caktuara. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor në cilësinë e dëshmitarëve janë dëgjuar edhe dëshmitarët e propozuar nga ana e PSRK-së të cilët kanë vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivët e akuzës duke vërtetuar veprimet inkriminuese të të akuzuarve, mënyrën e funksionimit të kontrabandës në atë pjesë, mënyrën e komunikimit të zyrtarëve policor me kontrabandistët e që ka qenë përmes telefonave të veçantë, pagesën e tarifave të veçanta për kalimin e mallrave si dhe vendet e caktuara ku janë bërë pagesat. Veprimet inkriminuese të të akuzuarve janë vërtetuar gjithashtu dhe nga përgjimet-bisedat që janë në përputhje të plotë edhe me provat e tjera të siguruara gjatë procedurës hetimore, dëshmime të dëshmitarëve, mbrojtjes së të akuzuarve në cilësinë e dëshmitarëve bashkëpunues dhe provave tjera teknike. Këto përgjime të bisedave që janë nxjerr nga vetura zyrtare, materializohen me thëniet e dëshmitarëve dhe vërtetojnë në mënyrë të pakontestuar se në veprimet e të gjithë të akuzuarve ekzistojnë veprime inkriminuese për çka edhe janë akuzuar. Ndërsa lidhur me një pjesë të provave që gjykata i ka shpallur të papranueshme, pala mbrojtjes kundërshtimet e tyre kanë qenë të orientuara në mënyrën e nxjerrjes, mirëpo jo të përmbajtjes. Tutje, në fjalën përfundimtare prokurori ka shtuar se përgjegjësinë penale të të akuzuarve në këtë proces penal përveç provave që i kemi paraqitur e vërtetojnë edhe vendimet e të njëjtës gjykatë për të akuzuarit e përfshirë e që procedura penale është zhvilluar e ndarë. Andaj, mbështetur në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve Z S, B N, M M, A M, A H, O K, R M, D S, D K, J D, Z B, A P, Z R, R K, V T, B T, L V, B M dhe B L, ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale si në dispozitiv të kësaj aktakuze dhe atë Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nën par.2.3 lidhur me par.1 të KPR-së, dhe i propozojmë trupit gjykues që të akuzuarit ti shpall fajtor për këto veprat për të cilët janë të akuzuar si dhe të njëjtëve të i'u shqiptoj një dënim të paraparë me ligj me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit Z S, av.Ahmet Gjinovci, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se me asnjë provë qoftë formale apo material nuk është provuar teza e akuzës se i mbrojturi im ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Provat materiale të administruara në këtë çështje penalo-juridike provojnë faktin se pretendimet e PSRK-së janë tërësisht të paqëndrueshme, sepse aktakuza është e pabazuar në fakte dhe prova dhe e njëjta është në kundërshtim me provat material që gjenden në shkresat e lëndës. Për më tepër dispozitivi i aktakuzës me një analizë dhe kujdes të shtuar vërteton faktin se te i mbrojturi im nuk ka veprime konkrete inkriminuese që mund ti përshkruhen si elemente apo tipare të veprës penale për të cilën akuzohet. Dispozitivi i aktakuzës është në kundërshtim me provat material nga shkresat e lëndës dhe si e tillë si në aspektin faktik dhe atë juridik është e paqëndrueshme, pasi që nuk përshkruhen veprimet konkrete inkriminuese për të cilat dyshohet i mbrojturi im e që paraqesin tiparet të veprës penale dhe mu për këtë konsiderojmë se aktakuza nuk i plotëson standardet e parapara me dispozitën e

nenit 241 të KPP-së. Gjithashtu, gjykata duhet të vlerësoj mbrojtjen e të mbrojturit tim Z S dhënë në Prokurorinë Speciale, deklaratë kjo e cila pa mëdyshje provon faktin se i njëjti nuk ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, e veçmas duhet të ketë parasysh dhe duhet të vlerësoj se i njëjti nga fillimi i hetimit në këtë çështje penale ishte më tepër se bashkëpunues me organet e hetuesisë dhe me prokurorinë. Mbrojtja tutje ka shtuar se prokuroria në mënyrë paushallë mbështetë pretendimet e aktakuzës pa dhënë përshkrim konkret për çdo veprim inkriminues për të mbrojturin tim. Andaj, konsiderojmë se të gjitha këto fakte aktakuzën e bëjnë juridikisht të paqëndrueshme sepse pretendimet e prokurorisë nuk kanë mbështetje në prova dhe fakte të besueshme. Në këtë procedurë gjyqësore gjithashtu janë dëgjuar edhe dëshmitarët anonim si D-1 dhe F-2 dhe dëshmitar të tjerë, nga deponimi i këtyre dëshmitarëve nuk vërtetohet se i mbrojturi im ka kryer veprat penale për të cilat pretendon PSRK në aktakuzë. Gjithashtu, janë administruar prova si transkripta-telefonatat, nga të cilat vërtetohet se i mbrojturi im nuk ka biseduar me ndonjë person që dyshohet për veprimet kriminale për të cilat ngarkohet. Mbrojtja, tutje thekson se duke pasur parasysh bashkëpunimin e të mbrojturit tim me organet e hetuesisë nga fillimi i hetimeve e sidomos me prokurorinë, vërtetohet se i njëjti në tërësi ka kryet dhe përmbushur detyrat e punës në zonën e tij të përgjegjësisë si komandant i Stacionit Policor në Zubin Potok dhe fare nuk është dashtë të figuroj si i akuzuar në këtë rast. Mbrojtja konsideron se provat material të cilat gjykatës i janë dorëzuar me parashtresën e datës 22.03.2023 e po ashtu edhe PSRK-së pavarësisht se në shqyrtimin e datës 17.05.2023 janë refuzuar nga ana e trupit gjykues për tu administruar si prova, mbrojtja konsideron se janë prova me rëndësi për të vërtetuar gjendjen faktike të plotë dhe janë prova relevante për një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Përmes këtyre provave material do të vërtetohej se i njëjti ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të autorizimeve të përcaktuara në Ligjin e Policisë së Kosovës në zonën e tij të përgjegjësisë për të penduar kontrabandimin-kalimin ilegal të mallrave nga Republika e Serbisë në Republikën e Kosovës, i njëjti ka informuar me kohë organet më të larta në zinxhirin komandues të policisë se çka po ndodhë, ku gjatë ushtrimit të detyrës së tij ka qenë i kërcënuar, sulmuar dhe i penguar në kryerjen e detyrës. Të gjitha këto fakte provojnë pafajësinë e të mbrojturit tim nga se nuk është provuar se në bashkëkryerje ka kryer vepra penale për të cilat akuzohet. Nga të lartcekurat gjykatës i ka propozuar që konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së, të merr aktgjykim lirues.

I akuzuari Z S, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, duke deklaruar tutje se përgjegjshëm deklaroj për veten se nuk kam shkelur asnjë nen të ligjit të vlefshëm në Kosovë, jo vetëm të ligjit por edhe të Udhëzimeve Administrative dhe rregulloreve apo procedurave. Do ta kisha një vërejtje trupit gjykues e ka pranuar dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues B M, pasi që ne nuk e dimë se kush janë dëshmitarët mbrojtur e trupi gjykues e dine, le ta shikon ne deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues B M, kush janë dy police nga policia vëzhguese e stacionit policor Zubin Potok i ka emëruar si kontrabandues kryesor të barnave cigareve etj, ashtu që trupi gjykues do ti bëhet e qarte se ne çfarë dëshmitar bashkëpunues ish prokurori e ka bazuar akuzën. Ky është shekulli XXI nuk është shek.V para erës se re, juve juristëve është shumë i njohur pragma se dy qobane e kane dënuar, frikësohem se ish prokurori me arrestimin dhe ngritjen e akuzës kundër këtyre 90 % të njerëzve vetëm ka dashur ti fsheh ata që kanë kontribuar në punët jo ligjore. Ne çfarë presioni e ka për këtë dhe me presion të kujt e din ish prokurori dhe edhe prokurori i tanishëm,

e si e kam kryer unë punën time jam i sigurt që e din edhe ish prokurori dhe prokurori i tanishëm, dhe një nga ju tre anëtarët e trupit gjykues një prej jush e dini se a kam bërë apo jo, kaq.

Mbrojtësi i të akuzuarës B N, av. Dobrica Laziq në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar se e mbrojtura ime nga ana e PSRK-së akuzohet se nga viti 2017 deri në vitin 2019 ka keqpërdorur detyrat dhe kompetencat e saj zyrtare duke lejuar dhe lehtësuar kontrabandën e mallrave në rrugë ilegale dhe duke bashkëpunuar me D I, B R, D D, M R, M R, Z V, ashtu që duke bashkëpunuar me të njëjtit ka vepruar në kundërshtim me detyrën e saj zyrtare. Nën akuzën e PSRK-së për marrje të ryshfetit e mbrojtura ime ka qëndruar në paraburgim 15 muaj, ndërsa nga analiza e provave të administruara përgjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se aktakuza e PSRK-së është e pabazuar dhe pa asnjë provë. Pas tërheqjes së prokurorit të shtetit nga pika e aktakuzës për marrje të ryshfetit si mbrojtje konsiderojmë se është e paqëndrueshme që të njëjtit të akuzuar të ndiqen nën pikën e Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, për arsye se nëse nuk është vërtetuar marrja atëherë si ka ndodhur keqpërdorimi i pozitës i pretenduar nga ana e PSRK-së. Andaj, duke u bazuar se në drejtim të të mbrojturës sime nuk ka prova për të vërtetuar fajësinë dhe nga të lartcekurat gjykatës i ka propozuar që konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së, të merr aktgjykim lirues.

E akuzuara B N, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe ka shtuar se që nga deklarata ime e parë që kam dhënë se nuk ndjehem fajtorë, e përsërisë se nuk jam fajtorë, ndihem e tradhtuar se në vend se të marr mirënjohje kam përfunduar ku kam përfunduar, nuk kam çfarë të them tjetër.

Mbrojtësja e të akuzuarit A H, av. Albana Kelmendi, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se sa i përket pikës së I të aktakuzës e njëjta është për plotë paqartësi dhe konfuzitet, që do ti vë në pah vetëm ato të cilat janë plotësisht të pamundshme të ndodhin mbi bazën e provave shkresore të cilat demantojnë tërësisht akuzën. Prokuroria sa i përket dispozitivit të I-të të akuzës që ka të bëjë me të mbrojturin tim, cek vetëm se i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar me dashje nuk kanë kryer detyrat e përcaktuara me ligj dhe nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare të tyre me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, pa cek fare se si është bërë keqpërdorimi me qëllim të përfitimit të dobisë dhe për më tepër cilin ligj dhe cilin dispozitë të këtij ligji e ka shkelur dhe vazhdon tutje për të akuzuarit e tjerë, pa saktësuar se në cilën mënyrë i kanë tejkaluar detyrat e tyre zyrtare, sa është përfitimi nga personat e tjerë të përmendur në këtë dispozitiv dhe cilat janë personat e tjerë të cilët kanë përfituar nga mospërmbushja e detyrave zyrtare. Forma dhe elementet që sanksionon veprat penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare me qëllim që vetës, apo personit tjetër, t'i sjellë përfitim pasuror, ose dëm palës tjetër me mos përmbushjen, ose tejkalimin e kompetencave. Pra, të tri këto forma, keqpërdorimi, mos përmbushja dhe tejkalimi i kompetencave janë elementet e vetme që sanksionohen dhe të cilat kryhen vetëm me dashje direkte, pra, vepra penale në fjalë kryhen vetëm me dashje direkte, pra vepra penale kryhet vetëm me dashje direkte. Pra, sipas dispozitivit nuk është e qartë se në cilën formë është kryer vepra penale me keqpërdorimin, me mos përmbushjen apo me tejkalimin e kompetencave. Nga dispozitivi I-rë i aktakuzës nuk është vërtetuar se kush ka përfituar në rastin konkret, nëse po, sa

është ai përfitim. Tutje, edhe pas shqyrtimit gjyqësor prokuroria ka dështuar të argumentoj përgjegjësinë penale të z.H kjo së paku nuk është arritur të vërtetohet me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor prokuroria si organ i ndjekjes, obligohet që ti provojë para gjykatës pretendimet e prezantuara në akuzë. Përfaqësuesi i akuzës ka dështuar të argumentoj akuzën dhe atë në asnjë fazë të procedurës e as në shqyrtim gjyqësor gjykatës nuk i është ofruar prova të pa kontestueshme me të cilat do të vërtetohet ekzistimi i veprës penale dhe përgjegjësia penale e të mbrojturit tim. Të gjitha dëshmitarët e propozuar nga organi i ndjekjes, janë dëgjuar në shqyrtim gjyqësor dhe nga deklaratimet e tyre është vërtetuar e kundërta e asaj që organi i ndjekjes ka pretenduar. I mbrojturi im që nga fillimi i procedurës penale të zhvilluar kundër tij, gjatë hetuesisë dhe gjerë në fund të shqyrtimit gjyqësor ka qenë kooperativë dhe në detaje ka treguar ngjarjen lidhur me veprimet e tij gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Pra, pas analizimit të të gjitha provave personale dhe duke i ndërlidhur edhe me provat materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor vërtetohet se nga përshkrimi i veprimeve të të mbrojturit tim, në asnjë pjesë të akuzës nuk mund të përcaktohet elementi objektiv dhe subjektiv i veprës penale si element esencial që kërkohet për të përmbushur kushti ligjor, për ekzistimin e veprës penale “ Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Nga të lartcekurat gjykatës i ka propozuar që konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së, të merr aktgjykim lirues.

I akuzuari A H, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtëses time, e di që nuk jam fajtor dhe nuk kam asgjë tjetër për te shtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit A M, av.Naim Rudari, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se provat mbi të cilat mbështetët aktakuza nuk janë marr në mënyrë të ligjshme nga Inspektorati Policor i Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë ngase ata kishin aplikuar masat e fshehta pa nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve. Si mbrojtje kundërshtojmë të gjitha materialet e nxjerra nga aplikimi i masave të fshehta nga IPK të cilët në bashkëpunim me prokurorinë kanë aplikuar këto masa pa aktvendim për fillim të hetimit. Në fazën e kundërshtimit të provave dhe kërkesën për hudhje të aktakuzës është nxjerr aktvendimi me numër PS.nr.23/2020 të datës 20.08.2020 me të cilin ish-in aprovuar pjesërisht kundërshtimet ndaj provave të ushtruara nga mbrojtësit duke konstatuar si të paligjshme urdhëresat PPRKR.nr.282/18 të datës 15.02.2019 të lëshuar nga gjykata në lidhje me masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit si: Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave, hetimi i fshehtë, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerje e simuluar dhe simulim i veprës së korrupsionit në raport me të pandehurin Z S, Z R, O K, B N dhe D K dhe atë që nga data 15.02.2019 e deri me datë 06.05.2019 si dhe provat e nxjerra nga këto urdhëresa janë shpallur të papranueshme të cilat janë përjashtuar nga shkresat e lëndës. Mirëpo në raport me pretendimet e mbrojtësve të tjerë kundërshtimet janë refuzuar si të pabazuar, kështu duke lënë gjykata në shfrytëzim frytet e një peme të helmuar pasi që vetë urdhëresa për aplikimin e masave të fshehta ishin të pa ligjshme sepse ato ishin nxjerr pa aktvendim për fillimin e hetimeve dhe se ato u ishin drejtuar personave konkret me emër dhe mbiemër. Ato urdhëresa mund të ishin të ligjshme sikur mos të kishte asnjë person të dyshuar me emër dhe mbiemër, të cilëve u dihet identiteti dhe deri në momentin që mësohet identiteti i ndonjërit do të duhet të kishim aktvendim për fillimin e hetimit, por nga momenti që ka pasur persona të dyshuar identiteti i të cilëve është ditur është dashur të kishte aktvendim për fillim të hetimeve dhe më pas ajo urdhëresë do të ishte e ligjshme edhe për të

dyshuarit e tjerë identiteti i të cilëve nuk është ditur në ato momente. Provat që tani për tani gjykata i cilëson si të ligjshme kanë ndërlidhje të pandashme me ato të kundërligjshmet, pra janë të lidhur si mishi me kockën të cilat assesi nuk mund ti kenë dy epitete dhe atë brenda bisedës së zhvilluar e për bashkëbiseduesit për njërin të jetë e paligjshme e për tjetrin të jetë e ligjshme. Tutje, mbrojtja ka shtuar se provat që ishin propozuar nga prokuroria që të administrohen në shqyrtimin gjyqësor nuk ishin prova relevante që dëshmonin se A M e ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet edhe pse asnjëra nga ato që kishte përmendur prokurori në aktakuzë nuk përbënte provë konkrete lidhur me A e që dëshmon se i njëjti ka kryer ndonjërin nga veprat penale që i viheshin në barrë. Nga analizimi i shkresave që kemi pranuar nga prokuroria nuk kemi hasur në ndonjë provë të drejtë e të ligjshme që argumenton tezën e aktakuzës së prokurorisë. Deklarata e dëshmitarit të mbrojturi D1 i cili ka dhënë deklaratë me datë 04.04.2019 ka thënë se kinse të gjithë policët janë përfshirë që të merren me kontrabandistë por ai nuk ka përmendur për asnjë moment emrin e A M apo nuk ka mundur që të dëshmoj diçka konkrete lidhur me të, madje dëshmitari ka deklaruar se ka marr para për vete dhe se i njëjti nuk dihet se pse është bërë dëshmitar i mbrojtur kur ai ka qenë i dyshuar dhe se ka qenë i përfshirë në veprimtari penale e cila rrethanë ligjërisht nuk e lejon që i njëjti të jetë dëshmitar, por përkundër vërejtjeve tona trupi gjykues e ka proceduar si dëshmitar të mbrojtur e që ne besojmë fuqishëm se kjo rrethanë nuk duhet të kaloj. Dëshmitari F2 po ashtu rezulton të jetë zyrtar policor i cili është intervistuar si dëshmitar por i njëjti besohet se ka qenë pjesë e përfshirjes në vepra penale të pretenduara, ndonëse ai në asnjë moment nuk e ka përmendur A M dhe se nuk di asgjë për Albertin sado që ka dhënë detaje, në anën tjetër nuk ka deklaruar për vetën e tij ngase Policia, IPK dhe Prokurori i shtetit e kanë amnistuar për veprat që ai i kishte kryer. I njëjti ka mundur të jetë dëshmitar bashkëpunues ashtu siç e parasheh nenit 235 i KPP-së. Në asnjërin nga aktvendimet mbi zgjerimin e hetimit i mbrojturi im A M nuk ka qenë pjesë e aktvendimit por në realitet masat e fshehta ndaj të njëjtit kanë filluar të aplikohen më herët para se të nxirret aktvendim për fillimin apo zgjerimin e hetimit. Pra, masa monitorimi i fshehtë i bisedave, hetimi i fshehtë, ishte aplikuar diku në muajin Mars 2019 e çka nënkupton se diku 3 muaj para se të ngritet aktvendimi për fillimin e hetimeve apo edhe për zgjerimin e hetimit ndaj A M si dhe aktvendim për zgjerimin e hetimit ndaj të mbrojturit tim ishte nxjerr 8 ditë pas arrestimit të tij. Lidhur me çështjen se kur fillon procedura penale në mënyrë të qartë ka paraparë neni 84 i ish KPPRK-së. Nga analizimi i bazës mbi të cilat janë lëshuar masat ndaj të mbrojturit tim mbrojtja thekson se procedura e zhvilluar në këtë çështje penale ishte pa bazë, me shkelje të shumta procedural dhe shkelje të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor duke aplikuar masa të fshehta në ndërhyrje të privatësisë e konkretisht ndaj A M dhe se asnjëherë nuk kishin mundur që të gjejnë diçka të dyshuar tek i njëjti. Pra, ndaj të mbrojturit tim nuk janë aplikuar dispozitat ligjore kur i njëjti është vënë nën masën e përgjimit ligjor dhe se i është nënshtuar masës së përgjimit pa pasur aktvendim për fillim të hetimit ose zgjerim të hetimit, e që këtë gjë nuk e lejon KPPRK-së dhe mbisundon parimi se nuk mund të shkelet ligji për të zbatuar ligjin. Ndërsa sa i përket çështjes së dëshmitarëve bashkëpunues mbrojtja në fjalën hyrëse ka theksuar faktin se pse nuk duhen të jetë të njëjtit dëshmitar bashkëpunues, mirëpo që gjykata ka refuzuar që ti hiqet statusi të njëjtëve duke vendosur kështu në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore dhe po ashtu të njëjtit nuk kanë deklaruar asgjë inkriminuese në raport me të mbrojturin tim. Tutje, mbrojtja ka shtuar faktin se përkundër që Gjykata e Apelit ka vendosur që masat e përgjimit ndaj të mbrojturit tim ti lë në fuqi dhe të procedohet, mbrojtja konsideron se përgjimet e njëjta janë të kundërligjshme dhe jemi të bindur se nuk mund të mbështetët asnjë vendim në të njëjtat

transkripte pasi që të njëjtat nuk kanë bazë ligjore dhe nuk mund të administrohen si provë. Po ashtu në bazë të gjithë procedurës së zhvilluar në këtë gjykatë për asnjë moment nuk është shpalosur asnjë dëshmi që argumenton se A M ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet nga ana e prokurorisë dhe se në rastin konkret nuk mund të kemi aktgjykim të drejtë e të ligjshëm tjetër sa i përket A M përveç aktgjykim lirues. Andaj, kërkojmë nga ana e gjykatës që në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së të mbrojturin tim ta lironi nga aktakuza sepse nuk është vërtetuar se ai ka kryer veprën penale për të cilën i vihet në barrë.

I akuzuari A M, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çka te shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit M M, av.Nebojsa Vlajic, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se ne si mbrojtje vazhdimisht kemi bërë jehonë sa i përket çështjes së provave që janë administruara pasi që të njëjtat janë prova të papranueshme. Ndërsa, sa i përket dëgjimit të dëshmitarëve mbrojtja thekson se të njëjtit vetëm janë deklaruar se kanë dëgjuar se është keqpërdorur detyra se është marr rryshfet pa përmendur burimin e informacionit se nga kush kanë dëgjuar apo si kanë ardhur në njohuri të këtyre fakteve, pra përmes tyre nuk është marr asnjë provë konkrete në raport me ndonjërin të akuzuar. Aktakuza është e paqartë në kuptimin e saj pasi që është shkruar në mënyrë të përgjithshme ku është e pamundur të përcaktohet se çfarë ka bërë saktësisht i mbrojturi im. Si mbrojtje konsiderojmë se nuk mund të dënohet askush në këtë mënyrë pasi që si vepër penale që akuzohet i mbrojturi im nga PSRK për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nuk është përmendur se në cilën datë, vend dhe në çfarë mënyre i mbrojturi im ka lejuar t'i shesin mallrat që janë zhdoganuar, në mënyrë të prerë dhe arbitrare është përmendur në aktakuzë se të akuzuarit kanë marr shuma të ndryshme të parave për kalimin e kamionit dhe se për këtë nuk ka asnjë provë konkrete e as ndonjë dëshmitar që e thotë këtë. Sa i përket provave gjegjësisht transkripteve të përgjimeve të njëjtat janë të papranueshme për mbrojtjen pasi që nuk dihet se kush flet në ato incizime, zëri i kujt është regjistruar dhe çfarë flitet aty. Andaj, nga të lartcekurat i propozojmë gjykatës që ndaj të mbrojturit tim të gjykata të merr aktgjykim lirues në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPP-së.

I akuzuari M M, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: në tërësi e mbështes avokatin tim dhe nuk kam çka të shtoj tjetër dhe nuk jam fajtor.

Mbrojtësi i të akuzuarit O K, av.Jovana Filipovic, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se edhe pse jemi në fjalën përfundimtare nuk e kam ndërruar linjën më fjalën hyrëse të cilën e kam dhënë pasi që nuk kemi asnjë provë të vetme që do të vërtetonte dyshimin e drejtpërdrejtë apo prova në mënyrë indirekte që do të rezultonte se veprimet e të akuzuarit O K përbënin elemente thelbësore të veprës penale për të cilën akuzohet. PSRK ka qenë e obliguar që të vërtetoj në mënyrë të qartë dhe të pagabueshme se cilët kufijtë të kompetencave të caktuara janë shkelur nga i mbrojturi im, në çfarë mënyre konkrete nuk e ka kryer detyrën zyrtare dhe çfarë dobie pasurore është marr me rastin e veprimit nga i mbrojturi im. Mbrojtja thekson se për tu vërtetuar fajësia apo pafajësia e një personi duhet përgjigjur pyetjeve të arta të kriminalistikës, ndërsa me anë të provave të paraqitura në këtë procedurë nuk është marr asnjë përgjigje lidhur me pyetjet nga pyetjet e arta

nga kriminalistika. Mbrojtja thekson se nuk kemi një formulim të qartë se cili veprim konkret për të cilën ngarkohet i mbrojturi im është i kundërligjshëm. Akuza e tillë nga ana e PSRK nuk është vërtetuar përgjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë prove material apo personale, andaj në kuptim të kësaj i propozojmë gjykatës që në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 i mbrojturi im të lirohet nga akuza.

I akuzuari O K, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e përkrah ne tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses time dhe nuk kam çka të shtojë tjetër, nuk jam fajtor vetëm kërkoj që drejtësia të triumfoj.

Mbrojtësja e të akuzuarit R M, av.Arlinda Avdimetaj – Fejzullahu, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar PSRK gjatë përshkrimit të veprimeve të të pandehurve për të cilat ata akuzohen në dispozitivin e III-të të aktakuzës në asnjë moment nuk ka argumentuar me fakte se cilat veprime të të mbrojturit tim përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën akuzohet. Me asnjë dëshmi nuk është dëshmuar se i mbrojturi im i ka tejkaluar kompetencat e tij apo nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose personin tjetër apo t'i shkaktoj dëm personit tjetër apo t'i shkel të drejtat e personit tjetër, ashtu siç parashihet në dispozitën ligjore në bazë të së cilës i mbrojturi im akuzohet. Tutje mbrojtja në fjalën përfundimtare ka theksuar sfidat e punës së zyrtarëve policor për të siguruar sundimin e ligjit në rastet e luftimit të kontrabandimeve duke rrezikuar dhe jetën e tyre, i mbrojturi im ka rrezikuar jetën e tij në detyrën e tij ndërsa sot i njëjti është i akuzuar nga PSRK për keqpërdorim të detyrës zyrtare e cila nuk ka provuar asnjëherë se të njëjtat kanë kryer këtë vepër penale. Po ashtu nga provat materiale të administruara, gjegjësisht transkriptet nga masat e përgjimit janë prova të cilat nuk kanë mbështetje ligjore pasi që i mbrojturi im bisedat e përgjuara nga transkriptet rezulton ti ketë nga data 17.02.2019, ndërsa aktvendimi për fillimin e hetimeve është nxjerr pas kësaj date nga data 06.05.2019. Nga të lartcekurat trupit gjykues i propozojmë që me rastin e nxjerrjes së vendimit lidhur me përgjegjësinë e të mbrojturi tim ti ketë parasysh rrethanat e elaboruara dhe të njëjtin ta liroj nga përgjegjësia për veprën penale për të cilën i vihet në barrë në mungesë të provave, pasi që në këtë procedurë nuk është provuar se ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet dhe gjykata nuk mund të bazoj vendimin e saj dhe ta shpall fajtor të mbrojturin tim vetëm në bazë të disa përgjimeve të kundërligjshme të nxjerra pa aktvendim për fillimin e hetimit.

I akuzuari R M, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: s mbështes ne tërësi fjalën përfundimtare te mbrojtëses time dhe nuk kam asgjë tjetër për te shtuar, dhe deklaroj se nuk jam fajtor.

Mbrojtësi i të akuzuarit D S, av.Ljubomir Pantovic, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se aktakuza e PSRK-së nuk është e bazuar në prova të besueshme, e njëjta ka mangësi të shumta dhe nuk mund të të jetë bazë për një bindje. Aktakuza nuk përmban parakushtet ligjore nga neni 235 të KPP-së, për më tepër në aktakuzë për të mbrojturin tim prokuroria pretendon se i njëjti ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtar si policë. Në rastin konkret cilat janë mallrat që i mbrojturi im i mundësoj kontrabandën, sa është sasia e atyre mallrave, vlera e tyre, për të gjithë këto prokuroria nuk ka arritur të argumentoj me asnjë provë të vetme. Po ashtu nga ana e PSRK-së i mbrojturi

im akuzohet se së bashku me të akuzuarit e tjerë u'a ka mundësuar përfitim të kundërligjshëm personave të cekur në aktakuzë pa treguar se cili është përfitimi që pretendohet, pra prokurori i shtetit nuk ka arritur të argumentoj përmes provave se i mbrojturi im ka mundësuar një gjë të tillë. Ndërsa sa i përket çështjes së dëmit prokuroria nuk ka arritur të vërtetoj lartësinë e dëmit që është shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës, andaj në kuptim të lartcekurave mbrojtja konsideron se prokuroria nuk ka arritur të argumentoj tezën e akuzës dhe për këtë i propozon gjykatës që ndaj të mbrojturit të sjell aktgjykim lirues.

I akuzuari D S, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çka të shtoj tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit D K, av.Milos Delevic, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se prokurori special i shtetit nuk na ka shpjeguar as në hapje, as në procedurën provuese dhe as tani në vijën përfundimtare se çfarë veprimesh ka kryer apo nuk i ka kryer i mbrojturi im, faktin se kur, ku, pse dhe si i mbrojturi im ka abuzuar me pozitën apo autoritetin zyrtar. Në aktakuzë nuk është cekur vendi, koha, mënyra e kryerjes së veprës penale të pretenduar me përshkrim dhe fakte të detajuara. Prokurori i shtetit në përshkrimin faktik të aktakuzës nuk ka përmendur ndonjë rast konkret kur klienti im drejtpërdrejtë ose nga një ndërmjetës ka marr para ose ka përfituar përfitime të tjera material, ekziston një teori e përgjithshme se disa policë kanë bashkëpunuar me kontrabandistë mirëpo nuk ka asnjë provë që klienti im e ka kryer këtë krim. Për më tepër nga dëgjimi i dëshmitarëve F1 dhe D1 të njëjtit janë të pabesueshëm dhe kontradiktor në deklaratimet e tyre, gjegjësisht dëshmitari D1 në pyetjen e mbrojtësit se ku ka marr informacionin se Dragos Kompiroviq ka mbledhur para për tre turnet në shumën prej 500 Euro secila, dëshmitari është përgjigjur me atë se:” Kam dëgjuar”, pra i njëjti nuk është i besueshëm si provë për të provuar gjendjen faktike të përshkruar si në aktakuzë. Andaj, nga të lartcekurat gjykatës i propozojmë që ndaj të mbrojturit tim të shpall aktgjykim lirues në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPP-së.

I akuzuari D K, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, të gjitha shkresat e lëndës flasin më shumë për fjalën time përfundimtare, dhe ajo është që unë në këtë çështje juridike jam i shtyre me dhunë me forcë, nuk do te doja të deklaroja më shumë vetëm te shtojë që jam personi dhe shumë here e kam cekur gjatë kësaj procedure penale se nuk jam personi i arrestuar por vet jam lajmëruar në IPK. Fjalët e mija nuk bazohen vetëm ne fjale mirëpo kam edhe prova materiale, me datën 28 kur është kryer aksioni i arrestimeve gjatë ditës, në mbrëmje kam punuar në ndërrimin e natës dhe këtë deklaratë e kam dhënë me 01.07.2019, në seancën për mbajtjen e paraburgimit. Në seancën e kaluar e kam dhënë një deklaratë të shkurtër në bazë të një letre të gjetur gjatë bastisjes së shtëpisë që jam lajmëruar Kapiteni Fejzullah Tara. Atë çka e kam cek deri më tani e ka vërtetuar edhe Bosko Janicijevic-dëshmitari. Ndërsa sa i përket hetimeve kanë marrë pjesë Nexhat Nikolli dhe Albert Emini policet e Departamentit të njësisë hetuese. Sa i përket hetimeve te tyre e kemi ligjin e IPK-se, i cili thotë “*kush mund te beje hetime kundër zyrtareve policor*” njëjtë e ka vërtetuar edhe ne KTV emisioni 60 minuta kompetencat e IKP-së, shefi i IPK-se Kushtrim Hodaj, cilët janë kompetencat ashtu që në rastin tonë dy zyrtare policor te përmendur nuk kane mundur ti zhvillojnë hetimet. Duke shtuar se sa i përket kryerjes se hetimeve se edhe ju si gjykatë keni parashtruar një pyetje

dëshmitarit N B, i cili ka qenë në cilësi të dëshmitarit të Z S dhe i keni bërë pyetje direkte: “ *kur e vëreni se zyrtari policor ka keqpërdorur autoritetin zyrtar kujt ia dorëzoni*, në të cilën dëshmitari Bektoshi ka thënë se ja dorëzojnë IPK-së në përgjigjen e dhënë. Duke e kundërshtuar në fjalën përfundimtare akuzën në tërësi nga ana e PSRK-së e cila e ngarkon, duke e konsideruar si të të pabazuar ka kërkuar lirim nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarës J D, Av.Asdren Hoxha, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se PSRK nuk ka sjellur në gjykatë prova të mjaftueshme materiale dhe personale për të vërtetuar me saktësi të plotë dhe pa asnjë mëdyshje se e mbrojtura ime ka kryer veprën penale që i vihet në barrë. Përshkrimi faktik në pikën III të aktakuzës lidhur me këtë veprë penale është i mangët, pa qartë të cili i mungon koha, vendi, mënyra e kryerjes së veprës penale aq më tepër nuk është cekur ekzistimi i marrëveshjes paraprake për të ekzistuar bashkëkryerja si edhe nuk është cekur se ku, kur dhe sa herë është kryer kjo veprë penale për të pretenduar në vazhdimësi. Po ashtu, nuk është bërë përshkrimi individual i të mbrojturës sime në aktakuzë e as që është përcaktuar roli i saj në bashkëkryerje, PSRK nuk e din e as nuk ka përshkruar veprimin inkriminues. Me rëndësi po ashtu mbrojtja shton faktin se nuk janë dëgjuar personat që i’u është mundësuar kontrabandimi i mallrave të ndryshme e që janë pjesë e përshkrimit faktik të aktakuzës, në rastin konkret si mund të thuhet se është vërtetuar një gjë e tillë pa i pyetur personat në fjalë se a i’u ka mundësuar e mbrojtura ime J D veprimin e përshkruar në aktakuzë apo jo. Konsiderojmë se pas tërheqjes nga ana e PSRK-së për pikën IV të aktakuzës i ka humbur kuptimi veprës penale të mbetur në pikën III të aktakuzës ngase në çoftë se nuk është vërtetuar marrja e ryshfetit atëherë si mund të qëndroj keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar. Tutje, mbrojtja ka shtuar se nga provat materiale të administruara përgjatë shqyrtimit gjyqësor shumica nga to nuk kanë asnjë relevancë për vërtetim të pretendimit të PSRK-së lidhur me të mbrojturën time, kurse sa i përket raporteve të përgjimeve-transkripteve të bisedave të cilat janë lexuar në formë të specifikimit si index për mbrojtjen janë të papranueshme për arsyet e dhëna nga mbrojtja edhe më herët që janë siguruar në kundërshtim me ligjin për policinë dhe IPK-në. Po ashtu, nga këto transkripte nuk vërtetohen elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar e mbrojtura ime gjë që është shume e rëndësishme. Ndërsa, nga provat personale tek dëshmitarët D1 dhe F2 ata në asnjë mënyrë në asnjë pjesë të deklaratës së tyre nuk e kanë përmendur të mbrojturën time ku nuk kanë dëshmuar që ajo nuk i ka kryer detyrat e saj dhe po ashtu dëshmitari Dushan Millosavljevic nuk e ka përmendur fare të mbrojturën time. Nga të lartcekurat si dhe në mungesë të provave të pamjaftueshme nuk mbetet asgjë tjetër përveç se të nxjerrin aktgjykim lirues për të mbrojturën time.

E akuzuara J D, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësi e të akuzuarit Z B, Av.Zehra Verbovci, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se nga ajo që është zhvilluar përgjatë shqyrtimit gjyqësor nga dëgjimi i dëshmitarëve, provave materiale, masat e fshehta, me asgjë nuk janë vërtetuar pretendimet e akuzës se i mbrojturi im ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nën par.2.2 dhe me nenin 81 dhe 31 të KPRK-së. Konsiderojmë si mbrojtje se prokuroria në këtë

çështje penalo juridike ka dështuar në sigurimin e provave të besueshme për të bazuar aktakuzën, mungojnë përgjigjet në pyetjet se si vërtetohet fakti se Z Bka keqpërdorur pozitën apo autoritetin zyrtar dhe se cilët dëshmitar dhe prova materiale e bazon PSRK aktakuzën. Tutje, mbrojtja ka shtuar se i gjithë boshti i aktakuzës kundër të mbrojturit tim është i mbështetur vetëm e vetëm në spekulime, pretendime dhe trillime të pabazuar, paargumentuara dhe të paartikuluara po ashtu mbrojtja konsideron se nuk ka mundësi që Z Btë ketë kryer veprën penale për të cilën ngarkohet me aktakuzën. Për të mbrojturin tim PSRK nuk ka asnjë provë bindëse se i njëjti është i përfshirë në kryerjen e veprës penale, andaj nga gjykata kërkohet që në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK-së të merr aktgjykim lirues me të cilin i mbrojturi im Z Bshpallet i pafajshëm lidhur me akuzën ngase me asnjë provë nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari Z B në fjalën përfundimtare: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk e ndiej vetën në mënyrë absolute fajtor dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësi i të akuzuarit A P, Av. Vehbi Beqiri, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka dekaluar se nga ajo që është prezantuar në këtë çështje penale, provat materiale dhe thëniet e dëshmitarëve me asgjë nuk është vërtetuar pretendimet e akuzës në këtë lëndë penale lidhur me të mbrojturin tim A P. Me rastin e hetimeve lidhur me aktakuzën e cila është objekt shqyrtimit i kësaj gjykatë nuk janë përmbushur obligimet nga neni 7, 101 dhe 257 të KPP-së e as obligimet që dalin nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 6) dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 31), nga se edhe pse kishte dëshmi dhe dëshmitar të cilët e mbështesin atë se i akuzuari A P nuk kishte keqpërdorur pozitën apo autoritetin zyrtar që kryesisht bazohen në deklaratën fillestare të dëshmitarit bashkëpunues i cili për përfitime të veta duke dashur që të përfitoj pozitën më të volitshme në procedurë kishte deklaruar të pavërteta të cilat më vonë i njëjti kishte mohuar në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor. Tutje, mbrojtja ka shtuar se provat material të propozuara si në aktakuzë nuk mund të shërbejnë si bazë për aktgjykim dënues e në veçanti me rastin e hetimeve lidhur me aktakuzën e cila është objekt shqyrtimi nuk janë përmbushur obligimet ligjore, ngase nuk janë specifikuar detajet lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet. Provat me të cilat është ngritur aktakuza janë të papranueshme dhe atë nuk e mbështesin dyshimin e paraqitur në aktakuzë as në deklaratimet e tyre në fazën paraprake e as në shqyrtim gjyqësor, deklaratat e dëshmitarit anonim D1, dëshmitarit anonim F2, dëshmitarit D M, D Gj, B M në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues, Z B në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues i cili ka hequr dorë nga cilësia e dëshmitarit bashkëpunues shihet se të gjitha deklaratimet janë marr pa aktvendimin mbi fillimin e hetimeve në kundërshtim me nenin 104 të KPP-së. Po ashtu, transkriptet nga përgjimi në zyrën e SPMK-Zubin Potok nga data 17.02.2019 deri me datë 13.03.2019 janë marr pa aktvendim për fillimin e hetimeve të parapara me nenin 104 të KPP-së. Nga dëgjimi i dëshmitarëve të prokurorisë në shqyrtim gjyqësor asnjëri nga ta nuk e ka përmendur apo përfshir të mbrojturin tim A P në ndonjë aktivitet të kundërligjshëm. Andaj, nga të lartcekurat mbrojtja ka propozuar të në kuptim të dispozitave të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPP-së ndaj të akuzuarit A P të shpallet i pafajshëm lidhur me akuzën, nga se nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale.

I akuzuari A P, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësin tim dhe e ndiej vetën të pafajshëm, po ashtu nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësi i të akuzuarit Z R, Av.Zhivojin Jukanoviq, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se PSRK me aktakuzën ndaj të mbrojturit tim nuk ka arritur të vërtetoj me asnjë provë materiale apo personale se i njëjti ka qenë i përfshirë apo ka kryer veprime inkriminuese që përbëjnë vepër penale ashtu sic akuzohet nga organi i akuzës. Për më tepër i mbrojturi im përveç që nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet i njëjti ka qenë i dekoruar me mirënjohje të ndryshme për punën e tij, i njëjti përgjatë punës së tij ka marr kërcënime të ndryshme dhe i'u janë djegur dy automjete. Tutje, mbrojtja ka theksuar se nga analizimi i aktakuzës i mbrojturi im është përmendur 29 herë ndërsa nuk është përshkruar në asnjë pjesë se cili është veprimi inkriminues i të njëjtit, aktakuza nuk përmban elementet e nevojshme të cilat i parasheh KPP, andaj në kuptim të kësaj gjykatës i propozojmë që ndaj të njëjtit të gjykata të merr aktgjykim lirues në mungesë të provave në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPP-së.

I akuzuari Z R, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe dëshiroj të shtoj se dua të precizoj disa gjëra sa i përket provave materiale të cilat i kam përgatitur në një dosje që ua dorëzoi juve dhe prokurorit dhe unë do ti lexoj si dhe ju do ti analizoni. Në atë dosje janë 106 dokumente të njëjtat si tek unë edhe tek prokurori. Jam arrestuar 5 muaj më vonë nga policët tjerë të Kosovës, unë dhe N dhe jemi arrestuar në bazë të marrëveshjes nga ish-prokurori Sylë Hoxha. Do të thotë sepse kapiteni Z S ka dhënë deklaratë në disa raste dhe prokurori Sylë Hoxha ka tentuar që të shkarkoj për shkak atyre deklaratave që ka dhënë, aty është kryer një mrekulli që të lëshohet niveli i përgjegjësisë në team leader (shefat e ndërrimit). Në dosjet e juaja ekziston dokumenti me datën 13.08.2019, ku kapiteni Z S thotë: “ka qenë një korrespondencë ndërmjet nesh dhe shërbimit inteligjent” Z S ka shënuar: “kam harruar edhe ta theksoj si mundesh ti në kundërshtim me ligjin të punosh në PPS në Zubin Potok dhe kush të ka dërguar të punosh këtu me GPT - Jarinjë që ke marrë vendim për zhvendosje në administratën në Luzhan, dhe kush ty të ka mundësuar të punosh në Zubin Potok ku unë jam komandant e që nuk je në sistemin e pranimit dhe që unë të të udhëheq apo ti bëj oraret e pushimit vjetor si dhe pastaj ti nuk ki “prijme sistem” të policëve, kurse, unë e bëjë punën tuaj edhe pse jam këtu komandant”. Askujt nuk i ka shpjeguar pse është dashur ai të punoj, e jo unë. Unë jam zëvendësuar, jam ndërruar nga Jarinja sepse kam kapur shpëlarje parave me vlerë milionëshe në një kamion ndërmjet Doganës së R-Kosovës dhe Serbisë dhe kanë qenë rreth disa milion dollar (një milion e 753 dollar për 63 kamion). Kamionët kanë nisur nga Kroacia mallin e kanë lënë në Serbi dhe e kanë lënë të zbrazët në Kosovë dhe e kanë larguar TVSH dhe të gjitha këto dokumente ia kam dorëzuar ish-prokurorit dhe në bazë të asaj është shënuar kallëzimi penal dhe më kanë ofruar 10.000 Euro që ‘ti marrë këto para dhe t’i lëshoj kamionët. Vetëm do t’a theksoj se janë arrestuar në bazë të manipulimit të prokurorit Sylë Hoxha në shkresat e juaja ekziston procesverbali në Policinë e Kosovës të cilin e ka lëshuar R K, ai ka dhënë deklaratë në regjionin e Jugut në Mitrovicë, me datë 05.07.2021, në ora 05:00 pasdite. Ai ka deklaruar se nën presion e ka dhënë deklaratën, ndërsa deklaratën që e ka dhënë për mua paraprakisht e ka tërhequr dhe unë në bazë të atyre deklaratave të rreme që i ka dhënë kam qenë i arrestuar si dhe me deklaratën e B Mt i cili ka thënë se ka qenë duke plotësuar egon e prokurorit, e kemi deklaratën tek ju dhe se kurrë më parë nuk kam marrë para dhe nuk është marrë me korrupsion. Unë, njësinë time nuk

e kam udhëhequr, e kam dorëzuar dokumentin, prandaj mbes pranë fjalës time, besoj në drejtësi dhe integritetin e trupit gjykues.

Mbrojtësi i të akuzuarit R K, Av.Isa Salih, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se konkluzionet e prokurorisë së shtetit mbi faktet e rëndësishme nuk rezultojnë të provuara nga provat e administruara në raport me klientin tim, andaj konsiderojmë se prokurori i shtetit nuk ka siguruar dhe prezantuar ndonjë provë që do të vërtetonte tezën e kësaj aktakuze në raport me të mbrojturin tim. Për më tepër, e njëjta aktakuzë është ngritur në bazë të pretendimeve të paqëndrueshme dhe jo mbi bazën e fakteve dhe argumenteve. Ndërsa sa i përket provave-përgjimeve që janë propozuar nga ana e prokurorit të shtetit të njëjtat janë marr në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe të njëjtat duhet të shpallen të papranueshme. Ndërsa sa i përket deklarimeve të dëshmitarëve të propozuar nga ana e prokurorisë dhe të cilët janë dëgjuar nga ana e gjykatës nuk është vërtetuar asnjë pretendim i akuzës për veprën penale e cila i vihet në barrë pasi që si të tilla janë kundërthënëse dhe jo kredibile dhe të paargumentuara dhe më e rëndësishmja se nuk kanë provuar asgjë në raport me të mbrojturin tim. Nga të lartcekurat mbrojtja ka kërkuar që të lirohet nga akuzat e akuzuarit R K për faktin se nuk ka elemente të veprës penale siç pretendon prokuroria e shtetit dhe kjo është vërtetuar me provat e administruara përgjatë shqyrtimit gjyqësor.

I akuzuari R K, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësja e të akuzuarit V T, Av.Mimoza Zabeli Sinani, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se PSRK nuk ka arritur të vërtetoj me prova bindëse se i mbrojturi im të ketë kryer veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par 1 lidhur me par.2 nën par.3.2 lidhur me nenin 81 dhe 31 të KPRK-së. Për më tepër dispozitivët e aktakuzës janë të përgjithësuar duke mos specifikuar veprimet konkrete individuale të kundërligjshme të cilat i mbrojturi im ka ndërmarr, përkatësisht kur dhe si ka veprua, cila ishte shuma e të hollave korruptive, nga kush I kishte pranuar këto të holla, konkretisht cilët ishin automjetet transportuese të cilat i kishte lëshuar në kundërshtim me detyrën zyrtare dhe kohën kur e kishte lëshuar këto automjete. Tutje, mbrojtja ka theksuar faktin se përgjimet e marra nga masat e fshehta janë pa dyshim prova të kundërligjshme dhe atë në përputhje me nenin 257 par.2 të KPP-së, pasi që aktvendimi për fillimin e hetimeve është i datës 04.09.2018 e as në zgjerimin e hetimit të datës 10.10.2018, nuk ka qenë i përfshirë i mbrojturi im V T, edhe pse në bazë të transkripteve të përgjimeve që posedonte PSRK ishte i njohur identiteti i të mbrojturit tim dhe ndaj të njëjtit ishin aplikuar masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit rreth 2 muaj pa aktvendim për fillimin e hetimit. Mbrojtja thekson se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht dëgjimit të dëshmitarëve dhe një mori provash materiale mbrojtja thekson se ka ardhur në përfundim se nuk është arritur që të vërtetohet se i mbrojturi im të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Andaj, konform nenit 363 par.1 nën par.1.3, gjykatës i propozojmë që ndaj të mbrojturit tim të merr aktgjykim lirues pasi që nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i mbrojturi im të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari V T, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: E mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësi i të akuzuarës B T, Av.Ali Rexha, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka deklaruar se PSRK aktakuzën ndaj të mbrojturës sime nuk e ka mbështetur në asnjë provë, për më tepër ndaj të mbrojturës sime në aktvendimin mbi fillimin e hetimeve e njëjta nuk është përfshirë fare e që sipas nenit 104 par.1 kusht esencial, hap fillestar është përpilimi i aktvendimit mbi fillimin e hetimit. Për më tepër mbrojtja thekson faktin se përgjatë hetimit janë bërë lëshime të tilla saqë janë urdhëruar masa të fshehta me NN, duke qenë i ditur se identiteti i të mbrojturës sime. Mbi bazën e asaj se procedura hetimore përmban të meta dhe shkelje ligjore për çka mbrojtja konsideron se do të ketë aktgjykim lirues ndaj të mbrojturës sime në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPP-së.

E akuzuara B T, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësi i të akuzuarit L V, Av.Srdjan Mitrovic, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar se të gjitha akuzat ndaj të mbrojturit tim kanë mbetur në nivelin e thashethemeve dhe asgjë më shumë. Mbrojtja thekson se L V është i pafajshëm, fajësia e tij nuk është vërtetuar dhe i vetmi vendim i drejtë i gjykatës është lirimi nga akuzat. Të gjitha premtimet e PSRK-së në fjalën hyrëse se do të vërtetohet fajësia e të mbrojturit tim kanë mbetur premtime boshe, prokurori thjesht nuk ka mundur të provoj fajësinë e klientit tim. Ligji parashikon se aktgjykimi duhet të bazohet në provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor siç përcaktohet me nenin 360 par.1 të KPP-së. I mbrojturi im akuzohet se ka marr ryshfet dhe si provë e pretenduar kundër tij është deklarata e tij e dhënë në prokurori dhe incizimi i bisedës së përgjimit. Mbrojtja në fjalën përfundimtare thekson disa parregullsi të procedurës që kanë ndodhur në vazhdimësi, siç janë, kompetencat e gjykatës nuk është dashur të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, por është dashur të aplikohet nenit 29 par.1 të KPP-së, ku vendi ka rezultuar të jetë diku tjetër dhe jo në Prishtinë, pra kompetente është dashur të jetë Gjykata Themelore në Mitrovicë. Tutje, mbrojtja sa i përket provave material, personale, të administruara përgjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar faktin se nuk është provuar asnjë element apo veprim inkriminues në raport me të mbrojturin tim. Andaj, në kuptim të kësaj nga të lartcekurat mbrojtja ka kërkuar që të merret aktgjykim lirues në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPP-së.

I akuzuari L V, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe konsideroj se absolutisht për asgjë nuk jam fajtor dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësja e të akuzuarit B M, Av.Fatlume Korqa-Sekiraqa, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar se i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë që nga deklarimi i parë dhe për shkak të besueshmërisë së të njëjtit nga PSRK është shpallur dhe dëshmitar bashkëpunues me kërkesë të prokurorit special. I mbrojturi im përgjatë çdo pyetje që është parashtruar nga ana e mbrojtësve është përgjigjur dhe ka treguar të gjitha që i njëjti ka ditur me qëllim që të zbardhet e vërteta përgjatë shqyrtimit

gjyqësor. Nga të lartcekurat gjykatës i propozojmë që ndaj të mbrojturit tim ti merr për bazë rrethanat lehtësuese që klienti im nuk ka asnjë precedent penal, sinqeritetin e tij dhe bashkëpunimin e tij në çdo fazë të procedurës, shpalljen e tij si dëshmitar bashkëpunues si dhe pranimin e fajësisë.

I akuzuari B M, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtëses sime dhe besoj në vendimin tuaj që do të merrni në fund, nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësja e të akuzuarit B L, Av.Predrag Miljkovic, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësor, ka theksuar se përgjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se PSRK nuk ka ofruar asnjë provë të vetme që do ta inkriminonte të mbrojturin tim në çfarëdo mënyrë për të mbështetur dyshimin e bazuar se ka kryer veprën penale. Përgjatë shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dëshmitar e mbrojtur D1 dhe F1 të cilët në deklaratat e tyre as nuk e kanë përmendur të mbrojturin tim, përmes dëgjimit të këtyre dëshmitarëve asnjëherë nuk është provuar aktakuza e PSRK-së. Tutje, mbrojtja ka elaboruar dëshminë e të akuzuarit B M i cili ka dhënë deklaratat kontradiktore i cili me dëshminë e tij nuk ka arritur të vërtetoj asgjë për të mbrojturin tim. Po ashtu, sa i përket provave materiale i mbrojturi im nuk ndërlidhet me asnjë provë të administruar përkundrazi vërtetohet se i mbrojturi im ka shërbyer me profesionalizëm. Meqenëse prokurori i shtetit është tërhequr nga marrja e ryshfetit i cili ka qenë dhe thelbi i gjithë aktakuzës dhe se për veprën penale të mbetur për Keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nuk ka asnjë provë që do të vërtetonte. Andaj, nga të lartcekurat gjykatës i propozojmë që për të mbrojturin tim të sjell aktgjykim lirues në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPP-së.

I akuzuari B L, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam çfarë të shtoj më tepër.

Mbrojtësja e të akuzuarit N G, Av.Musa Damati, në fjalën përfundimtare, ka theksuar se mbrojtja falenderon prokurorin e shtetit për qasjen profesionale në raport me të mbrojturin tim.

I akuzuari N G, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: dëshiroj të më kthehet dorëzania që më është caktuar lidhur me këtë rast dhe i përkrahi fjalët e mbrojtësit tim.

3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse të akuzuarit , nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë, gjykata për vërtetimin e gjendjeve faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve dhe administrimin e këtyre provave dhe atë;

- Dëgjimin e dëshmitarit bashkëpunues: B M;
- Dëgjimin e dëshmitarëve anonim: D 1 dhe F 2;
- Dëgjimin e dëshmitarëve: D M, F M, N B, V I, B J, O B.

- **Leximin e provave materiale, siç janë përshkruar dhe elaboruar, në pikën 3.3 tek pjesa e Provat materiale në pjesa e mëposhtme e këtij aktgjykimi.**
- **Të gjithë të akuzuarit, gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre ligjore janë mbrojtur në heshtje, nuk janë deklaruar gjatë fazës së mbrojtjes.**

3.1 Deklaratat e dëshmitarëve;

3.1.1 Dëshmitari bashkëpunues B M, në shqyrtimin gjyqësor të datave 08.12.2022 dhe 09.12.2022, ka deklaruar se: i kujtohet për deklaratën e dhënë në prokurori me datën 11.10.2019, duke shtuar se gjatë kohës sa ka punuar si zyrtarë policor kanë marrë shuma të caktuar të parave të cilat janë ndarë përmes shefave të ndërrimit Z R, zëvendësit të tij K S – tani i ndjere dhe B L dhe se orarin e punës e kanë përpiluar Z R dhe K S dhe ndonjëherë edhe Z S. Kur është bërë ndarja e parave që kanë marrë prej kontrabanduesve i njëjti ka qene prezent dhe se kryesisht paratë që i kanë marrë i kanë ndarë kryesisht ne veturë zyrtare, në ndonjë lokal-kafe ose jashtë kur kanë qenë në teren në fund të ndërrimit. Ndërsa tutje ka shtuar se i kujtohen si emra të kontrabanduesve të kenë qenë D I dhe vëllai i tij R I të cilët kanë kontrabanduar gjedhe-bika si dhe pije alkoolike dhe jo alkoolike dhe gjëra ushqimore si dhe vëllezërit M dhe M mbiemrat e të cilëve nuk i kujtoheshin të cilët merreshin me kontrabandimin e derivateve të naftës, pijeve alkoolike dhe jo alkoolike si dhe gjëra ushqimore, dhe shuma që kanë dhënë të njëjtit për kalimin ilegal ka qenë 50 Euro për kamion Sava, 30 Euro ka qenë për kombi, për cisterna të derivateve ka qenë 150 Euro, ndërsa për vetura ka qenë 15-20 Euro. Dëshmitari bashkëpunues B M gjatë deklaramit të tij ka theksuar se arsyeja që ka kaluar në keqpërdorim të detyrës zyrtare ka qene se në shtator të vitit 2017 janë sulmuar me armë automatike në automjetin zyrtar të policisë ku ka qenë edhe e akuzuara B N, si dhe J D, A H dhe D S, për shkak se një ditë më parë i njëjti kishte zënë kontraband në ndërrimin e ditës ndërsa në ndërrimin e natës është sulmuar, dhe rasti është iniciuar dhe se askush nuk është marrë me atë punë dhe përkundër kësaj komandanti Z e ka kthyer në vendin e ngjarjes ku ka ndodhur gjuajtja me armë, duke qenë viktimë e rastit e që është në kundërshtim me procedurën, dhe se askush nuk i kishte pyetur se si janë dhe si po ndjejnë veten, por vetëm kishin thënë se qenka dëmtuar vetura Toyota, dhe kjo kishte qenë arsyeja pse ai ishte shtyrë që të bëhej nga një polic i mirë në një polic të keq dhe të keqpërdor detyrën zyrtare e cila sipas tij ishte shumë e shenjtë, dhe po ashtu ka deklaruar se polici B L pasi që këta kishin diskutuar që me e rëndësishme qenka vetura se sa jeta e njeriut B i kishte thënë se ne kemi mundësi, të paktën sa jemi këtu me marrë pare. Po ashtu gjatë deklaramit të tij ka shtuar se njëri prej kontrabanduesve që ka kontrabanduar drunjtë të drunkosura në sasi prej 15 m kub për kamion solo 3AX, i cili ka bashkëpunuar me Z R, K S dhe B L, për të cilin ka theksuar se ka pasur raste që kur italkanit i'u kanë konfiskuar drunjtë për shkak se fletë përcjellje e cila ka qenë obligative për transportin e drunjtëve të drunkosura dhe ka pasur raste kur Z R dhe K S i kishin thënë që ta lëshojmë të njëjtin edhe pse s'ka qenë në rregull me dokumente, po ashtu edhe B L i cili kohëve të fundit kishte qëndruar shumë në kujdestari ku kanë punuar si zyrtar policor. Më tutje dëshmitari ka sqaruar përpilimin e orarit në fillim të ndërrimit, ku para përpilimit të orarit shumë herë përmes telefonit 064 të cilin e kishte bartë K S, B L, të cilët paraprakisht e kishin informatën se në cilën orë vijnë dhe kush vjen prej kontrabandistëve, dhe nëse nuk kanë pasur informatë paraprake ishte lënë mundësia që 2 ore patrullimi në fshatin Banjë e cila ishte arteria kryesore e kontrabandës dhe pas dy orëve ishin tërheq në zona të tjera dhe është përcjellë tereni se kush po

hyn për me dit sa të holla me ju marrë. Tutje, ka shtuar se shpesh K S i ka thënë që nuk është lajmëruar askush, dhe në koordinim me Z R dhe B L i kanë tërhequr në pjesë të tjera për të qenë më pak të informuar se çka po ndodhë dhe shpesh here kishte ndodhë që Z R me B L, nuk i kishin treguar se është përdorur rruga që vjen prej Leposaviqit që ishte zona e tyre e përgjegjësisë gjegjësisht rruga që ishte për Zveçan ku ka qenë rreth 40 km në pjesën tjetër që ishte shume larg prej orarit të cilin e kishin përpiluar d.m.th. ishte si zonë e harruar, jo decidivisht pa qëllim. Shuma që kryesisht kishte fituar ai, Z R, B L dhe K S kishte qenë përafërsisht 80 Euro në ditë, por ka pasur ditë që nuk kanë përfituar asgjë se nuk janë marrë me ndonjë rast apo nuk e kanë ditur se a ka kaluar diçka apo jo, dhe kryesisht ajo shumë që ishte fituar ishte ndarë në 4 pjesë dhe sipas tij një shumë ishte ndarë si sfond për ta dërguar në drekë Z Sin ne restorant “Vita” ne Zveçan. Sa i përket të akuzuarit L V ka deklaruar se nuk ka marrë ryshfet dhe mendon se është viktimë e sistemit sepse ky person ishte i shkolluar dhe ka pasur një sjellje njerëzore si në raport me qytetarët ashtu edhe me kolegët, dhe ka qenë neutral dhe nuk ka qenë i involvuar në këto punë dhe kohëve të fundit bashkëshorten e kishte të sëmurë me kancer dhe ka evituar me dal në teren, dhe në pyetjen e prokurorit se: *“ne deklaratën tënde të dhënë me datë 11.10.2019 për të cilën më herët ju pyeta a keni njohuri për çka e konfirmuat, me lejen e Ktgj-së ju ve ne dijeni duke ju ballafaquar se ne deklaratën e juaj ne faqen 6 të kësaj deklarate kur jeni pyetur ne lidhje me personin L V keni konfirmuar se ky person ka marrë te holla dhe këtij personi i kane lënë kontrabandistet ne pompën e derivateve dhe po ashtu ka marrë para ne dyqanin e M R, tani po thoni ndryshe a mund ti thoni gjykatës pse po bëni këtë ndryshim të deklaratës”* i njëjti është përgjigjur se: *“deklaratën që e kam dhënë për personin ne fjalë e kam dhënë për frustrim personal vetëm pse kam pasur frustrim ndaj tij dhe jo që kam pasur ndonjë prove ose që ka qenë i involvuar as ky as B e as V T dhe këta kanë qenë vetëm numër ne ndërrim që nuk i ka pyetur askush”*. Ka shtuar se është në dijeni që N G të ketë marrë ryshfet prej punëtorit N me nofkën N i cili ka qenë punëtor i M dhe M R, dhe i kujtohet të ketë marrë nga ai 50 Euro pasi që ai kishte kaluar me kamion me pije dhe e kishte parë pasi ai ishte dikund 3-5 metra larg tij, për të cilët ka deklaruar se kanë qenë kontrabandiste të njohur, ndërsa për të akuzuarin B N ka deklaruar se nuk ka dëgjuar dhe nuk ka parë që më u bind që është e involvuar, dhe po ashtu edhe për R Kn ka deklaruar se ai as nuk është llogaritur që është në ndërrim. Ndërsa sa i përket deklaratës së tij të dhënë në prokurori me datë 10.11.2019, i njëjti ka deklaruar se ndryshimet që i bënë sot në deklaratë i bënë për shkak të vërtetës dhe se është plotësisht i vetëdijshëm kur thoshte se për veti ka marrë dhe e di për pasojat që do të bartë dhe se të tjerët nuk po i hjek prej këtij rasti për shkak të frikës ose që i dhimbsen por vetëm për shkak të vërtetës, dhe se në prokurori kishte deklaruar ashtu për të përmbushur egon e ish prokurorit special pasi që pyetjet e tij ishin sugjestive dhe paraprakisht ishin diskutime e pastaj pyetje. Ndërsa sa i përket çështjes së lajmërimit të kontrabandimit i njëjti ka deklaruar se ka komunikuar direkt me shefin e njësisë dhe i ka treguar se si po funksionojnë gjërat në Veri dhe ka shkëmby emaila me ta, mirëpo nuk ka pasur adresë të duhur në të cilën kishte guxuar që të deklaroj se çka po ndodhë dhe se askush nuk kishte kontaktuar me ta që të pyesin dhe të diskutojnë me ta se çka mund të ndryshojnë këta si zyrtar policor që të jenë më të suksesshëm për të parandaluar kontrabandën. Tutje në dëshminë e tij ka shtuar se sa i përket të akuzuarit Z R, ka pasur raste që kur ka qenë në ndërrimin me të, kanë pranuar para dhe atë nga D I dhe se ato para i kanë ndarë mes vete dhe shumicën e punëve i ka kryer përmes të ndjerit K S, dhe se paratë kanë shkuar ose te K ose te B këta dy lojtar kanë qenë, që kanë marrë para si ndërrim, dhe po ashtu ka deklaruar se para të akuzuarit Z R i kishte dhënë edhe italyani, dhe për këtë punë janë marrë vesh përmes sms ose mesazheve, dhe për këtë kishte

qenë vet prezent i akuzuari B M. Ndërsa para se të ndodhte sulmi ku kishte qenë në ndërrim me Rreshteren B N, kolegu M M, kolegu D S, J D, H F dhe A Pnuk kishte vërejtë se në këtë grup ka pasur aktivitete kriminale kontrabandë ose diçka.

3.1.2 Dëshmitari **anonim D1**; gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 10.02.2023, ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë me datë 04.04.2019. Ka shtuar se komandant i stacionit policor në Veri në pjesën e kufirit ka qenë Z S dhe se ekipet janë udhëhequr nga B N, O K, N G dhe Z R. Tutje, ka shtuar se gjatë vitit 2017-2019, ka pasur raste të kontrabandimit të mallrave në pjesën veriore dhe për të funksionuar kjo, në vendet ku kanë punuar si në Zubin Potok, Banjë dhe Bube, fillimisht është bërë ndryshimi i grupeve ku ishin caktuar kanë bërë ndryshimet e thirrura barrikada dhe këto ndërrime më shume janë bërë në Stacionin Policor në Mitrovicë dhe në kontrabandimin e mallrave janë përfshirë zyrtarë policor pandihmën e të cilëve nuk do të mund të kryhej kontrabanda dhe se ky kontrabandim ka ndodhur pothuajse në të gjitha ndërrimet përveç në ndërrimin e G nuk ka qenë e njëjtë dhe sipas dijenisë se tij nuk ka ndodhur diçka në këtë ndërrim, dhe forma e bashkëpunimit ka qenë përmes telefonit mobil, d.m.th. telefona të veçantë dhe këta telefona i kanë pasur në posedim udhëheqësit e ndërrimeve, ku patrullat tërhiqeshin pasi që dikush thirrte në telefon dhe thoshte se dikush duhet të kaloj, kontrolla tërhiqej dhe kontrabandimi kryhej ashtu siç planifikohet, ndërsa sa i përket tarifave për kalimin ilegal të mallrave ka theksuar se nuk e di me të vërtetë, por sa kishte informata kane qenë nga 50 Euro dhe 30 Euro dhe këto para janë marrë nga shefat dhe udhëheqësit e ndërrimeve, dhe ka ekzistuar një tarifë ditore që është paguar për komandantin e cila ka qenë 50 Euro sipas ndërrimeve, dhe këto para i'a kanë dhënë komandantit shefat e ndërrimeve dhe pastaj i kanë ndarë edhe me policët patrullues dhe këto para kryesisht janë dhënë vetura janë lënë në market në pompa të benzinës. Sa i përket të akuzuari Z S, dëshmitari ka deklaruar se nuk e ka parë që të ketë marrë para, mirëpo ka dëgjuar se i njëjti ka marrë para. Sa i përket të akuzuarës B N, dëshmitari anonim D1 ka deklaruar se e akuzuara B dhe kolegët e saj i mblidhnin dhe i dërgonin në rrugë në Qeqev, kurse ajo mbetej në fshatin Banjë dhe pasi që kalonin kontrabandistët ajo mblidhte paratë nga ata dhe në fund të ndërrimit i ndante me ata nga 10, 20 ose 30 Euro, e ndonjëherë thoshte se nuk ka asgjë për të ndarë dhe kjo zakonisht ndodhte në fund të ndërrimit gjatë kthimit me veturë nga Zubin Potoku deri rrugës në stacionin policor ne Veri, ka shtuar se ai nuk e ka parë që të këtë marr para personalisht nga kontrabanduesit, por se në fund të ndërrimit ato para i ndante me ata. Tutje, ka shtuar se është e vërtetë që komandanti ka kërkuar mi dhënë mjete dhe i kujtohet kur ti këtë thënë e akuzuara B, që do të shkojë tek komandanti dhe ti dërgojë para, këtë nuk e kishte parë vet por se këtë gjë ia kishte thënë vet e akuzuara B, se do të vepronte kështu dhe aty kanë qenë prezent edhe policët e tjerë, mirëpo emrat e tyre nuk i kujtoheshin pasi që kishte kaluar kohë e gjatë. Sa i përket të akuzuarit Z R, dëshmitari ka deklaruar se nuk kam dëgjuar asgjë, kanë qenë disa thashetheme që i njëjti ka marrë mito ose para, por për këto ai nuk iu ka besuar dhe nuk ju beson. Tutje, gjatë dëshmisë së tij ka shtuar se prej të akuzuarve të cilët janë të ngarkuar me këtë aktakuzë e të cilët i njeh, para prej kontrabanduesve pohon të këtë marr e akuzuara B N, vendi nuk i kujtohet se ku dhe se personalisht nuk e kishte parë por sa ka qene ne patrulle me ta, ajo ka dalë nga vetura dhe ka marrë para nga kontrabandues të ndryshëm.

3.1.3 Dëshmitari **anonim F2**, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar të datës 10.02.2023, fillimisht ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë me datë 17.12.2019, duke shtuar se gjatë vitit 2017-2019, ka pasur raste të kontrabandimit të mallrave nga Serbia në Kosovë dhe

anasjelltas ku kryesisht është zhvilluar në fshatin Bube si dhe rrugë të tjera ku kontrabanduesit kanë shkuar nga R dhe kanë ardhur ne fshatin Bube dhe ky kontrabandim është bërë përmes policisë nëpërmjet telefonave mobil se ku dhe kur do të kaloje kontrabandimi të cilët telefona i kanë poseduar udhëheqësit e ndërrimeve por ka pasur raste që i kanë pasur edhe policët dhe paratë janë lënë kryesisht në pompa të benzinës si dhe në lokale-shitore dhe ka pasur disa tarifa për kalimin e mallrave, në fillim ka qenë 15 Euro për automjete kombi, për kamionët blegtorisë apo shtazëve ka qenë 25 Euro, ose për kamionë të mallrave të ndryshme ka qenë 25 Euro, ndërsa më vonë ka ndryshuar për kamionë është bërë 50 Euro, për kombi 20 Euro, për mauna të derivateve ka qenë 80 Euro, ku këto para i janë dhënë në disa raste policëve, në shumicën e rasteve janë lënë në lokalit në Zubin Potok i cili ka qenë i kontrabanduesit me emrin M, emri i lokalit nuk i kujtohej, ndërsa ka deklaruar se për komandantin ka ekzistuar tarifë e veçantë e cila ka qenë mujore dhe shuma ka qenë në fillim 500 Euro, mandej është bërë 700 Euro. Ndërsa, sa i përket të akuzuarit D K, ka deklaruar se ka njohuri se i njëjti ka poseduar një lokal i cili ka qenë afër një pompe të vogël të benzinës, i cili ka pasur të vendosura kamera brenda dhe jashtë lokalit të cilat kane qenë me shikim nga pompa dhe kur ka parë se kush ka kaluar me vonë ka shkuar dhe i ka marrë paratë të cilat i kanë lënë kontrabanduesit dhe ka shtuar se këtë nuk e ka parë më sytë e tij por ka dëgjuar nga ndërrimet e tjera nga policet e tjerë. Dhe në fund ka shtuar se për të akuzuarin Z R asnjëherë nuk kam thënë për Z R e as nuk kam parë që i njëjti të ketë marrë para nga kontrabanduesit dhe se nuk e ka parë të ketë shpërndarë para me udhëheqësit e ndërrimeve. Ndërsa, sa i përket të akuzuarës B N, dëshmitari anonim F2 ka deklaruar se që i ka dhënë para komandantit nuk e kam parë por që i ka mbledhur pare (mjetet) prej kontrabanduesve po, dhe atë prej Q, është marrë nga M B, janë marrë nga B, janë marr nga M, janë marrë nga K. Këta kane qenë kontrabandues dhe nga ta janë marrë para dhe shuma ka qenë rreth 300 Euro për një ndërrim dhe nuk ka qenë vetëm për Biljanen, por ajo shumë është ndarë edhe për neve ka deklaruar dëshmitari dhe kryesisht mallrat që janë kontrabanduar kanë qenë pije alkoolike, naftë, miell, mallra teknike, shtazë, pula etj.

3.1.4 Dëshmitari **DM**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 31.01.2023, ka deklaruar se në policinë e Kosovës është kyçur në vitin 2014 ne Stacionin Policor në Leposaviq, pastaj në vitin 2015 në njësinë intervenuese në Mitrovicën e Veriut, ndërsa në vitin 2016-2017 pikën kufitare në Zubin Potok. Tutje, ka theksuar se fillimisht ka punuar në ndërrimin A ku udhëheqëse ka qenë B N, pastaj në ndërrimin C ku shef ka qenë Z R, dhe në ndërrimin D ku shef i ndërrimit ka qenë N B, ku detyra e tyre ka qenë mbikëqyrja dhe kontrollimi i pikave kufitare dhe ka shtuar se kur ka pasur kalim të mallrave ilegale këto i kanë parandaluar, i kanë lajmëruar dhe i kanë sanksionuar dhe kryesisht sa i kujtohej kanë qenë gjëra ushqimore. Tutje, ka shtuar se nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi me rastin e kalimit të mallrave nga Republika e Serbisë ne Republikën e Kosovës, dhe se edhe pse kryesisht ka punuar në ndërrim vetëm me të akuzuarin N G, i cili ka qenë udhëheqës i ndërrimit D, nuk ka pasur ndonjë vërejtje në punën e tij dhe nuk ka vërejtur nëse i njëjti është përfshirë në ndonjë veprimtari të kundërligjshme dhe se kryesisht kanë punuar sipas orarit dhe se nuk ka vërejtur që të jenë përdorur telefona te veçantë me te cilët kanë komunikuar policet e kufirit për të iu ndihmuar kontrabandistëve për kalimin e mallrave ilegale dhe se në ndërrimin ku ka punuar i njëjti nuk ka pasur telefona të veçantë dhe se nuk ka dëgjuar që të ketë pasur tarifa për kalimin e mallrave ilegale, dhe se nuk kishte njohuri nëse ndokush nga zyrtarët policor apo udhëheqësit e ndërrimeve kanë poseduar depo të mallrave në brezin kufitar.

3.1.5 Dëshmitari **F M**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 06.03.2023, ka deklaruar se të akuzuarin **Z S**, e njeh që nga viti 2007, dhe sipas mendimit të tij personal mendon se i njëjti ka qenë korrekt si ndaj zyrtarëve policor, ashtu edhe për çdo mbikëqyrës dhe ndaj çdo qytetari. Ndërsa sa i përket udhëheqjes operative ka shtuar se ai nuk është kompetent për të vlerësuar një gjë të tillë, mirëpo sa i përket anës së komandimit nga ana e të akuzuarit **Z** ka qenë korrekte dhe edhe pse nuk ka qenë përgjegjësi e tij që të dalë në teren mirëpo ka ndodhur që te jetë ftuar i akuzuari **Z** dhe së bashku kanë dalë në teren, por jo edhe shpesh për shkak të problemeve shëndetësore që kishte pasur dhe vetëm kur nuk ka pasur polic ai ishte detyruar që të dalë në teren, përndryshe ai kishte punuar në administratë dhe logjistike, dhe ka shtuar se është e vërtetë që kemi pasur mungesë të objektit, automjete nuk kanë pasur dhe ato që i kanë pasur kanë qenë me defekt dhe kryesisht kanë qenë 10-12 zyrtare dhe disa kanë qenë në detyrë disa në pushim dhe rrallë herë ka ndodhë që të formohen dy ekipe për patrullë për shkak të mungesës së zyrtarëve policor. Ndërsa, sa i përket asaj se a ka pasur raste më shumë para arrestimit të akuzuarit **Z** apo pas arrestimit, i njëjti ka shtuar se pas arrestimit të tyre struktura ka ndryshuar, etniteti i policëve ka ndryshuar, kanë ardhur polic që terrenin nuk e kanë njohur dhe raste ka pasur shumë më pak dhe kohëve të fundit prapë ka raste mirëpo kufiri është më i sigurt dhe ka njësi më shumë. Tutje, ka shtuar se ka pasur disa raste që kanë shkuar për ta marrë në shtëpi komandantin **Z** dhe se i kujtohej që një ditë kanë shkuar që të marrin në shtëpi komandantin për shkak se i njëjti i kishte thirr për ta marrë dhe për ta dërguar në Zveçan sepse kishte marrë disa mesazhe në viber apo rrjet direkt që i kishte thënë dikush se nuk po më lëshon një njësi e trafikut për me kalua me mall diçka, dhe se a mundem me kalu, ky i'a kishte kthyer se a mundesh me tregu se kush je ngase unë s'po ju njoh as juve as pse mu ke drejtuar, as numri i kujt është dhe a po e din kujt je tu i shkru, dhe sa më kujtohet kështu i'a ka kthyer mesazhin kjo ka qenë përgjigja që kishte marrë në atë kohë nga **Z** dhe të njëjtin e kemi dërguar në stacionin e rendit në Zveçan për me hap rast nga një numër që nuk e dinte edhe ai kush ishte dhe se nuk kishte lidhje me rastin në fjalë për mesazhet që i kishin ardhur. Tutje, ka shtuar se sa i përket njohurive të tij nuk kishte parë asnjëherë ose nuk kishte vërejtur se i akuzuari **Z** të jetë shoqëruar me persona të dyshimtë apo të ketë marrë para prej dikujt për aq kohë sa ka qenë dëshmitari prezent dhe po ashtu edhe për të akuzuarit të cilët janë të ngarkuar me këtë aktakuzë ka deklaruar se nuk ka njohuri që ndonjëri prej tyre të ketë marrë apo nuk i ka parë të kenë marrë para. Ndërsa, sa i përket sistemit të tij thekson se ka punuar në ndërrimin e **N**, mirëpo në atë kohë sa i kujtohet nuk ka dalë në teren ose ka dalë një herë ose dy jo më shumë se ka pasur probleme shëndetësore. Ndërsa, sa i përket tarifave për kalime ilegale të kufirit ka deklaruar se nuk ka njohuri dhe se ka dëgjuar nga kolegët ndonjëherë që kanë biseduar mes vete, por personalisht nuk kishte njohuri ngase më shumë kishte punuar në administratë.

3.1.6 Dëshmitari **N B**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 06.03.2023, ka deklaruar se të akuzuarin **Z S** e njeh që nga viti 2005 dhe i njëjti ka qenë komandant i tij dhe ka shtuar se i njëjti ka qenë i barabartë me të gjithë qytetarët, punonjësit apo zyrtarët policor dhe shefat e ndërrimeve që kanë punuar aty. Tutje, ka shtuar se gjatë punës së tyre kanë pasur edhe kërcënime gjatë luftimit të kontrabandimit dhe ka pasur raste kur edhe janë sulmuar dhe janë lënduar për të cilat probleme ka theksuar se i akuzuari **Z** i ka raportuar në mbledhjet që i kanë pasur me zyrtarët e EULEX-it. Ndërsa, sa i përket shtëpisë së banimit të të akuzuarit ka shtuar se rastet kur i ka rënë që të dërgojë të akuzuarin **Z** në shtëpinë e tij e ka parë që shtëpia e tij është shtëpia e vjetër e ndërtuar prej druri ku i njëjti ka banuar bashkë me vëllain e tij në atë shtëpi, dhe shpesh herë në

biseda me kolegët ka shtuar se kemi bërë hajgare se si deri tani nuk ke shtëpi, banesë apo veturë tënden. Tutje, dëshmitari ka shtuar se stacioni policor ne Zubin Potok shumicën e rasteve ka qenë një veturë atu, mirëpo ka pasur raste dhe kur kemi mbetur pa asnjë veturë pasi që kanë qenë të vjetra dhe se ka pasur raste kur ka pasur me shku komandanti diku e kemi marr veturën e patrullës në teren e kemi dërguar komandantin dhe pastaj e kemi kthyer veturën. Ndërsa, kemi kërkuar në zinxhirin komandues në Prishtinë që të na sigurohet veturë për ti mbuluar rrugët ilegale që kanë qenë pasi që nuk kemi pasur veturë për ti mbuluar rrugët ilegale si dhe magjistralen pasi që kjo ka qenë e tjetër kujt dhe nuk kemi mund me kontrollua se kemi pasur vetëm një patrullë. Tutje, dëshmitari ka shtuar se sa ka qenë stacioni nën komandën e Z ka pasur rezultatet të mira deri 48 raste brenda vitit dhe se ka pasur raste të mëdha të kalimit të kontrabandimit, tregti e ndaluar që nuk ka pasur prejardhje malli dhe raste të tjera të ngjashme. Dëshmitari, tutje ka deklaruar se me komandantin dhe kolegët tjerë kemi dal shpesh ne inspektim dhe patrullim dhe komandanti ka bërë plan taktik ku kemi vazhduar kontrolle nëpër male dhe kanë qenë disa rrugë që vetëm komandanti i ka ditur dhe nga atu kemi arritur me arrestuar edhe persona të dyshuar duke kontrabanduar mallra me vlerë prej 12-13 mijë Euro, ku kemi pasur dhe kontakte fizike me të njëjtit ku komandanti ka dalur dhe na ka mbrojtur, kemi pasur kërcënime prej kontrabandistëve që kanë qenë të rrezikshëm që më vonë e kam marr vesh se kush kanë qenë. Gjatë kësaj kohe kemi pasur dhe lëndime, unë personalisht kam marr lëndim të rëndë e kam pasur hundën e thyer, ndërsa Z ka qenë i goditur nga një shufër e hekurt, dhe po ashtu kolegu F M ka pasur lëndime në gjoks nga goditjet që ka marrë. Duke shtuar se njëri nga të dyshuarit është dënua nga gjykata e Zubin Potokut për sulm ndaj nesh. Tutje, dëshmitari ka shtuar se ka qenë një situatë shumë shqetësuese pasi që kam kuptuar se vëllau i gruas së kolegut tonë ka qenë njëri prej kontrabanduesve që na ka sulmuar, emri i tij ka shtuar se nuk më kujtohet por thekson se e di që ka qenë njëri prej kontrabanduesve të njohur në pjesën e Zubin Potokut. Tutje, ka shtuar se ka pasur fjalë që Z ka marr mito për të cilën pjesë unë nuk i di për askënd që ka marr mito. Dëshmitari, ka deklaruar se Z çdo herë ka mbajtur mbledhje me patrullat dhe udhëheqësit e ekipeve sa ka qenë në detyrë duke kërkuar vigjilencë në punë dhe shpesh herë nuk ka qenë i kënaqur me punën e tyre. Po ashtu se shumë herë Z kur kemi dal për të pirë kafe me kolegët dhe kur janë paguar kafetë i ka pyetur kolegët se a janë këto para të rrogës apo ndonjë aktivitetit tjetër dhe se shpesh ka thënë se nëse gabon me marrë dikush ose me pagur unë e marr vesh, ka qenë ky muhabet e mbaj në mend. Po ashtu, tutje ka shtuar se në shumicën e rasteve udhëheqësit e ekipeve i kanë bërë oraret e ndërrimeve mirëpo ndonjëherë kur e ka kontrollu komandanti orarin nëse nuk ka qenë ne rregull e ka ndryshuar dhe i'u ka dhënë veturën e tij për kontrolle dhe se e di që ka thënë komandanti se pa përfunduar ndërrimi deri të bëhet ndërrimi tjetër mos me leshu zonën se munden ta shfrytëzojnë të kalojnë në mënyrë ilegal. Duke shtuar tutje se shumicën e rasteve unë së bashku me kolegun F kemi qenë me komandantin dhe e kemi vozitë sepse shumë herë ka qenë i zënë dhe se unë kam qenë i caktuar me vendim tek Z R, por me punë kam qenë në logjistik në stacion. Tutje, ka deklaruar se lidhur me rastin videot i kam parë në kallxo.com mirëpo me mu nuk kanë biseduar në stacion por që kam dëgjuar prej njerëzve që po ndodhin po lëshojnë mall të kontrabanduar dhe se në rastet kur me patrullën i kemi zënë mallin e kontrabanduar të gjitha janë evidentuar. Dëshmitari ka shtuar tutje se secili që ka ditë diçka e ka njoftuar zinxhirin komandues dhe inteligjencën dhe se kanë marrur veprime dhe se sa i përket çështjeve të tjera ka theksuar se kam punuar në logjistik dhe në teren kam dal 5-6 herë dhe se e vërteta është se kam punuar në zyre të komandantit dhe jo në teren.

3.1.7 Dëshmitari **V I**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 06.03.2023, ka deklaruar se para nuk i kam dhënë askujt dhe as nuk i kam dhënë Z R dhe as B Mt dhe po ashtu ka shtuar se nuk e din faktin nëse i është montuar rasti Z R. Duke shtuar tutje se nuk jam kërcënuar dhe as nuk kam pasur presion nga askush. Ka pasur shumë herë raste kur më janë konfiskuar drutë pasi që nuk kemi pasur dokumentacion përkatës për ato dru dhe policia i ka konfiskuar dhe se me këtë punë merremi që moti kohë por nuk i kemi dhënë para askujt pasi që po ti kishim dhënë para ne kishim kalu dhe se ndonjëherë i kemi pasur letrat por ka mungu diçka dhe na janë konfiskuar drutë dhe se shtojë përsëri se nuk kam dhënë asnjëherë para.

3.1.8 Dëshmitari **B J**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 19.04.2023 ka deklaruar se është një lokal që pronar i së njëjtës është dëshmitari i cili ka qenë prezent me emrin O, ndërsa lokalin e njëjtë e kam pasur me qira dhe biznesi i shitjeve të gjërave të sanitarisë dhe gjësendeve të tjera për ujësjellës ka qenë i imi nga viti 2011 e deri kur ka filluar corona virusi nëse më kujtohet dhe se i njëjti lokal ka qenë afër një pompe të benzinës. Tutje, dëshmitari ka shtuar se i akuzuari K sipas kumbarës sime e njëjta më ka njoftuar se K qëndron në një listë për arrestim dhe më ka thënë që i njëjti të shkon në stacion policor që të shikon se për çka bëhet fjalë, duke shtuar se kemi shkuar në stacion unë, kumbara dhe vëllai i tij në Stacionin Policor në Mitrovicën e Jugut aty i kanë marrë në pyetje disa orë, mirëpo unë nuk kam pasur leje që të dëgjoj diçka aty gjatë deklarimit të tyre. Duke shtuar tutje që të pandehurin D e kam kumbar dhe kjo pjesë e kumbarisë ka vazhduar prej gjyshit tonë, dhe kjo ka vazhduar dhe kemi pasur raporte shumë të mira dhe se e kanë ditur Zubin Potoku pasi që është vend i vogël aty të gjithë njihen me njëri tjetrin dhe sigurisht që e kanë ditur. Duke shtuar tutje që D ndodhte që të vinte për vizitë tek lokali dhe zakonisht vinte pa uniformë dhe kemi pirë kafe aty tek një lokal afër kur kam pasur kohë dhe se në Zubin Potok e kanë ditur që lokali im ka qenë i kumbarës së D. Tutje, ka shtuar se kam pasur kamera në lokalin që unë e kam mbajtur biznesin mirëpo ato nuk kanë qenë të lidhura askund, nuk kanë funksionuar kjo vërtetohet përmes një ngjarje që ka ndodhur një aksident para lokalit tim dhe kur kanë ardhur policia mi kërkoi incizimet që të shihet se si ka ndodhur kanë hyrë dhe të njëjtit e kanë parë që nuk ka incizime pasi që kamerat kanë qenë të rrejshme, kjo ngjarje ka ndodhur diku në vitin 2014-2015 dhe çështja e kamerave jo funksionale ka vazhduar deri në vitin 2019.

3.1.9 Dëshmitari **O B**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 19.04.2023 ka deklaruar se jam nga Zubin Potoku dhe se është pronar i një lokali në rrugën magjistrale Zubin Potok si dhe lokalin e ka pasur me qira dëshmitari B J, ndërsa rreth çështjes se a është marrë D me ndonjë aktivitet tjetër përveç zyrtarit policor ka shtuar se sa kam njohuri i njëjti e ka punuar tokën dhe e ka mbjellë dhe se D nuk e kam parë në lokal vetëm gjatë kohës sa ka punuar në ara e kam parë të njëjtin. Duke shtuar tutje se lokalin me qera tani e ka në shfrytëzim S B dhe se më vonë e kam kuptuar faktin se B-shfrytëzuesi i lokalit ka qenë kumbara i D dhe se i njëjti e ka mbajtur lokalin me qera diku rreth 7 vite.

3.2 Provat materiale;

3.2.1 Nga leximi i raportit njoftues i policisë së Kosovës, i dt.18.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin e veprimeve hetimore të cilat i kishte ndërmarrë hetuesi policor në lidhje me rastin konkret.

3.2.2 Nga shikimi dhe dëgjimi i CD-ve dhe foto dokumentacionit në shkresat e lendes, gjykata ka vërtetuar faktin se në CD-të shikohet se janë të inxhizuara bisedat të cilat më pas janë transkriptuar dhe që janë elaboruar si në vijim, ndërsa nga shikimi i foto dokumentacionit shihen rrugët ilegale përmes të cilave kanë kaluar mallrat e kontrabanduara dhe shihen disa gjedhe që ishin ndalur në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

3.2.3 Nga leximi i transkriptit të datës 17.02.2019 ora 19:30:04, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut) , ishte incizuar biseda e zhvilluar biseda në mes të akuzuarve Z B dhe R M, nga e cila bisedë Z B theksonte se: *“Duhet me thirrë D sonte me i’a dhanë qato, a e thrrasim sonte”*. *Ashtu që R M i thotë” E thërrasim bre q.. n..”*.

3.2.4. Nga leximi i transkriptit të datës 17.02.2019 ora 19:33:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda e zhvilluar në mes të të akuzuarve Z B, R M dhe J D, ku ndër të tjera kanë biseduar Z B i cili thoshte se: *“Ia kam dhënë atë ditë, atë ditë në sabah që shkum me kerr i’a kam dhënë”*, ndërsa i akuzuari R M në bisedën theksonte se *“Edhe ti i’a ke dhanë n’sabab”*, ku i akuzuari Z B pohonte me fjalën: *“Po”*. Ndërsa J D në bisedë me të akuzuarin R M, deklaronte se *“Për mua ishin 50 dhe tre herë 10”*, nga e cila transkript vërtetohet se të akuzuarit Z B, R M dhe J D kanë marrë nga 20 Euro për person, dhe në këtë transkript të akuzuarit vetëm ishin dyshuar se 20 Euro kanë marrë edhe zyrtarët policer A P, B M-B, D S K si dhe D K.

3.2.5. Nga leximi i transkriptes së datës 17.02.2019 ora 20:17:24, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut) e akuzuara J D kishte biseduar me Bozidar Milosavljeviq-Boza ose D S (njërin nga këta), ku e akuzuara Durleviq pyet se në ndërrimin e kaluar a i’a ka dhënë paratë zyrtarit policor A P, sepse D-K-P po i kërkonte paratë e veta, e cila bisedë ishte vazhdimësi e bisedës së datës 17.02.2019, orës 19:33:38 ndërmjet J D, R Mit dhe Z B.

3.2.6. Nga leximi i transkriptes së datës 17.02.2019 ora 19:33:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda e zhvilluar në mes të akuzuarit Z B, R M dhe J D, ku e akuzuara J D thekson se: *“Ato në mëngjes, a ja ke dhënë”*, i akuzuari Z B përgjigjet: *“Po, po A ja kam dhënë, ja kam dhënë A paratë”*, dhe në bisedë e akuzuara deklaronte se B e A u’a kam dhënë 50, ata më kanë dhënë. Nga kjo bisede vërtetohet se biseda që është zhvilluara mes të akuzuarve për ndarjen e parave në mes të akuzuarve Z B, R M, J D, A P, R K.

3.2.7. Nga leximi i transkriptes së datës 17.02.2019 ora 20:36:19, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të akuzuarës J D dhe një personi të paidentifikuar dhe e akuzuara J D tregon që të akuzuarit R M i’a ka dhënë 80 Euro dhe këto të holla i kanë ndarë mes vete J D, A P, D S-K dhe B M-B.

3.2.8. Nga leximi i transkriptes së datës 18.02.2019 ora 15:55:42, dhe në intervale tjera gjatë asaj dite gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën

e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të akuzuarës B T dhe një personi të cilin e thërret Golle, me të cilin bisedon dhe i thotë se *“ato janë për mua, po të them, a po më dëgjon”* si dhe në bisedën në mes të akuzuarës B T dhe personit B L, nga e cila bisedë B T është caktuar që të qëndroj si kujdestare në bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të kufirit-Zubin Potok në Mitrovicë të Veriut,

3.2.9. Nga leximi i transkriptes së datës 25.02.2019 ora 19:44:21, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të akuzuarve R M – Ramce dhe zyrtarëve policor D K dhe A P, në të cilën bisedë flasin që të mos lëshojnë askënd (dyshohet për kamionë me mall) deri në ora 6 të mëngjesit.

3.2.10. Nga leximi i transkriptes së datës 26.02.2019 ora 19:01:03- 19:01:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes B L, M M, B M, B N, ndër të tjera e akuzuara B ju thotë të pranishmëve që *“nuk pranoj të ju mbrojt dhe të humbë punën, derisa lëshojnë kamionë dhe i marrin paratë”*.

3.2.11. Nga leximi i transkriptes së datës 26.02.2019 ora 21:46:31-21:47:36, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të B N, D V dhe A H, ku ndër të tjera D V tregon që është zënë kamioni i M, ndërsa ndër të tjera e akuzuara B N tregon që këtë kamion e ka lëshuar zyrtari policor K S.

3.2.12. Nga leximi i transkriptes së datës 26.02.2019 ora 21:49:11- 21:49:54, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të B N, N J dhe A H, ndër të tjera e akuzuara B N tregon për bisedën që ka pasur me B L, të cilit i ka thënë që nuk ka kolegialitet për derisa ata marrin para dhe në anën tjetër e njëjta me pas telashe, dhe ku e përmend K që i ka fut paratë në xhep.

3.2.13. Nga leximi i transkriptes të datës 26.02.2019, ora 21:54:10- 21:56:31, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të B N, N J, A H, D V dhe A M, ku zhvillohet biseda që D ka fol me D me numrin e tij të telefonit dhe për këtë arsye e akuzuara B N i'u thotë të pranishmëve që ta fikun telefonin dhe ta nxjerrin kartelën pasi që mund të lokalizohen.

3.2.14. Nga leximi i transkriptes të datës 05.03.2019, ora 19:45:30- 19:46:30, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të O K, B M dhe A P, të cilët kanë biseduar për situatën kur B M ka marrë para dhe për kamerën që ka pasur M, dhe për çështjen nëse kamera merr pamje video apo vetëm regjistrime audio, në bisedë e sipër pas pohimit nga A P se nuk ka kamera, i akuzuari B M theksonte se tash e kam më lehtë se sa herë kam hy dhe kam marrë para aty.

3.2.15. Nga leximi i transkriptes të datës 09.03.2019, ora 17:37:50- 17:39:00, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje-Zubin Potok në veturë (Defender 141-02), ishte incizuar biseda në mes të B N, A H dhe A M-A i cili gjate momentit të bisedës është dëgjuar duke fjetur, ndërsa e akuzuara B N bisedon me A H për shumën e parave që janë marrë nga kontrabanduesit e mallrave dhe sipas kësaj bisede këto para 200 Euro janë dhënë nga personat G, M dhe N, dhe është biseduar për të kaluar edhe diçka dhe nëse kalon bëhet 270 Euro, dhe A ka përmendur pas llogaritjes shumën nga 40 Euro.

3.2.16. Nga leximi i transkriptes të datës 09.03.2019 ora 19:20:45-19:28:00, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje-Zubin Potok në veturën (Defender 141-02), ishte incizuar në mes të A M dhe një personi NN G, dyshohet që G sjell 70 Euro tek vetura ku ishte A M në emër të M, ndërsa pastaj hyn A H, të cilët bisedojnë se si personi NN G I ka lënë vetëm 70 për M dhe jo 80 sa është dashur që ti lë. Ndërsa A H ka potencuar që i ka mbi 200 Euro të cilët bisedojnë për ti ndarë ndërmjet B N, A M, A H, D V dhe M M. Në bisedë po ashtu dëgjohen se këto para i kanë lënë kontrabanduesit e mallrave si: Guri, M R dhe personi me nofkën N.

3.2.17. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 17:34:35, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje - Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), është incizuar biseda në mes A M dhe M M, të cilët pastaj në telefon bisedojnë me një kontrabandist me të cilin nuk pajtohen në lidhje me çmimet që janë sa i përket lejimit të kontrabandimit të mallrave nga Serbia për në Kosovë, duke ofruar kontrabandisti një çmim tjetër sa i përket kontrabandimit mirëpo që të akuzuarit nuk pajtohen dhe më i zëshmi në bisedë është A M i cili thekson se çmimet duhet të rriten duke pasur parasysh dhe taksën e vendosur prej 100% nga Ramush Haradinaj, duke përmendur dhe çmimin prej 200 Euro për naftë, dhe bisedojnë A M dhe M M për ndarjen e parave, po ashtu përmendën çmimet tjera si 20, 50 dhe 70 si në transkript.

3.2.18. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 17:54:22 – 18:04:00, gjykata ka faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes A M dhe M M, dhe bisedës në telefon në mes D I, ku zhvillohet biseda në lidhje me çmimet sa i përket lejimit të D që të fus mall të kontrabanduar nga Serbia për në Kosovë rrugëve ilegale, mirëpo nuk mundën me u marrë vesh sa i përket çmimit që duhet të paguaj D për patrullën policore në krye me B. A M i'u thotë që nuk don të rrezikoj më shumë për 50 Euro, dhe se për sonte le të bëjnë çka të dojnë ndërsa ndryshe do të jetë nga ndërrimi i ardhshëm.

3.2.19. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 20:24:54, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes A P dhe Z B, flitet për 100 Euro që i ka lënë Vespa, dhe për 10 Euro të tjera që i ka dikush të cilës i referohen në bisedë me meçka.

3.2.20. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 18:04:40 – 18:19:39, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për

Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes A M dhe M M, përgjatë bisedës dëgjohen duke biseduar për rritjen e çmimeve për lejimin e automjeteve me mallra të kontrabanduara. Në bisedë flitet edhe për Z (Komandantin) për të cilin thonë se çka nëse pyet se kush i ka rritur çmimet, ndërsa A M është përgjigjur se nuk ma nin për Z, unë dua ta rrisë çmimin, duke shtuar se po kalohet nëpër rrugë kryesore, më herët kam marr 20-30 €uro vetëm të mos shkruaj dënime, ndërsa tash me plot mall, dogana 100%, dhe në ndërkohë dëgjohet në bisedë që vjen një kontrabandist për të pyetur se si të kalojnë rrugëve ilegale me mall dhe i njëjti i sjellë disa para për zyrtarët. Ndërsa A M në bisedë e sipër thekson se le të bëjnë çka të dojnë, unë nuk dua asgjë, bëni çka të doni.

3.2.21. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 18:19:40 – 18:34:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes A M, M M dhe B N-udhëheqëse e ndërrimit, të cilët flasin në lidhje me rritjen e çmimeve sa i përket lejimit të kontrabandimit me mallra, dhe flasin për shqetësimin dhe rrezikun se mund të kapen duke marrë para, ndër të tjera në bisedë A M deklaron: *“Nuk jemi kundër, por nëse rrezikoj ta di pse po rrezikoj, asgjë tjetër. Nuk jam kundër për këtë, por kur të rrezikoj bile të kam para për avokat”* dhe në komunikimet e njëri-tjetrit, M M, deklaron: *“... Na i kanë marrë adresat, na i kanë marrë numrat, na i kanë marrë të gjitha dhe tash të na zënë në vepër, dhe kur ata të zënë më nuk del nga burgu..”*, pra në komunikimet me njëri tjetrin, të njëjtit deklarohen secili për shqetësimet e tyre rreth mundësisë që të njëjtit të arrestohen për veprimet që i kanë shkaktuar përmes lëshimeve të kontrabandimit të mallrave Serbe për në Kosovë. Po ashtu nga biseda e A M, i njëjti thekson *“..Nuk është hera e parë por kështu ma jo, nuk jam unë maxhup edhe 20 edhe 50... kur të rrezikoj ta di se çka po marrë”*.

3.2.22. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 18:34:40 – 18:45, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të B N, A M dhe M M, të akuzuarit flasin sa automjete kanë kaluar gjatë ndërrimit të tyre dhe në një moment A M fillon të llogarisë automjetet që kanë kaluar përgjatë ndërrimit në vlerë monetare, duke përmendur vlerën 300 dhe 700, gjithsejtë 1000 €uro dhe llogaritje se sa automjete të vogla dhe kamion kanë kaluar.

3.2.23. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 19:39:25 – 19:43:28, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të A M dhe M M, të njëjtit bisedojnë se sa automjete kanë kaluar gjatë ndërrimit të tyre për shkak të pagesave që duhet bërë nga ana e kontrabandistëve dhe flasin për 10 (dhjetë) automjete që kanë kaluar në mënyrë ilegale dhe e akuzuar B N në një moment gjatë bisedës i thotë M M, se nuk dua të punoj për këto para, më mirë të mos punoj asgjë sesa e tërë kjo kolonë të kaloj për aq para. Dhe bisedojnë për kamionët dhe kombit e ndryshëm se kujt i përkasin, 6 (gjashtë) kamion bisedojnë se i përkasin D (D I-D), 2 (dy) kamionë të M (M R), 1 (një) kamion i M dhe 1 (një) tjetër i një personi me pseudonimin Ç.

3.2.24. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 20:09:24 – 20:15:16, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje - Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të A P, B M dhe J D, të cilët bisedojnë për paratë që i kanë marrë dhe për mënyrën se si i kanë ndarë këto para, nga leximi i transkriptes kuptohet që A P, B M, J D, i kanë marrë nga 10 €uro për person dhe po ashtu në bazë të bisedës dyshohet se nga 10 €uro kishin marr edhe zyrtarët policor B, Z B, O K, D K-P dhe D S-K, po ashtu për B P flasin që ka mbet edhe 30 €uro për me i nda më vonë.

3.2.25. Nga leximi i transkriptes të datës 13.03.2019, ora 20:25:45 – 20:37, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të B N 1, A M dhe M M1, ku të njëjtit bisedojnë sa i përket punës në të cilën kanë hy, për sa i përket lejimit të automjeteve me mall të kontrabanduar, dhe bisedojnë për rrezikun që ka kjo punë. Po ashtu, bisedojnë për zyrtarët policor të tjerë të ndërrimit për të cilët dyshojnë se mund të flasin për sa i përket aktivitetit kriminal, dhe në bisedë e sipër A M thotë se nuk dua që të punoj më për këto çmime duke aluduar në rritjen e çmimeve për lejimin e automjeteve me mallra dhe thotë se sot do të punojmë kështu dhe pastaj ndryshe që kuptohet me çmime të reja.

3.2.26. Nga leximi i transkriptes të datës 15.03.2019, ora 00:47:33 – 00:59:40, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje-Zubin Potok në veturën (Defender 134-02) ishte incizuar biseda në mes të A H V K dhe M M, të njëjtit në veturë bisedojnë për problemet që i kanë pasur me tregtar-kontrabandistët sa i përket ngritjes së çmimit nga ana e Policisë për lejimin e automjeteve me mall të kontrabanduar nga Serbia për në Kosovë, Përgjatë bisedës përmendin disa tregtarë siç janë D, D I kontrabandist i mallrave. Në këtë bisedë përmendën edhe çmimet për lejimin e një kombi me mall e që është 70 €uro, një kamion 100 €uro, ndërsa kur flitet për shifrën prej 200 €uro për cisterna me naftë. Po ashtu përmendën fakti që ngritjen e çmimit për kontrabandistët e ka bërë A (A M) dhe B (B N). Dhe në bisedë e sipër i akuzuari A H pohon faktin se ka marrë dhuratë nga 20 €uro nga kontrabandistët që kanë kaluar me mall.

3.2.27. Nga leximi i transkriptes të datës 18.03.2019, ora 11:56:05, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje-Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të B T dhe V T, të cilët bisedojnë që asnjëri prej kontrabandistëve nuk është lajmëruar akoma për të kaluar, dhe të njëjtit e diskutojnë mundësinë me shfrytëzu Kohen derisa shefi i ndërrimit është në drekë për me leshur dikënd prej kontrabandistëve. Në ndërkohë në bisedë dëgjohen duke folur me një person me emrin D (Vj.D I-kontrabandist i lopëve) të cilin e pyesin se a ka diçka dhe i tregojnë se janë patrullat e KFOR-it amerikan dhe i'u thojnë që ti përcjell dikush këto patrulla. Pra, nga biseda dëgjohet që të akuzuarit i thonë kontrabandistëve që ti përcjellin patrullat e KFOR-it amerikan.

3.2.28. Nga leximi i transkriptes të datës 19.03.2019, ora 01:32:15 – 01:35:35, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të M M, D V dhe V K, ishte zhvilluar biseda rreth parave që janë marrë nga kontrabandistët e mallrave, më

saktësisht përmendin emrin e një kontrabanduesi me emër B, dhe i cili u'a ka dhënë vetëm 100 Euro për dy (dy kamiona), dhe sipas bisedës shihet se ka pasur mi dhanë 2, që nënkuptohet nga biseda se është fjala për 200 Euro, dhe në bisedë dëgjohen të frustruar dhe duke biseduar për rritjen e çmimit për një kamion me mallra të bëhet çmimi prej 130 Euro. Po ashtu, flasin edhe për një person me emrin D (D I) për të cilin thonë se do të paguaj për këtë B.

3.2.29. Nga leximi i transkriptes të datës 19.03.2019, ora 16:43:41 – 16:44:39, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes G D dhe F M, bisedojnë rreth ndërrimit të çmimeve sesi për një kombi që ka qenë 30 Euro tash paguhet 50 Euro, për një kamion që ka qenë 50 Euro tash është 100 Euro, ndërsa për një cisternë që ka qenë 150 Euro është rritur çmimi në 300 Euro, pra çmimet janë dyfishuar. Po ashtu, G i ka treguar F se ka dëgjuar nga tregtarët se Z S e ka rritur çmimin dhe se më herët ishte paguar nga tregtarët në bazë mujore nga tregtarët nga 500 Euro në muaj e tash paguhet në shumën prej 700 Euro (bisedë kjo si në transkript).

3.2.30. Nga leximi i transkriptes të datës 23.03.2019, ora 19:51:04 – 19:52:00 dhe ora 20:02:00 – 20:04:30, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje-Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes R K dhe B M, të njëjtit bisedonin për një veturë Golf 5 që e kanë parë në Lluzhan dhe me siguri se ata do të jenë sonte në teren dhe se duhet të kenë kujdes të mos lëshojnë asgjë deri ne ora 4-5 e mëngjesit. R K tregon se ka folur me M(M R kontrabanduesin e mallrave), dhe i ka thënë se nëse punon duhet me përcjell terrenin me veturë, po ashtu gjatë bisedës të njëjti flasin se si po flitet se janë duke u përcjell dhe se do të ketë arrestime.

3.2.31. Nga leximi i transkriptes të datës 23.03.2019, ora 23:47:30 – 23:49:00, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes B M, L V dhe R K, në këtë bisedë L V nuk ka qenë e përfshirë, ndërsa B M dhe R K bisedojnë për paratë që kanë marrë nga kontrabanduesit, përgjatë bisedës dëgjohen duke kalkuluar shumat që i kanë mbledhur dhe përmendet shuma prej 800 Euro, ku flitet për paratë që i kanë marr nga D (D I-kontrabandues lopëve dhe M R-kontrabandues i mallrave).

3.2.32. Nga leximi i transkriptes të datës 28.03.2019, ora 07:04:00 – 07:04:50, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes B T dhe V T, ku fillimisht V i thotë B se është dashtë me i dhanë edhe nga 10 Euro më shumë bile me u ba 50 Euro dhe gjatë bisedës dëgjohet B T që nuk pranon të merr para, ndërsa V T e telefonin R K në të cilën bisedë e informon për B e cila nuk dëshiron që ti marrë paratë.

3.2.33. Nga leximi i transkriptes të datës 28.03.2019, ora 07:44:49 – 07:45:22, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes B T dhe V T, ku në bisedë dëgjohet V T që i thotë B që “unë do ti kthej të mijat” që nënkuptohet për paratë,

dhe B T në bisedë i thotë që të verifikoj nëse kanë kaluar më shumë që nga biseda nënkuptohet se flitet për automjete me mall të kontrabanduar.

3.2.34. Nga leximi i transkriptes të datës 20.04.2019, ora 20:44:39– 20:49:10, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes R K dhe K S, përgjatë bisedës telefonike bisedojnë për shumën prej 560 Euro të cilat i kanë marrë nga kontrabanduesit e mallrave, të cilat janë marrur nga M (M R) dhe nga personi me emrin M-djali i Z V-Ç, dhe në bisedë e sipër të njëjtat bisedojnë për mundësinë që ndokush prej zyrtarëve policor ti ketë marrë paratë nga kontrabanduesit dhe të mos i kenë deklaruar saktë shumën e parave që janë grumbulluar.

3.2.35. Nga leximi i transkriptes të datës 12.04.2019, ora 21:38:25 – 21:39:17, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes R K dhe personit që dyshohet të jetë K S, ku së bashku bisedojnë për koordinimin sa i përket kalimit të mallrave të kontrabanduesve nga Serbia për në Kosovë.

3.2.36 Nga leximi i transkriptes të datës 12.04.2019, ora 23:01:22 – 23:01:45, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda e R K dhe një personi që dyshohet të jetë kontrabandues i mallrave, të cilët zhvillojnë bisedën për mundësinë e kalimit të mallrave dhe në bisedë e sipër R K e njofton se mund të kalojnë mallrat e kontrabanduara. Në ora 23:02:03 – 23:03:48, kjo bisedë vazhdon e incizuar atë ditë kur një kamion me mall të kontrabanduar e i lëshuar nga zyrtarët e SPMK-Zubin Potok është zënë nga SHDPK sipas rastit 2019-YI-02, kamioni me mall ka qenë i tregtarit M R nga Zubin Potoku ndërsa në këtë kamion ka qenë duke vozitur D D në të cilën atë ditë kanë folur disa zyrtar policor nga ky stacion. Ndërsa në ora 23:04:37 – 23:04:53, përsëri R K zhvillon bisedë me një person dyshohet të jetë kontrabandist i mallrave atë mënyrë që i akuzuari R K deklarohet rreth automjeteve me mallra të kontrabanduara e që e cek se janë në rrugë dy kombi që kanë për të kaluar mallrat e të cilët bisedojnë rreth mundësisë së kalimit të mallrave dhe i akuzuari R K e lajmëron përmes telefonit të dyshuarin për kontraband dhe se të do ta lajmëroj për çdo gjë.

3.2.37. Nga leximi i transkriptes të datës 04.05.2019, ora 20:00:57 – 20:02:20, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të R M dhe J D, kjo e fundit e pyet R se i kanë kaluar mbrëm, i njëjti i përgjigjet se kurrqysh pasi që nga 230 Euro që i kishte marrë nga kontrabanduesit e mallrave, që të gjitha këto para i kishte ndarë policëve dhe vetëm 20 i kishin mbetur atij (Rt). Nga biseda kuptohet se paratë i kishte marr nga kontrabanduesit përmend emrat e M R, ZV-C, D I, duke treguar dhe se nga cila pjesë kanë kaluar me mallra të kontrabanduara.

3.2.38. Nga leximi i transkriptes të datës 25.05.2019, ora 00:34:05 – 00:34:25, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të R M,

dhe D S të cilët flasin për paratë që i kanë marr dhe për mënyrën se si kanë ndarë këto para. Nga kjo bisedë kuptohet që të lartshënuarit i kanë marr nga 50 Euro dhe po ashtu në bazë të bisedës të lartshënuarit kontaktojnë në telefon me kontrabanduesin e mallrave Z V-C, një person tjetër me emrin V, person me pseudonimin K K dhe mënyrën se si i ndihmojnë në veprimet e tyre të jashtëligjshme. Po ashtu, flasin edhe për kontrabanduesit tjerë si D I, R I-R, kontrabanduesit tjerë N, M R etj.

3.2.39. Nga leximi i transkriptes të datës 25.05.2019, ora 00:40:05 – 00:40:19, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të R M dhe një personi që dyshohet që mund të jetë Z V-C, dëgjohen duke i thënë akuzuari R M personit në bisedë me fjalet : “ Mirë, kryje ti me të, merrja ti, pastaj na i jep”, që vërtetohet se është bërë bisedë për shpërndarjen e parave me njëri tjetrin.

3.2.40. Nga leximi i transkriptes të datës 25.05.2019, ora 00:42:30 – 00:43:07, gjykata ka vërtetuar se faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të R M dhe personave të dyshuar të mallrave me emrin V dhe tjetri me pseudonimin K, bisedojnë për mallrat e kontrabanduara dhe përgjatë bisedës telefonike personi me emrin K del nga vetura dhe nuk dëgjohet mes tyre.

3.2.41. Nga leximi i transkriptes të datës 10.05.2019, ora 07:17:42 – 07:28:42, gjykata ka vërtetuar se faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të dy zyrtarëve policor NN, flasin për mallrat e kontrabanduara dhe njëri nga ta pyet se sa po japin për cigare, dhe flasin për një kontrabandues me emrin M B të cilët pohojnë se nga i njëjti kanë marr nga 20 Euro.

3.2.42. Nga leximi i transkriptes të datës 15.05.2019, ora 17:17:07 – 19:55:01, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të N G dhe personit NN, kanë biseduar për njësi intervenuese në teren dhe duke pohuar se jam në bazë dhe se do të ketë diçka (që nuk kuptohet drejtë për çfarë bisedohet).

3.2.43. Nga leximi i transkriptes të datës 15.05.2019, ora 17:17:07 – 20:10:17, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok-Mitrovicë e Veriut, ishte inxhizuar biseda në mes të N G dhe personit NN, flasin për kontrollat dhe për njësinë intervenuese në teren.

3.2.44. Nga leximi i transkriptes të datës 10.05.2019, ora 07:32:42 – 07:44:20, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të dy zyrtarëve policor NN edhe personit NN, flasin për para dhe përmendin shifrën prej 120 Euro, mirëpo që përgjatë bisedës nuk saktësohet se për kënd dhe nga kush janë marr.

3.2.45. Nga leximi i transkriptes të datës 26.04.2019, ora 00:47:51 – 01:02:50, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok-Mitrovicë e Veriut, ishte inxhizuar biseda në mes të A V dhe Q M,

të njëjtit bisedojnë për pakënaqësitë dhe problemet që i ka shkaktuar G, dhe flasin me njëri tjetrin që mos ta ndalin përgjatë kalimit dikë që nuk përmendin dhe në bisedë nuk dëgjohej se për kënd është fjala.

3.2.46. Nga leximi i transkriptes të datës 26.04.2019, ora 00:47:51 – 01:02:50, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok- Mitrovicë e Veriut, ishte inxhizuar biseda në mes të A V dhe Q M, flasin për pakënaqësitë dhe mundësinë e mundshme të kalimit të automjetit përgjatë kohës sa të njëjtit janë në ndërrim.

3.2.47. Nga leximi i transkriptes të datës 26.04.2019, ora 02:05:46 – 02:18:31, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok-Mitrovicë e Veriut, ishte inxhizuar biseda në mes të A V dhe Q M, flasin po ashtu për mundësinë e kalimit të automjeteve përgjatë kohës sa janë në ndërrim dhe për shqetësimet e tyre duke diskutuar me njëri-tjetrin.

3.2.48. Nga leximi i kontrata për dhënie me qira të lokalit afarist të datës 12.06.2012, gjykata ka vërtetuar faktin se ishte lidhur kontratë mbi qiranë për shfrytëzimin e lokalit në mes të O B nga Zubin Potoku dhe B J nga Mitrovica e Veriut.

3.3. Mbrojtja e të akuzuarve;

Të gjithë akuzuarit kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre ligjore, janë mbrojtur në heshtje, nuk janë deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor në fazën e mbrojtjes.

4.Gjetjet e gjykatës në raport me pikat I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit pjesa gjykuese A;

Gjykata në raport me këtë çështje penale dhe aktin akuzues të parashtruar në këtë çështje penale, së pari do ta shtjelloj: vërtetimin e gjendjeve faktike në këtë çështje penale e për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor në pikat I, II dhe III të aktgjykimit (Pjesa gjykuese A); cilësimin juridik të veprave penale në raport me gjetjet të cilat kanë rezultuar me administrimin e provave në këtë çështje penale; provat dhe faktet të cilat kanë sjellë deri tek gjetja fajtor e të akuzuarit; pretendimet e mbrojtjes për çështjet e caktuara të parashtruara në fjalë përfundimtare; çështjen e dënimit, dënimit plotësues dhe të shpenzimeve procedurale.

Gjykata në këtë çështje penale si fakte të pa-kontestueshme i ka vërtetuar, faktet si më poshtë:

- Fakt i pakontestueshëm ishte se të akuzuarve në pikën I, II dhe III të aktgjykimit i'u takon cilësia e personit zyrtar që është përcaktuar me nenin 120 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 të KPRK-së, për shkak se në kohën për të cilin janë shpallur fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit, të akuzuarit ishin Zyrtarë Policorë pranë Stacionit Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok.
- Të akuzuarit si në pikën I të aktgjykimit i ushtronin këto pozita: i akuzuari Z S ishte Komandat i SPMK në Zubin Potok, e akuzuara B N ishte Udhëheqëse e ndërrimit (A), ndërsa të akuzuarit M M, A M dhe A H ishin Zyrtarë Policor Patrullues.

- Të akuzuarit si në pikën II të aktgjykimit i ushtronin këto pozita: R M, J D, Z B, A P, ish-in Zyrtarë Policor Patrullues në kuadër të ndërrimit (B), pranë SPMK Zubin Potok.
- Të akuzuarit si në pikën III të aktgjykimit i ushtronin këto pozita: R K, V T, B M, B L, ish-in Zyrtarë Policor Patrullues në kuadër të ndërrimit (C) pranë SPMK Zubin Potok.
- Po ashtu nuk ka qenë kontestuese fakti se Stacioni Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok, ku të akuzuarit ish-in Zyrtarë Policorë, kishte nën mbikëqyrje një pjesën e kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë, dhe të njëjtit si detyrë kishin mbikëqyrjen e kufirit, pra ish-in përgjegjës ndër të tjera edhe për parandalimin dhe zbulimin e veprimtarisë së krimit ndërkufitar dhe kontrabandave të mallrave dhe kontrabandave tjera të ndaluara me ligj, pra parandalimin dhe ndalimin e lëvizjes së mallrave dhe bagëtieve ilegale përmes kufirit shtetëror.
- Gjithashtu, nuk ka qenë kontestuese fakti se gjatë kësaj periudhe kohore Komandant stacioni në SPMK në Zubin Potok, ka qenë Z S, ndërsa nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë tre ekipe policore (A,B,C) të cilët kanë operuar me ndërrime dhe secili prej ndërrimit ka pas udhëheqësin e ndërrimit dhe zëvendës udhëheqësin e ndërrimit. Detyrë e ekipeve policore ka qenë mbikëqyrja e brezit kufitar dhe parandalimi i kontrabandimit të mallrave dhe njerëzve. Ndërsa detyrë e udhëheqësve të ndërrimeve ka qenë përpilimi i orarit të ndërrimeve si dhe mbikëqyrja e ekipit në terren duke iu dhënë udhëzime për vendosjen e pikave të kontrollit ose ndryshimin e tyre sipas nevojës.

5. Gjendjet faktike dhe cilësimi juridik në raport me gjendjet faktike për pikën I, II, III të dispozitivit të aktgjykimit Pjesa Gjykuese A;

Nga provat e administruara gjykata ka gjeti se nga viti 2017 e deri në muajin Maj të vitit 2019, përmes rrugëve ilegale në brezin kufitar Kosovë – Serbi konkretisht nëpërmes rrugëve të fshatrave Banjë, Bube, Jagnjenjicë dhe fshatrave tjerë në Zubin Potok, kanë ekzistuar rrugë ilegale përmes të cilave është zhvilluar kontrabandimi i mallrave të ndryshme: si kafshë (Lopë), mallra ushqimore, pije alkoolike dhe joalkoolike dhe derivateve nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, duke iu shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave.

Siç është theksuar edhe më latë të gjithë të akuzuarit kanë qenë zyrtarë policor në pozitat e përshkruara më lartë, pranë Stacioni Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok dhe përgjegjësi dhe mision i tyre ka qenë të njëjtit të garantojë siguri të shtuar kufitare duke parandaluar, duke zbuluar dhe duke kapur kriminelët e përfshirë në veprimtari të krimit ndërkufitar dhe kontrabandave tjera të ndaluara me ligj dhe përgjegjësi tjera ligjore.

Nga dëshmia e dëshmitarit D1, vërtetohet se në rrugët ilegale në brezin kufitar që ishte nën mbikëqyrje të SPMK Zubin Potok është zhvilluar kontrabandë, ku i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: “*gjatë vitit 2017-2019, ka pasur raste të kontrabandimit të mallrave në pjesën veriore dhe për të funksionuar kjo, në vendet ku kanë punuar si në Zubin Potok, Banjë dhe Bube, fillimisht është bërë ndryshimi i grupeve ku ish-in caktuar kanë bërë ndryshimet e*

thirrura barrikada dhe këto ndërrime më shume janë bërë në Stacionin Policor në Mitrovicë dhe në kontrabandimin e mallrave janë përfshirë zyrtarë policor pandihmën e të cilëve nuk do të mund të kryhej kontrabanda dhe se ky kontrabandim ka ndodhur pothuajse në të gjitha ndërrimet përveç në ndërrimin e Gogiqit nuk ka qenë e njëjtë dhe sipas dijenisë se tij nuk ka ndodhur diçka në këtë ndërrim, dhe forma e bashkëpunimit ka qenë përmes telefonit mobil, d.m.th. telefona të veçantë dhe këta telefona i kanë pasur në posedim udhëheqësit e ndërrimeve, ku patrullat tërhiqeshin pasi që dikush thirrte në telefon dhe thoshte se dikush duhet të kaloj, kontrolla tërhiqej dhe kontrabandimi kryhej ashtu siç planifikohej, ndërsa sa i përket tarifave për kalimin ilegal të mallrave ka theksuar se nuk e di me të vërtetë, por sa kishte informata kane qenë nga 50 Euro dhe 30 Euro dhe këto para janë marrë nga shefat dhe udhëheqësit e ndërrimeve, dhe ka ekzistuar një tarifë ditore që është paguar për komandantin e cila ka qenë 50 Euro sipas ndërrimeve, dhe këto para i'a kanë dhënë komandantit shefat e ndërrimeve dhe pastaj i kanë ndarë edhe me policët patrullues dhe këto para kryesisht janë dhënë vetura janë lënë në market në pompa të benzinës.”

Edhe sipas dëshmitarit F2, vërtetohet se në rrugët ilegale në brezin kufitar që ishte nën mbikëqyrje të SPMK Zubin Potok është zhvilluar kontrabandë, ku i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *“se gjatë vitit 2017-2019, ka pasur raste të kontrabandimit të mallrave nga Serbia në Kosovë dhe anasjelltas ku kryesisht është zhvilluar në fshatin Bube si dhe rrugë të tjera ku kontrabanduesit kanë shkuar nga Ribariqi dhe kanë ardhur në fshatin Bube dhe ky kontrabandim është bërë përmes policisë nëpërmjet telefonave mobil se ku dhe kur do të kaloje kontrabandimi të cilët telefona i kanë poseduar udhëheqësit e ndërrimeve por ka pasur raste që i kanë pasur edhe policët dhe paratë janë lënë kryesisht në pompa të benzinës si dhe në lokale-shitore dhe ka pasur disa tarifa për kalimin e mallrave, në fillim ka qenë 15 Euro për automjete kombi, për kamionët blegtorisë apo shtazëve ka qenë 25 Euro, ose për kamionë të mallrave të ndryshme ka qenë 25 Euro, ndërsa më vonë ka ndryshuar për kamionë është bërë 50 Euro, për kombi 20 Euro, për mauna të derivateve ka qenë 80 Euro, ku këto para i janë dhënë në disa raste policëve, në shumicën e rasteve janë lënë në lokalit në Zubin Potok i cili ka qenë i kontrabanduesit me emrin Miloško, emri i lokalit nuk i kujtohej, ndërsa ka deklaruar se për komandantin ka ekzistuar tarifë e veçantë e cila ka qenë mujore dhe shuma ka qenë në fillim 500 Euro, mandej është bërë 700 Euro.”*

Po ashtu dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues B M, vërtetohet se në rrugët ilegale në brezin kufitar që ishte nën mbikëqyrje të SPMK Zubin Potok është zhvilluar kontrabandë, për shkak se vet dëshmitari bashkëpunues kishe marr para nga kontrabanduesit, ku i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *gjatë kohës sa ka punuar si zyrtarë policor kanë marrë shuma të caktuar të parave të cilat janë ndarë përmes shefave të ndërrimit.... Kur është bërë ndarja e parave që kanë marrë prej kontrabanduesve i njëjti ka qenë prezent dhe se kryesisht paratë që i kanë marrë i kanë ndarë kryesisht në veturë zyrtare, në ndonjë lokal-kafe ose jashtë kur kanë qenë në teren në fund të ndërrimit. Ndërsa tutje ka shtuar se i kujtohen si emra të kontrabanduesve të kenë qenë D I dhe vëllai i tij Radoslav Igrutinović të cilët kanë kontrabanduar gjedhe-bika si dhe pije alkoolike dhe jo alkoolike dhe gjëra ushqimore si dhe vëllezërit Milan dhe Miloško mbiemrat e të cilëve nuk i kujtoheshin të cilët merreshin me kontrabandimin e derivateve të naftës, pijeve alkoolike dhe jo alkoolike si dhe gjëra ushqimore, dhe shuma që kanë dhënë të njëjtit për kalimin ilegal ka qenë 50 Euro për kamion Sava, 30 Euro*

ka qenë për kombi, për cisterna të derivateve ka qenë 150 Euro, ndërsa për vetura ka qenë 15-20 Euro.

Pra në bazë deklaratave të lartpërmendura të dëshmitareve D1 dhe F2, por edhe dëshmitarit bashkëpunues B M, vërtetohet se në rrugët ilegale është zhvilluar kontrabandë, pasi që edhe vetë dëshmitari bashkëpunues kishe marr para nga kontabanduesit, të cilit kishin bërë transportim të mallrave nga Serbia për në Kosovë dhe anasjelltas. Pra është vërtetuar edhe mënyra e bashkëpunimit të kontrabanduesve me policinë ka qenë në atë mënyrë që ata përmes numrave të telefonit i kanë kontaktuar zyrtarët policor dhe përmes tyre janë njoftuar se në cilën pjesë mund të kalojnë lirshëm ku nuk ka patrulla të policisë, pra patrullat tërhiqeshin pasi që dikush thirrte në telefon dhe thoshte se dikush duhet të kaloj, kontrolla tërhiqej dhe kontrabandimi kryhej ashtu siç planifikohej, pastaj kontrabanduesit për këtë kanë lenë një shumë të hollave në vende të caktuara lokale. Të hollat i kanë lënë në emër të nderimit ose mbikëqyrësit të ndërrimit, të cilat pastaj kanë shkuar dhe i kanë marrë policet i kanë ndër sipas ndërrimit njëri me tjetrin.

Nga provat e administruara deklaratat e dëshmitarëve të lartpërmendur por transkriptat e bisedave të nxjerra në Bazën e SPMK Zubin Potok dhe në veturat (Defender 141-02 dhe Defender 134-02) të cilat janë elabuar në pikën 3.3 (provat material), të cilat do të elaborohen edhe tek pjesa që ka të bëjë me përgjegjësinë penale individuale të akuzuarve, si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se të akuzuarit për kalimin e automjeteve me mallra kanë pranuar – marrë shuma të ndryshme të parave nga kontrabanduesit për të vepruar në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, pra duke pranuar parat sipas tarifave të vet përcaktuara nga 20 Euro për vetura të vogla, 30 – 60 Euro për furgona dhe 100 – 150 Euro për çdo kamion, me ç'rast kanë përfituar për vete, ju mundësuar përfitim pasuror të kundërligjshëm kontrabanduesve për shkak se ju kanë mundësuar kontrabanduesve që mallrat e ndryshëm ti kalojnë nëpërmjet rrugëve ilegale kështu edhe duke iu shmangur tarifave doganore.

Faktin se kishin bashkëpunuar me kontrabanduesit përkatësisht kishin bashkëpunuar me të pandehurit D I, B RD D, M R, M R, Z V dhe persona të tjerë kontrabandues, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga transkriptat e bisedave të nxjerra në Bazën e SPMK Zubin Potok dhe në veturat (Defender 141-02 dhe Defender 134-02) të cilat janë elabuar në pikën 3.3 (provat material), të cilat do të elaborohen edhe tek pjesa që ka të bëjë me përgjegjësinë penale individuale të akuzuarve, ku në këto transkripte që të akuzuarit bisedojnë lidhur me kalimin e mallrave nga kontrabanduesit e lartpërmendur, janë në harmoni edhe me deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues B M, i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se *“i kujtohen si emra të kontrabanduesve të kenë qenë D I dhe vëllai i tij Radosllav Igrutinoviç të cilët kanë kontrabanduar gjedhe-bika si dhe pije alkoolike dhe jo alkoolike dhe gjëra ushqimore si dhe vëllezërit Milan dhe Miloško mbiemrat e të cilëve nuk i kujtoheshin të cilët merreshin me kontrabandimin e derivateve të naftës, pijeve alkoolike dhe jo alkoolike si dhe gjëra ushqimore, dhe shuma që kanë dhënë të njëjtit për kalimin ilegal ka qenë 50 Euro për kamion Sava, 30 Euro ka qenë për kombi, për cisterna të derivateve ka qenë 150 Euro, ndërsa për vetura ka qenë 15-20 Euro”*.

Gjykata në këtë drejtim dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues B M të dhënë në shqyrtim gjyqësor e vlerësoj si të besueshme për shkak se e njëjta është në harmoni edhe me deklaratën e

dhënë në PSRK, më datën 11.10.2019, në cilësi të dëshmitarit bashkëpunues, i cili kishte deklaruar po ashtu se: *“sa më kujtohet ditëve të hëna dhe mërkura janë ditët të cilat kanë kaluar decidivisht D I i cili ka transportuar në mënyrë ilegale gjedhe dhe atë me kamion, ku ka pas minimum 2 kamion deri ne 5 dhe atë gjatë paradites dhe shuma për kamion është paguar 50€ përkatësisht 100€ pas dhënies se tarifës”... Ndërsa Milejko, kur ka kaluar cisternën me derivate personi ose kontrabanduesi me nofkën Nixha me emrin Nikolla e mbiemri i të cilit nuk më kujtohet është nga fshati Banjë, është person I besueshëm i kontrabandistit në fjalë i cili ka koordinuar kalimin e të mirave materiale nga Serbia në Kosovë.. Po ashtu njëjti ka deklaruar se Boban Radojkovic kishte transportuar gjedhe, mirëpo i njëjti në krahasim me D I kishte transportuar më rrallë.*

Se deklarata e dëshmitarit bashkëpunues B M, ishte e besueshme për gjykatën lidhur me faktet e lartpërmendura, Gjykata ka gjetur se deklarata e tij është në harmoni edhe me deklaratën e dëshmitarit D1, të dhënë në PSRK me datën 04.04.2019, i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklartës së dhënë në PSKR, në cilën deklaratë kishte theksuar se: *“Bagëtinë e kontrabanduar e udhëheqin vëllezërit Igrutinoviq, të cilët kontrabandën janë bagëtitë përmes kodrave dhe këto bagëti i merr një qytetar shqiptar por emrin nuk e di, kryesisht ushqimet dhe pijet përfundojnë në Zubin Potok neper shitore, pijet alkoolike dhe ushqimet i kontrabandojnë personi i quajtur n, derivatet e naftës i kontrabandon vëllai i tij Milko. Personi i quajtur Kurjevo dhe ky kontrabandon artikuj ushqimor dhe pije alkoolike, ndërsa Djugiqi dhe Bobani kontrabandojnë pije alkoolike dhe jo alkoolike këta janë personat kryesor që kontrabandojnë mallra, ka edhe te tjerë por ata janë më të vegjël”.*

Nga të lartpërmendurat, pa mëdyshje është vërtetuar se të akuzuarit kishin bashkëpunuar me kontrabanduesit, për çka si zyrtarë policor kishin qenë në dijeni rreth kontrabandimit të mallrave të ndryshme në këtë pjesë të zonës kufitare dhe të njëjtit si zyrtarë policor nuk kishin përmbushur detyrat e tyre ligjore të cilat u janë përcaktuar me ligj, për çka edhe me marrjen e parave nga kontaanudesit kishin përfitur për vete dhe po ashtu ju kanë sjellë dobi pasurore konatbanuseve lidhur me kalimin e mallrave të ndryshëm në mënyrë ilegale kështu duke iu shmangur tarifave doganore.

Gjithashtu, duke marr për bazë faktin se të akuzuarit kishin lejuar në vazhdimësi një numër të konsiderueshëm të kalimin e mallrave të ndryshëm në mënyrë ilegale me veturë, furgon, kamion dhe cisternë, për çka kontrabanuesit me rastin e kalimit në mënyrë ilegale edhe iu kishin shmangur tarifave doganore, padyshim që me këto veprime i kanë shkaktuar edhe dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovës, mirëpo duke marrë për bazë faktin se nuk dihet saktë sasia e mallit të kaluar në mënyrë ilegale, në rastin konkretë kjo gjykatë konsideron se ka qenë e pamundur të përcaktohet saktë dëmi i shkaktuar, mirëpo padyshim që dëmi material i konsiderueshëm është shkaktuar, sepse mallrat kanë kaluar pa i paguar tarifave detyrueshme doganore.

Në rastin konkret të akuzuarit **të cilët janë shpallur fajtor në pikën I, II, III të pjesës gjyquese, të njëjtit PSRK** i ka akuzuar se të njëjtit: *“në cilësinë e personave zyrtar si zyrtar policor, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje kanë keqpërdorur detyrat zyrtare, nuk i kanë kryer detyrat e përcaktuar me ligj dhe nuk i kanë përmbushur autorizime e tyre zyrtare, me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, pra në këtë rast si objekt kemi elementin se të njëjtit duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar me dashje kanë*

keqpërdorur detyrat zyrtare, nuk i kanë kryer detyrat e përcaktuara me ligj dhe nuk i kanë përmbushur autorizime e tyre zyrtare.

Fillimisht gjykata sqaron se si element qenësor për të ekzistuar vepra penale e Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, është tejkalimi i autorizimeve nga ana e personit zyrtar apo mos përmbushja e detyrave zyrtare.

Pra nga ky përkufizim ligjor, sipas nenit 422, paragrafi 1 të KPRK, rezulton se kjo vepër penale përbëhet prej këtyre elementeve:

1) Kryes i kësaj vepre penale duhet të jetë personi zyrtar (domethënia e shprehjes “person zyrtar”, përveç tjerash është paraqitur edhe në nenin 120, paragrafi 2 i KPRK-së);

2) Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar;

3) Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë : në tejkalimin e kompetencave ose mos përmbushjen e detyrave zyrtare dhe

4) Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me qëllimin e kryesit që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër.

Ndërsa paragrafi 2 i nenit 422 të KPP-së, ka përcaktuar se: “Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në”: nën paragrafi 2.2. ka përcaktuar moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj; ndërsa nën paragrafi 2.3. ka përcaktuar: pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj”;

Sipas nenit 10 të Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, janë përcaktuar **Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë se:** 1.Detyrat e përgjithshme të policisë janë të: 1.1. mbrojtjetën, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat; 1.2.mbrojtjet të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave; 1.3.parandaloj rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike; **1.4. parandaloj dhe t'i zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre;** 1.5. hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre; 1.6. mbikëqyrë dhe kontrolloj sigurinë në komunikacion; **1.7. menaxhoj dhe kontrolloj kufirin shtetëror;** 1.8.ofroj ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe 1.9. kryej detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.

Siç është theksuar edhe më latë të gjithë të akuzuarit kanë qenë zyrtarë policor në pozitë e përkrahura më lartë, pranë Stacioni Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok dhe përgjegjësi dhe mision i tyre ka qenë që të njëjtë të garantojë siguri të shtuar kufitare duke parandaluar, zbuluar dhe duke kapur kriminelët e përfshirë në veprimtari të krimit ndërkufitar dhe kontrabandave të mallave dhe kontrabandave tjera të ndaluara me ligj dhe përgjegjësi tjera ligjore.

Nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari Z S si Komandat i SPMK në Zubin Potok, së bashku me të akuzuarit B N Udhëheqëse e ndërrimit (A), M M, A M dhe A H Zyrtarë Policor Patrollues, dhe të akuzuarit R M, J D, Z B, A P, R K, V T, B M, B L, zyrtarë policor pranë SPMK Zubin Potok të cilët janë shpallur fajtor në pikat I, II dhe III të aktgjykimit, me dashje nuk i kishin përmbushur detyrat zyrtare të cilat kanë qenë të obliguar me ligj, pra për parandaluar, zbuluar dhe kapur kriminelët e përfshirë në veprimtari të krimit ndërkufitar, ku ndër të tjera si detyre e tyre ka qenë edhe kontrollimi dhe mbikëqyrja e zonës kufitare në Zubin Potok, me qëllim të parandalimit dhe ndalimit të kontrabanimi të mallrave, të njëjtit për me tepër është vërtetuar se jo vetëm që nuk kishin përmbushur detyrat e tyre zyrtare por të njëjtit me dashje kishin bashkëpunuar me kontrabanduesit duke organizuar kalimin mallave në mënyrë ilegale dhe nga të njëjtit në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare kishin pranuar edhe shuma të parave sipas tarifave të vet përcaktuara nga 20 Euro për vetura të vogla, 30 – 60 Euro për furgona dhe 100 – 150 për çdo kamion.

6.Gjetjet e gjykatës në raport me të përgjegjësinë penale të akuzuarve;

Nuk ka mëdyshje se nga provat e administruara si: deklaratat e dëshmitarëve; dëshmitarit bashkëpunues, traskirpatave të bisedave, janë vërtetuar veprimet e secilit të akuzuar veç e veç.

Cilat janë veprimet e të akuzuarve të cilat i kanë ndërmarrë të akuzuarit në funksion të kryerjes së veprës penale, respektivisht cilat veprime të të akuzuarve ngërthejnë në vete përgjegjësinë penale, e për të cilat gjykata edhe i ka gjetur fajtor. Në vazhdim do të elaborohen provat në funksion të vërtetimit të veprimeve të secilit prej të akuzuarve, mbi të cilat gjykata i ka gjetur dhe i ka shpallur fajtor.

6.1 Lidhur me të akuzuarit në pikën I të aktgjykimit pjesa gjykuse A;

6.1.1 Për të akuzuarin Zvezan Spasojeviq;

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Z S, gjatë viteve 2017 deri në Maj 2019 ka qenë Komandat i Stacionit për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok, ashtu që në cilësi të personit zyrtar ka keqpërdorur autorizimet e tij, në atë mënyrë që i njëjti si komandant ishte në dijeni për bashkëpunimin e zyrtarëve policor me kontrabanduesit se të njëjtit janë duke i mundësuar – lejuar kontrabandimin e mallrave nëpër rrugë ilegale dhe se ishin duke përfituar materialisht shuma të ndryshme të parave, ku një pjesë e këtyre parave të marra nga zyrtarët policorë nga kontrabanduesit është ndarë edhe për të si komandat, ku i njëjti kishte pranuar shuma të ndryshme të parave nga zyrtarët policor të tij që i kishte nën komandë, ashtu që i njëjti si komandat me dashje nuk i ka kryer detyrat të cilat i kishte si domosdoshme të kryente e të cilat kanë qenë të përcaktuara me ligj, pra parandalimi-ndalimi i kontrabandimit të mallrave që ishte duke e bërë në këtë zonë dhe për më tepër në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare i njëjti kishin pranuar shumat e ndryshme të parave nga zyrtarët e tij policor të cilët i kishin marr nga kontrabanduesit.

Se e njëjti ka vepruar në këtë mënyre e vërteton fakti se ku pothuajse shumica e dëshmitarëve kanë deklaruar se nga zyrtarët policor të SPMK-së ku komandat ishte i akuzuari Z Spajoviq është realizuar kontrabanda.

Dëshmitari D1 gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar; ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë me datë 04.04.2019 në PSRK, ku me mes tjerash gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se *“të akuzuarin Zn se nuk e ka parë që të ketë marrë para, mirëpo ka dëgjuar se i njëjti ka marrë para” Ai tutje ka shtuar se është e vërtetë se vet e kishte dëgjuar të akuzuarën B duke thënë se komandanti ka kërkuar me i dhënë mjete dhe i kujtohet kur t’i ketë thënë vet e akuzuara B që po shkoj tek komandanti që t’ia dërgoj paratë.*

Ndërsa në deklaratën në PSRK dëshmitari D1, i pyetur se; *“a mundte flisni për mospajtimet me B N”*, i njëjti mes tjerash për të akuzuari Z ka deklaruar...*“për komandantin pas çdo ndërrimi edhe kur në tërën kur nuk grumbullohen para jemi të obliguar ti ndajmë ka 50 Euro për komandantin Z S nga rrogat tona”*. Ndërsa i i pyetur në deklaratën në PSRK se: *“a jeni në dijeni për paratë e përmendura të urdhëruara nga rreshterja B shkojnë në dore të Z S, i njëjti është përgjigjur “po jam i sigurt se B ja dërgon ne shtëpi paratë Z apo takohen në ndonjë lokal”*.

Po ashtu, kur është pyetur në deklaratën në PSRK nga prokurori : *“A jeni në dijeni se këta kontrabandistë sa dhe kujt i paguajnë për mallin e kontrabanduar në nivel muaji”*, i njëjti është përgjigjur se: *“ Po kam folur personalisht me kontrabanduesin M B i cili më ka pyetur se përse ju nuk punoni me komandant Z, po krijoni probleme kur të gjithë kontrabandistit në nivel muaji japim nga 500 Euro. Tash flitet se është ngritur kjo tarifë prej 500 deri në 700 Euro”*.

Gjykata deklaratën e dhënë të dëshmitarit D1 në PSRK-së, e vlerësoj si të besueshme për shkak se e njëjta është në harmoni me dëshminë e dëshmitarit F2 të dhënë në PSRK me datën 17.02.2019, i cili dëshmitar gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në PSRK dhe për të njëjtin fakt dhe të njëjtën rrethanë kishte deklaruar sikurse dëshmitari D1.

Dëshmitari F1, në deklaratën në PSRK, kur ishte pyetur se a jeni në dijeni se nga kontrabandimi i mallrave paguhet dikush nga eprorët e policisë në baza mujore, i njëjti kishte deklaruar se: *“kam dëgjuar nga kontrabanduesit dhe policet se në fund të muajit në një zarf mblidhet shuma prej 1500 Euro për komandantin Z S, këto para ja ka sjellë shoku i tij i shkollës me nofkën Zhermir, i cili banon në fshatin Banje dhe ja dërgon në adresën në shtëpi”*. I njëjti në të njëjtën deklaratë kishte theksuar se: *“ Kolegu Dejan Vukashinoviç më ka treguar që në njëherë në restorantin Beli Dvor ia kishte dhënë komandat Z S shumën prej 60 Euro, ku të njëjtat ia kishte vendosur brenda paqetave të cigareve, e ka marr paqetën e cigares e i kanë dalur paratë e përmendura ndërsa cigaret ia ka kthyer”*, po ashtu: *“Rreshterja B N ka kërkuar nga secili ekip nga 50 Euro për babën, i cili është Z S.*

Në këtë drejtim për të njëjtin fakt dhe të njëjtën rrethanë për ndarjen e parave sipas ndërrime për komandantin, pra për këtu të akuzuarin Z, këtë fakt e ka pohuar edhe dëshmitari bashkëpunues B M, i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *“një shumë e parave që është marrë nga kontrabanda është ndarë për të akuzuarin Z nga secili grup për ta dërguar në drekë”*. Gjykata

këtë deklaram të dëshmitarit bashkëpunues e vlerësoi si të besueshme për shkak se është në përputhje dhe me deklaratat e dëshmitarëve D1 dhe F2, po është në përputhje edhe me vet deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues të dhënë në PSRK në cilësi të dëshmitarit bashkëpunues.

Dëshmitari bashkëpunues B M gjatë dëshmisë se tij në PSRK të datës 11.10.2019, ka deklaruar si në vijim: kur ishte pyetur se: *“a mund te sqaroni se ndërrimi juaj kur keni marrë para prej kontrabanduesve nga sa dhe si i keni ndarë për komandantin Z S”*, i njëjti kishte deklaruar se: *“shuma që e kemi ndarë për komandantin Zka qenë prej 100 Euro në çdo ndërrim të ditës e cila ka përfshirë edhe kafën e mëngjesit ne restorantin Berior ku kane pire afër ndërrimit të ditës dhe ndërrimin e natës”*

Nga të lartpërmendurat gjykata pa mëdyshje ka vërtetuar faktin se i akuzuari Z S kishte qenë në dijeni për veprimtarin kriminale të zhvilluar në këtë zone, pra për kontrabandimin e mallrave dhe pranimin e parave nga zyrtarët policor ku ishte përgjegjës si komandant i stacionit policor, ashtu që njëjti përveç që nuk kishte ndërmarrë veprime për të parandaluar-ndaluar apo kapur personat përgjegjës që po ushtronin kontrabandim me mallra dhe duke kapur lajmëruar zyrtarët e tij policor të cilit ishin përfshirë në vepër penale, mirëpo i njëjti me dashje kishte bashkëpunuar me zyrtarët e tij policor të cilët i kishte nën mbikëqyrje ku me dashje kishte lejuar kontrabandimin për çka dhe më pas kishte pranuar tarifat e marra nga vet zyrtarët policor për kalimin e mallrave të kontrabanduara nga kontrabanduesit, për çka gjykata ka vërtetuar faktin se i njëjti me dashje dhe me qëllim të përfitimit për vete dhe të tjerët nuk kishte përmbushur detyrat e tij zyrtare, me çka keqpërdorë detyrën zyrtare.

Gjykata, ka vlerësuar dhe analizuar edhe dëshminë e dëshmitarit F M, mirëpo gjykata ka vlerësuar se dëshmia e tij nuk paraqet ndonjë gjë konkrete në aspektin e vlerësimit të veprimeve të akuzuarit për shkak se vet ky dëshmitar thekson se vet si zyrtar policor më shumë ka qëndruar në Stacion Policor dhe rrallë herë ka dalë në teren dhe në aspektin e vlerësimit personal ai nuk e kishte vërejtë Z se ishte shoqëruar me persona të dyshimtë. Mirëpo vlen të theksohet se edhe ky dëshmitar e pranon faktin se kishte dëgjuar nga koleget e tij për kontrabandën që po zhvillohej në atë pjesë, prandaj gjykata në përgjithësi dëshminë e këtij dëshmitari e vlerësojë si jo relevante për çështjen për shkak se ky dëshmitar ka dëshmuar në aspekt të përgjithshëm dhe jo për rrethanat dhe faktet që kanë qenë objekt i akuzës për të cilën gjykata e kishte në shqyrtim.

Lidhur me dëshminë e dëshmitarit N gjykata ka vlerësuar dhe analizuar edhe dëshminë e këtij dëshmitar dhe ardhur në përfundim se dëshmia e tij është teje e përgjithësuar dhe nuk mund të vlerësohet në aspektin shfajësimit apo fajësimit të të akuzuarit Z, për shkak se vetë ky dëshmitar kishte pohuar se kishte punuar në zyre të komandantit dhe logjistikë dhe se nuk kishte dalë në teren 5-6 herë për shkak se puna e tij nuk ishte në teren. Ai në mënyrë të përgjithësuar ka shpjeguar punën e të akuzuarit Z si komandat, ku i njëjti ka shpjeguar edhe një rast lidhur me një sulm i cili kishte ndodhur atij së bashku me të akuzuarin Z i cili sulm ishte bërë nga kontrabanduesit mirëpo që nuk ishte objekt i akuzës, prandaj gjykata në përgjithësi dëshminë e këtij dëshmitari e vlerësojë si jo relevante për çështjen për shkak se ky dëshmitar ka dëshmuar në aspekt të përgjithshëm dhe jo për rrethanat dhe fakte relevante që kanë qenë objekt i akuzës për të cilën gjykata e kishte në shqyrtim.

- Lidhur me pretendimin e mbrojtësit të të akuzuarit se nga dëgjimi i dëshmitarëve D1 dhe F2 nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ky pretendim është i pabazuar për shkak se gjykata ka dhënë arsye të hollësishme lidhur me faktet relevante që kanë përmendur këta dëshmitarë në raport me gjetjen fajtor e të akuzuarit Z S.

Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër se gjykata kishte refuzuar propozimet e mbrojtjes lidhur me provat materiale të dorëzuar me parashtrësën e datës 22.03.2023, me arsyetimin se të njëjtat janë prova relevante nga të cilat do të vërtetoi pafajësia se i njëjti kishte ndërmarrë veprime të nevojshme në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me Ligjin për Policinë e Kosovës dhe zonën e tij të policisë si komandant, sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim gjithashtu është i pabazuar për shkak se siç është theksuar edhe më lartë gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme sa i përket fakteve dhe provave deri te gjetja fajtor e të akuzuarit Z, ndërsa sa i përket provave materiale të propozuara nga mbrojtja gjykata të njëjtat i ka refuzuar për shkak se këto prova nuk kanë qenë relevante me objektin e akuzës, ngase të njëjtat kanë qenë raporte të oficerëve policore në periudha të ndryshme kohore prej vitit 2017 deri në vitin 2019, ashtu që gjykata këto raporte i ka vlerësuar si raporte që nuk kanë qenë të përfshira në objekt të aktakuzës ngase gjykata nuk ka prejdukuar në asnjë rrethanë faktin se i njëjti kishte ndërmarrë veprime të nevojshme në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me Ligjin në raste të caktuara, pra në rastet kur nuk kishin ndonjë bashkëpunim me kontrabanduesit tjerë jashtë objektit të akuzës, pra të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në objekt të aktakuzës, prandaj në raste të tilla gjykata pa mëdyshje ka konsideruar se ka pasur raste tjera kur i akuzuari por edhe zyrtarë tjerë të policisë kishin vepruar, përkatësisht i kishin ndaluar kontrabanduesit me të cilët nuk kishin bashkëpunim dhe ju kishin zënë mall të kontrabanduar në mënyrë ilegale.

6.1.2 Për të akuzuarën B N;

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se e akuzuara B N gjatë viteve 2017 deri në Maj 2019 ka qenë udhëheqëse e ndërrimit "A" pranë Stacionit Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok dhe e njëjta në cilësi të personit zyrtar ka keqpërdor autorizimet e saj në atë mënyrë që si udhëheqëse e ndërrimit së bashku me komandantin Z S dhe me të akuzuarit tjerë përkatësisht zyrtarët policor M M, A M dhe A H kishin bashkëpunuar me kontrabanduesit ku të njëjtit ju kishin mundësuar dhe lejuar kontrabandimin e mallrave nëpër rrugë ilegale për cka më pas kishin përfituar materialisht shuma të ndryshme të parave sipas tarifave të përcaktuara nga vet të njëjtit, ashtu që e njëjta me dashje nuk ka kryer detyrat të cilat i kishte si të domosdoshme t'i kryente e të cilat kanë qenë të përcaktuara me ligj, pra parandalimin-ndalimin e kontrabandimit të mallrave në zonën ku ishte përgjegjëse.

Se e njëjta ka vepruar në këtë mënyrë vërtetohet nga fakti se pothuajse shumica e dëshmitarëve kanë deklaruar se e akuzuara B N kishte pranuar para nga kontrabanduesit.

Dëshmitari D 1, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *"B dhe kolegët e saj i mblidhnin dhe i dërgonin rrugëve Qeqove kurse ajo mbetej në fshatin Banjë dhe pasi që kalonin kontrabandistët ajo i mblidhte paratë nga ata dhe në fund të ndërrimit i ndante me kolegët e saj nga 10, 20 ose 30 Euro, e ndonjëherë thoshte se nuk ka asgjë për t'u ndarë dhe kjo zakonisht ka ndodhë në fund të ndërrimit gjatë kthimit me veturë në Zubin Potok. Ai tutje ka shtuar se është e vërtetë se vet e*

kishte dëgjuar duke thënë se komandanti ka kërkuar me i dhënë mjete dhe i kujtohet kur t'i ketë thënë vet e akuzuara B që po shkoj tek komandanti që t'ia dërgoj paratë.

Gjykata dëshminë e dëshmitarit D1 e vlerësoi si të besueshme për shkak se e njëjta është në përputhje të plotë edhe me dëshminë e tij të dhënë në PSRK me datën 04.04.2019 ku i pyetur se a mund të na flisni për këto mospajtime me B N i njëjti kishte deklaruar se: “*në teren i ka udhëhequr nga tre apo katër persona, unë kur kam ardhur në këtë ekip më ka thënë se ajo është mënyra në bazë të së cilës punojmë. Ajo i njej kontrabandistët në teren dhe bashkëpunon me ta dhe se kontakton dhe dëgjohet me ta dhe i lejon të kalojnë kamionët me mallra ilegale në Banjë*”, mua dhe kolegët e tjerë më dërgojnë në rrugët Qeqove ajo ngelë në Banjë dhe pasi të kalojnë kontrabandistët ajo mbledhë paratë nga ta dhe në përfundim të ndërrimit i ndan me policët, na jep nga 10, 20 dhe 30 Euro, nganjëherë na thotë që nuk ka asgjë për të ndarë. Ky dëshmitar po ashtu kur ishte pyetur në PSRK se si kalojnë rrugën kontrabandistët dhe si i kryejnë obligimet, i njëjti ka theksuar se rreshterja B N dëgjohet me kontrabandistët përmes telefonit dhe merren vesh se po i lënë paratë në shitore, në pompë ashtu që siç ajo merret vesh me kontrabandistët.

Gjykata deklaratën e dhënë të dëshmitarit D1 në PSRK e vlerësoi si të besueshme për shkak se e njëjta është në harmoni me dëshminë e dëshmitarit F2 të dhënë në PSRK me datën 17.02.2019, i cili dëshmitar gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në PSRK edhe për të njëjtin fakt dhe për të njëjtën rrethanë kishte deklaruar ngjashëm sikurse dëshmitari D1. Mes tjerash, kishte deklaruar se: “*... se rreshterja B N ka kërkuar nga secili ekip nga 50 Euro për babën, i cili është Z S*”.

Pretendimi i mbrojtjes se pas tërheqjes së prokurorit të shtetit nga pika e aktakuzës për Marrje të rryshfetit si mbrojtje konsiderojnë se është e paqëndrueshme që e njëjta të ndiqet nën pikën e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar për arsye se nëse nuk është vërtetuar marrja atëherë si ka ndodhë keqpërdorimi i pozitës së pretenduar nga PSRK. Sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim është i pabazuar për shkak se gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret tek e akuzuara dhe të akuzuarit tjerë të cilët janë shpallë fajtor përmbushën dhe formohen elemente të veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar që vlerësimi se janë përmbushur elementet e veprës penale do të bëhet në pikën që ka të bëjë me elementet ligjore të veprës penale për shkak se gjykata ka ardhur në përfundim se të njëjtit duke mos përmbushur detyrat e tyre zyrtare të përcaktuar me ligj kanë lejuar kalimin e mallrave në mënyrë ilegale nga kontrabanduesit me qëllim të përfitimit për vete dhe për personat e tjerë për çka edhe nga të lartpërmendura është vërtetuar se kane pranuar shuma të ndryshme për çdo kalim të mallrave ilegale nga kontrabanduesit.

Pretendimi i mbrojtjes se nuk është vërtetuar bashkëpunimi me kontrabanduesit, përkatësisht me të akuzuarit e tjerë të cilët gjenden në arrati dhe atë D I, B R D D , M R, M R, Z V, gjykata lidhur me këtë pretendim ka dhënë arsyet të mjaftueshme se si është vërtetuar ky fakt në pikën 5 të aktgjykimit kur ka elaboruar lidhur me gjendjet faktike dhe cilësimi juridik në raport me gjendjet faktike për pikën I, II, III të dispozitivit të aktgjykimit pjesa Gjykuese A.

6.1.3 Për të akuzuarit M M, A M dhe A H;

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit e lartë përmendur, gjatë viteve 2017 deri në Maj 2019 kanë qenë zyrtar policor pranë Stacionit Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok, ashtu së bashku me komandantin Z S dhe udhëheqësen e ndërrimit B N të njëjtit në cilësi të personave zyrtar kanë keqpërdor autorizimet e tyre në atë mënyrë që si zyrtar policor kishin bashkëpunuar me kontrabanduesit ku të akuzuarit ju kishin mundësuar dhe lejuar kontrabandimin e mallrave nëpër rrugë ilegale për çka më pas kishin përfituar materialisht shuma të ndryshme të parave duke pranuar shuma të ndryshme të parave nga kontrabanduesit për secilin kalim të mallrave në mënyrë ilegale, sipas tarifave të përcaktuara nga vet akuzuarit, ashtu që i njëjti me dashje nuk ka kryer detyrat të cilat i kishte si të domosdoshme t'i kryente e të cilat kanë qenë të përcaktuara me ligj, pra parandalimi-ndalimi i kontrabandimit të mallrave që ishte duke e bërë në këtë zonë dhe për me tepër në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare kishin pranuar shumat e ndryshme të parave nga kontrabandusit.

Se e njëjti ka vepruar në këtë mënyrë e vërtetohet nga transkriptat e bisedave të nxjerra në Bazën e SPMK Zubin Potok dhe në veturat (Defender 141-02 dhe Defender 134-02), ku nga bisedat të cilët zhvillojnë të akuzuarit pa mëdyshje është vërtetuar bashkëpunimi në mes të akuzuarve pra mes njëri tjetrit dhe po ashtu është vërtetuar bashkëpunimi në mes të akuzuarve me kontrabanduesit lidhur me kalimin e mallrave nga kontrabanduesit dhe konfirmimi mbi pranimin e parave nga kontrabanduesit pas kalimit të mallit në mënyrë ilegale sipas tarifave të përcaktuara nga vet të akuzuarit.

Nga transkripti i datës 26.02.2019, ora 19:01:03- 19:01:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të B L, **M M, B M, B N**, ndër të tjera e akuzuara B ju thotë të pranishmëve që *“nuk pranoj të ju mbrojti dhe të humbë punën, derisa lëshojnë kamionë dhe i marrin paratë”*.

Nga transkripti i datës 26.02.2019 ora 21:46:31-21:47:36, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të B N, Dejan Vukasinovic **dhe A H**, ku ndër të tjera D V tregon që është zënë kamioni i M, ndërsa ndër të tjera e akuzuara B N tregon që këtë kamion e ka lëshuar zyrtari policor K S.

Nga transkripti i datës 26.02.2019 ora 21:49:11- 21:49:54, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të B N, Nikoleta Jovanovic dhe **A H**, ndër të tjera e akuzuara B N tregon për bisedën që ka pasur me B L, të cilit i ka thënë që nuk ka kolegialitet për derisa ata marrin para dhe në anën tjetër e njëjta me pas telashe, dhe ku e përmend Krston që i ka fut paratë në xhep.

Nga transkripti i datës 09.03.2019, ora 17:37:50- 17:39:00, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje-Zubin Potok në veturë (Defender 141-02), ishte incizuar biseda në mes të B N, **A H dhe A M-A** i cili gjate momentit të bisedës është dëgjuar duke fjetur, ndërsa e akuzuara B N bisedon me A H për shumën e parave që janë marrë nga kontrabanduesit e mallrave dhe sipas kësaj bisede këto para

200 Euro janë dhënë nga personat G, M dhe N, dhe është biseduar për të kaluar edhe diçka dhe nëse kalon bëhet 270 Euro, dhe A ka përmendur pas llogaritjes shumë nga 40 Euro.

Nga transkripti i datës 09.03.2019 ora 19:20:45-19:28:00, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 141-02), ishte incizuar në mes të **A M** dhe një personi NN Guri, dyshohet që Guri i sjell 70 Euro tek vetura ku ishte A M në emër të Mi, ndërsa pastaj hyn **A H**, të cilët bisedojnë se si personi NN Guri I ka lënë vetëm 70 për M dhe jo 80 Euro, sa është dashur që ti lë. Ndërsa **A H** ka potencuar që i ka mbi 200 Euro të cilët bisedojnë për ti ndarë ndërmjet B N, **A M**, **A H**, D Vc dhe **M M**. Në bisedë po ashtu dëgjohen se këto para i kanë lënë kontrabadiesit e mallrave si: G, M R dhe personi me nofkën N.

Nga transkripti i datës 13.03.2019, ora 17:34:35, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), është incizuar biseda në mes **A M dhe M M**, të cilët pastaj në telefon bisedojnë me një kontrabandist me të cilin nuk pajtohen në lidhje me çmimet që janë sa i përket lejimit të kontrabandimit të mallrave nga Serbia për në Kosovë, duke ofruar kontrabandisti një çmim tjetër sa i përket kontrabandimit mirëpo që të akuzuarit nuk pajtohen dhe më i zëshmi në bisedë është A M i cili thekson se çmimet duhet të rriten duke pasur parasysh dhe taksën e vendosur prej 100% nga R H, duke përmendur dhe çmimin prej 200 Euro për naftë, dhe bisedojnë **A M dhe M M** për ndarjen e parave, po ashtu përmendën çmimet tjera si 20, 50 dhe 70 Euro, si në transkript.

Nga transkripti i të datës 13.03.2019, ora 17:54:22 – 18:04:00, gjykata ka faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes **A M dhe M M**, dhe bisedës në telefon në mes D I, ku zhvillohet biseda në lidhje me çmimet sa i përket lejimit të D që të fus mall të kontrabanduar nga Serbia për në Kosovë rrugëve ilegale, mirëpo nuk mundën me u marrë vesh sa i përket çmimit që duhet të paguaj D për patrullën policore në krye me Biljanën. A M i'u thotë që nuk don të rrezikoj më shumë për 50 Euro, dhe se për sonte le të bëjnë çka të dojnë ndërsa ndryshe do të jetë nga ndërrimi i ardhshëm.

Nga transkripti i datës 13.03.2019, ora 18:04:40 – 18:19:39, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje - Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes **A M dhe M M**, përgjatë bisedës dëgjohen duke biseduar për rritjen e çmimeve për lejimin e automjeteve me mallra të kontrabanduara. Në bisedë flitet edhe për **Z (Komandantin)** për të cilin thonë se çka nëse pyet se kush i ka rritur çmimet, ndërsa A M është përgjigjur se nuk ma nin për Z, unë dua ta rrisë çmimin, duke shtuar se po kalohet nëpër rrugë kryesore, më herët kam marr 20-30 Euro vetëm të mos shkruaj dënime, ndërsa tash me plot mall, dogana 100%, dhe në ndërkohë dëgjohet në bisedë që vjen një kontrabandist për të pyetur se si të kalojnë rrugëve ilegale me mall dhe i njëjti i sjellë disa para për zyrtarët. Ndërsa A M në bisedë e sipër thekson se le të bëjnë çka të dojnë, unë nuk dua asgjë, bëni çka të doni.

Nga transkripti i datës 13.03.2019, ora 18:19:40 – 18:34:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes **A M**, **M M** dhe **B N** -udhëheqëse e ndërrimit, të cilët flasin në lidhje me rritjen e çmimeve sa i përket lejimit të kontrabandimit me mallra, dhe flasin për shqetësimin dhe rrezikun se mund të kapen duke marrë para, ndër të tjera në bisedë **A M** deklaroi: *”Nuk jemi kundër, por nëse rrezikoj ta di pse po rrezikoj, asgjë tjetër. Nuk jam kundër për këtë, por kur të rrezikoj bile të kam para për avokat”* dhe në komunikimet e njëri-tjetrit, **M M**, deklaroi: *“... Na i kanë marrë adresat, na i kanë marrë numrat, na i kanë marrë të gjitha dhe tash të na zënë në vepër, dhe kur ata të zënë më nuk del nga burgu..”*, pra në komunikimet me njëri tjetrin, të njëjtit deklarohen secili për shqetësimet e tyre rreth mundësisë që të njëjtit të arrestohen për veprimet që i kanë shkaktuar përmes lëshimeve të kontrabandimit të mallrave Serbe për në Kosovë. Po ashtu nga biseda e **A M**, i njëjti thekson *“..Nuk është hera e parë por kështu ma jo, nuk jam unë maxhup edhe 20 edhe 50... kur të rrezikoj ta di se çka po marrë”*.

Nga transkripti i datës 13.03.2019, ora 18:34:40 – 18:45, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të **B N**, **A M** dhe **M M**, të akuzuarit flasin sa automjete kanë kaluar gjatë ndërrimit të tyre dhe në një moment **A M** fillon të llogarisë automjetet që kanë kaluar përgjatë ndërrimit në vlerë monetare, duke përmendur vlerën 300 dhe 700 Euro, gjithsejtë 1000 Euro dhe llogaritje se sa automjete të vogla dhe kamion kanë kaluar.

Nga transkripti i datës 13.03.2019, ora 19:39:25 – 19:43:28, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të **A M** dhe **M M**, të njëjtit bisedojnë se sa automjete kanë kaluar gjatë ndërrimit të tyre për shkak të pagesave që duhet bërë nga ana e kontrabandistëve dhe flasin për 10 (dhjetë) automjete që kanë kaluar në mënyrë ilegale dhe e akuzuara **B N** në një moment gjatë bisedës i thotë **M M**, se nuk dua të punoj për këto para, më mirë të mos punoj asgjë sesa e tërë kjo kolonë të kaloj për aq para. Dhe bisedojnë për kamionët dhe kombit e ndryshëm se kujt i përkasin, 6 (gjashtë) kamion bisedojnë se i përkasin **Dades** (**D I-Dade**), 2 (dy) kamiona të (**M R**), 1 (një) kamion i **Milloshit** dhe 1 (një) tjetër i një personi me pseudonimin **Çuko**.

Nga transkripti i datës 13.03.2019, ora 20:25:45 – 20:37, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të **Kufirit** në Zubin Potok-(**Zyra** në **DR-Mitrovicë** e **Veriut**), ishte incizuar biseda në mes të **B N**, **A M** dhe **M M**, ku të njëjtit bisedojnë sa i përket punës në të cilën kanë hy, për sa i përket lejimit të automjeteve me mall të kontrabanduar, dhe bisedojnë për rrezikun që ka kjo punë. Po ashtu, bisedojnë për zyrtarët policor të tjerë të ndërrimit për të cilët dyshojnë se mund të flasin për sa i përket aktivitetit kriminal, dhe në bisedë e sipër **A M** thotë se nuk dua që të punoj më për këto çmime duke aluduar në rritjen e çmimeve për lejimin e automjeteve me mallra dhe thotë se sot do të punojmë kështu dhe pastaj ndryshe që kuptohet me çmime të reja.

Nga transkripti i datës 15.03.2019, ora 00:47:33 – 00:59:40, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në

veturën (Defender 134-02) ishte incizuar biseda në mes të **A H, V K dhe M M**, të njëjtit në veturë bisedojnë për problemet që i kanë pasur me tregtar-kontrabandistët sa i përket ngritjes së çmimit nga ana e Policisë për lejimin e automjeteve me mall të kontrabanduar nga Serbia për në Kosovë, Përgjatë bisedës përmendin disa tregtarë siç janë Dade, D I kontrabandist i mallrave. Në këtë bisedë përmendën edhe çmimet për lejimin e një kombi me mall e që është 70 Euro, një kamion 100 Euro, ndërsa kur flitet për shifrën prej 200 Euro për cisterna me naftë. Po ashtu përmendën fakti që ngritjen e çmimit për kontrabandistët e ka bërë Alberti (A M) dhe Bilja (B N). Dhe në bisedë e sipër i akuzuari **A H** pohon faktin se ka marrë dhuratë nga 20 Euro nga kontrabandistët që kanë kaluar me mall.

Nga transkripti i të datës 19.03.2019, ora 01:32:15 – 01:35:35, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të **M M**, Dejan Vukasinoviq dhe Vlado Kasmikovcki, ishte zhvilluar biseda rreth parave që janë marrë nga kontrabandistët e mallrave, më saktësisht përmendin emrin e një kontrabanduesi me emër Boban, dhe i cili u'a ka dhënë vetëm 100 Euro për dy (dy kamionë), dhe sipas bisedës shihet se ka pasur mi dhanë 2, që nënkuptohet nga biseda se është fjala për 200 Euro, dhe në bisedë dëgjohen të frustruar dhe duke biseduar për rritjen e çmimit për një kamion me mallra të bëhet çmimi prej 130 Euro. Po ashtu, flasin edhe për një person me emrin Dade (D I) për të cilin thonë se do të paguaj për këtë Bobanin.

Pretendimi e mbrojtjes lidhur me të akuzuarit në pikën 6.1.3

Pretendimi i mbrojtëses M M, Av.Nebojsa Vlajic se: “Nga dëgjimi i dëshmitarëve nuk është vërtetuar vepra penale për të cilën ngarkohet i akuzuari për shkak se të njëjtit kanë deklaruar se kanë dëgjuar se është keqpërdorur detyra se është marr ryshfet pa konfirmuar burimin e informacionin se nga kush ka dëgjuar, si kanë marrur ryshfet, pra si kanë ardhur në njohuri lidhur me këto fakte”, gjykata këtë pretendim e vlerësoj **si të pabazuar** për shkak se në raport me të akuzuarin M M, gjykata ka ardhur në përfundim se nuk ka dëshmuar ndonjë dëshmitar konkretisht lidhur me përgjegjësinë penale e të akuzuarit M M lidhur me veprimet e tij konkrete inkriminuese, por në mënyrë të përgjithësuar për fenomenin e kontrabandimit të mallrave dhe pranimit të parave nga zyrtarët policor dhe për disa të akuzuar konkret për të cilët gjykata i ka elaboruar edhe më lartë, mirëpo në raport me këtë të akuzuar përgjegjësia e tij penale është nxjerr në bazë të transkriptave të bisedave të lartpërmendura që vërtetojnë veprimet inkriminuese të të pandehurit ne raport me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Ndërsa sa i përket pretendimit se transkriptet e bisedës të njëjtat janë të papranueshme për shkak se nuk dihet se kush flet ne ato incizime, zëri i kujt është dhe kush flet, ky pretendim është i pabazuar për arsye se nga transkriptet e lartpërmendura përveçse është bërë identifikimi në mes kujt zhvillohen këto biseda, gjatë bisedës edhe të akuzuarit përmendin emrat e njëri-tjetrit.

Lidhur me pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit A M, av.Naim Rudari se: aplikimi i masave të fshehta ishte i paligjshëm pasi që ato ishin nxjerr pa aktvendim për fillim të hetimit pasi që ato ishin nxjerrë në emra konkret me emër dhe mbiemër, ato urdhëresa mund të ishin të ligjshme sikur te mos kishin asnjë person të dyshuar me emër dhe mbiemër dhe deri në atë moment që mësohet identiteti i ndonjërit do duhej të kishim aktvendim për fillimin e hetimeve, por nga momenti që ka pasur persona te dyshuar identiteti është ditur është dashur që te kishte

aktvendim për fillimin e hetimit dhe me pas ajo urdhërese do të ishte e ligjshme për të dyshuarit e tjerë për të cilët nuk është ditur ne ato momente. Sipas vlerësimit të gjykatës **ky pretendim është i pabazuar**, për shkak se në këtë çështje penale kanë qenë duke u zhvilluar hetimet për personat zyrtar që kanë të bëjnë me Stacionit Policor të Leposaviqit, ku më pas ishte bërë zgjerimi i hetimit edhe për zonën SPMK-Zubin Potok, përkatësisht për kontrabanduesit- të pandehurit Izet Jashari etj dhe lëshimi i urdhëresës për hetimin e masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit të cilat ishin lëshuar ndaj akuzuarve Z S, O K, B N, D K, kjo urdhëresë ndaj tyre ishte lëshuar pa aktvendim për fillimin e hetimeve gjë që është konstatuar edhe sipas aktvendimin me numër PS.nr.23/20 të datës 20.08.2020, i cili vendim është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit-Departamentit Special, me numër PN.1.S.nr.111/2020 të datës 18.11.2020 , ashtu që si të tilla provat-përkatësisht transkriptat e bisedave ndaj të pandehurve të lartpërmendur janë shpallur si prova të papranueshme në raport me të akuzuarit e lartpërmendur, mirëpo edhe pse në aktvendimin e lartpërmendur kjo çështje është tejkaluar, kjo gjykatë rithekson se urdhëresa me të cilën ishin lëshuar masat e fshehta të vëzhgimit dhe hetimit ishte lëshuar edhe ndaj personave N.N, pra ndaj të dyshuarve të cilët në kohën kur ishin zbatuar këto masa nuk është ditur identiteti i tyre, e që më pas janë identifikuar, pra pas aplikimit të masave të fshehta, për çka nga ana e PSRK-së me pas hetimi është formalizuar edhe me aktvendimin për fillimin e hetimeve ndaj të njëjtëve me datë 06.05.2019, e që në hetim ishte përfshirë edhe i akuzuari A M. Prandaj, kjo gjykatë konsideron se këto prova janë të pranueshme dhe se pretendimet e mbrojtjes nuk qëndrojnë-janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se nga dëshmitarët D1 dhe F2 nuk ishte përmendur emri i të akuzuarit A M dhe nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim **është i pabazuar** pasi që gjykata ka ardhur në përfundim se nuk ka dëshmuar ndonjë dëshmitar konkretisht lidhur me përgjegjësinë penale e të akuzuarit A M lidhur me veprimet e tij konkrete inkriminuese, por në mënyrë të përgjithësuar për fenomenin e kontrabandimit të mallrave dhe pranimit të parave nga zyrtarët policor dhe për disa të akuzuar konkret për të cilët gjykata i ka elaboruar edhe më lartë, mirëpo në raport me këtë të akuzuar përgjegjësia e tij penale është nxjerr në bazë të transkriptave të bisedave të lartpërmendura që vërtetojnë veprimet inkriminuese të të pandehurit ne raport me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Pretendimi i mbrojtjes së të akuzuarit A H, Av.Albana Kelmendi se nuk është e qartë se në çfarë forme është kryer keqpërdorimi me mos përmbushje apo tejkalim si dhe nuk është vërtetuar faktin se kush ka përfituar ne rastin konkret, nëse po sa është përfitimi, e sipas vlerësimit të gjykatës këto pretendime **janë të pabazuara** për shkak se fillimisht nga provat e administruara është vërtetuar se ne rastin konkret kemi të bëjmë me mos përmbushje të detyrës zyrtare si forme e kryerjes tek vepra penale nga neni 422 të KPRK-së, ndërsa sa i përket faktit se nuk është vërtetuar se kush ka përfituar dhe sa është ky përfitim sipas vlerësimit të gjykatës padyshim nga transkriptat e bisedave të lartpërmendura është vërtetuar se i njëjti kishte pranuar shumën të ndryshme të parave ku një njëri nga bisedat ndër të tjera e pohon se kishte marr 20 € për kontrabandimin e mallrave me çka iu kishte mundësuar edhe kontrabanduesve përfitim për kalimin e mallrave pa iu nënshtruar kontrolleve të detyrueshme doganore.

6.2 Lidhur me të akuzuarit në pikën II të aktgjyqimit pjesa gjykuse A;

6.2.1 Për të akuzuarit R M, J D, Z B, A P

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit lartë përmendur, gjatë viteve 2017 deri në Maj 2019 kanë qenë zyrtar policor pranë Stacionit Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok, të njëjtit në cilësi të personave zyrtar kanë keqpërdor autorizimet e tyre në atë mënyrë që si zyrtar policor kishin bashkëpunuar me kontrabanduesit ku të akuzuarit ju kishin mundësuar dhe lejuar kontrabandimin e mallrave nëpër rrugë ilegale për çka më pas kishin përfituar materialisht shuma të ndryshme të parave duke pranuar shuma të ndryshme të parave nga kontrabanduesit për secilin kalim të mallrave në mënyrë ilegale, sipas tarifave të përcaktuara nga vet akuzuarit, ashtu që i njëjti me dashje nuk ka kryer detyrat të cilat i kishte si të domosdoshme t'i kryente e të cilat kanë qenë të përcaktuara me ligj, pra parandalimi-ndalimi i kontrabandimit të mallrave që ishte duke e bërë në këtë zonë dhe për me tepër në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare kishin pranuar shumat e ndryshme të parave nga kontrabanduesit.

Se e njëjti ka vepruar në këtë mënyrë e vërtetohet nga transkriptat e bisedave të nxjerra në Bazën e SPMK Zubin Potok dhe në veturat (Defender 141-02 dhe Defender 134-02), ku nga bisedat të cilët zhvillojnë të akuzuarit pa mëdyshje është vërtetuar bashkëpunimi në mes të akuzuarve pra mes njëri tjetrit dhe po ashtu është vërtetuar bashkëpunimi në mes të akuzuarve me kontrabanduesit, kalimi i mallrave nga kontrabanduesit dhe konfirmimi mbi pranimin e parave nga kontrabanduesit pas kalimit të mallit në mënyrë ilegale sipas tarifave të përcaktuara nga vet të akuzuarit.

Nga transkripti i datës 17.02.2019 ora 19:30:04, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda e zhvilluar biseda në mes të akuzuarve **Z B dhe R M**, nga e cila bisedë Z B theksonte se: *“Duhet me thirrë D sonte me i'a dhanë gato, a e thërrasim sonte”*. Ashtu që R M i thotë *“E thërrasim bre q.. n..”*.

Nga transkripti i datës 17.02.2019 ora 19:33:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda e zhvilluar në mes të të akuzuarve **Z B, R M dhe J D**, ku ndër të tjera kanë biseduar Z B i cili thoshte se: *“Ia kam dhënë atë ditë, atë ditë në sabah që shkum me kerr i'a kam dhënë”*, ndërsa i akuzuari R M në bisedën theksonte se *“Edhe ti i'a ke dhanë n'sabab”*, ku i akuzuari Z B pohonte me fjalën: *“Po”*. Ndërsa J D në bisedë me të akuzuarin R M, deklaronte se *“Për mua ishin 50 dhe tre herë 10”*, nga e cila transkript vërtetohet se të akuzuarit Z B, R M dhe J D kanë marrë nga 20 Euro për person, dhe në këtë transkript të akuzuarit vetëm ishin dyshuar se 20 Euro kanë marrë edhe zyrtarët policor A P, B M-B, D S K si dhe D K.

Nga transkripti i datës 17.02.2019 ora 20:17:24, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut) e akuzuara **J D** kishte biseduar me Bozidar Milosavljevic-Boza ose D S (njërin nga këta), ku e akuzuara D pyet se në ndërrimin e kaluar a i'a ka dhënë paratë zyrtarit policor **A P**, sepse D-K-P po i kërkonte paratë e veta, e cila bisedë ishte vazhdimësi e bisedës së datës 17.02.2019, orës 19:33:38 ndërmjet **J D, R M dhe Z B**.

Nga transkripti i datës 17.02.2019 ora 19:33:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda e zhvilluar në mes të akuzuarit **Z B, R M dhe J D**, ku e akuzuara **J D** thekson se:” *Ato në mëngjes, a ja ke dhënë*”, i akuzuari **Z B** përgjigjet:” *Po, po A ja kam dhënë, ja kam dhënë A paratë*”, dhe në bisedë e akuzuara deklaronte se B e A u’a kam dhënë 50, ata më kanë dhënë. Nga kjo bisede vërtetohet se biseda që është zhvilluar mes të akuzuarve për ndarjen e parave në mes të akuzuarve **Z B, R M, J D, A P, R K**.

Nga transkripti i datës 17.02.2019 ora 20:36:19, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të akuzares **J D** dhe një personi të paidentifikuar dhe e akuzuara **J D** tregon që të akuzuarit **R M** i’a ka dhënë 80 Euro dhe këto të holla i kanë ndarë mes vete **J D, A P, D S-K** dhe **B M-B**. Nga transkripti i datës 25.02.2019 ora 19:44:21, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të akuzuarve **R M – R** dhe zyrtarëve policor **D K** dhe **A P**, në të cilën bisedë flasin që të mos lëshojnë askënd (dyshohet për kamionët me mall) deri në ora 6 të mëngjesit.

Nga transkripti i datës 05.03.2019, ora 19:45:30- 19:46:30, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të **O K, B M dhe A P**, të cilët kanë biseduar për situatën kur **B M** ka marrë para dhe për kamerën që ka pasur **M**, dhe për çështjen nëse kamera merr pamje video apo vetëm regjistrime audio, në bisedë e sipër pas pohimit nga **A P** nuk ka kamera, i akuzuari **B M** theksonte se tash e kam më lehtë se sa herë kam hy dhe kam marrë para aty.

Nga transkripti i datës 13.03.2019, ora 20:24:54, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të **A P dhe Z B**, flitet për 100 Euro që i ka lënë **V**, dhe për 10 Euro të tjera që i ka dikush të cilës i referohen në bisedë me meçka.

Nga transkripti i datës 13.03.2019, ora 20:09:24 – 20:15:16, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes të **A P, B M dhe J D**, të cilët bisedojnë për paratë që i kanë marrë dhe për mënyrën se si i kanë ndarë këto para, nga leximi i transkriptes kuptohet që **A P B M, J D**, i kanë marrë nga 10 Euro për person dhe po ashtu në bazë të bisedës dyshohet se nga 10 Euro kishin marr edhe zyrtarët policor **B P, Z B, O K, D K-P** dhe **D S-K**, po ashtu për **B P** flasin që ka mbetur edhe 30 Euro për me i nda më vonë.

Nga transkripti i datës 04.05.2019, ora 20:00:57 – 20:02:20, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të **R M dhe J D**, kjo e fundit e pyet **R** se i kanë kaluar mbrëmë, i njëjti i përgjigjet se kurrqysh pasi që nga 230 Euro që i kishte marrë nga kontrabanduesit e mallrave, që të gjitha këto para i kishte ndarë policëve dhe vetëm 20 i

kishin mbetur atij (R). Nga biseda kuptohet se parat i kishe marr nga kontrabanduesit përmend emrat e M R, Z V-C, D I, duke treguar dhe se nga cila pjesë kanë kaluar me mallra të kontrabanduara.

Nga transkripti i datës 25.05.2019, ora 00:34:05 – 00:34:25, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të **R M**, dhe D S te cilët flasin për paratë që i kanë marr dhe për mënyrën se si kanë ndarë këto para. Nga kjo bisedë kuptohet që të lartshënuarit i kanë marr nga 50 Euro dhe po ashtu në bazë të bisedës të lartshënuarit kontaktojnë në telefon me kontrabanduesin e mallrave Z V-C, një person tjetër me emrin V, person me pseudonimin K K dhe mënyrën se si i ndihmojnë në veprimet e tyre të jashtëligjshme. Po ashtu, flasin edhe për kontrabanduesit tjerë si D I, R I-R, kontrabanduesit tjerë N, M R etj.

Nga transkripti i datës 25.05.2019, ora 00:40:05 – 00:40:19, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të **R M** dhe një personi që dyshohet që mund të jetë Z V-C, dëgjohen duke i thënë akuzuari R M personit në bisedë me fjalët : “ Mirë, kryeje ti me të, merrja ti, pastaj na i jep”, që vërtetohet se është bërë bisedë për shpërndarjen e parave me njëri tjetrin.

Nga transkripti i datës 25.05.2019, ora 00:42:30 – 00:43:07, gjykata ka vërtetuar se faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje – Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte inxhizuar biseda në mes të **R M** dhe personave të dyshuar të mallrave me emrin V dhe tjetri me pseudonimin K, bisedojnë për mallrat e kontrabanduara dhe përgjatë bisedës telefonike personi me emrin K del nga vetura dhe nuk dëgjohet mes tyre.

Pretendimi e mbrojtjes lidhur me të akuzuarit në pikën 6.2.1

Lidhur me pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit R M, Av.Arlinda Avdimetaj Fejzullahu se transkriptet e bisedave telefonike të cilat janë administruar si provë në raport me të akuzuarin R M janë të paligjshme, sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim **është i pabazuara** për shkak se rrethanat i ka ngritur mbrojtësja janë elaboruar nga ana e gjykatës në raport me pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A M, av.Naim Rudari dhe qëndrojnë arsyet e njëjta lidhur me këtë pretendim.

Lidhur me pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit J D, av.Asdren Hoxha lidhur me atë se prokuroria nuk është vërtetuar koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale e aq më tepër ekzistimi i marrëveshjes me të akuzuarit e tjerë, sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim i mbrojtjes **është i pabazuar** për arsye se në dispozitivin e këtij aktgjykimit është përshkruar në mënyrë të qartë koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale, ndërsa sa i përket formës së bashkëpunimit-bashkëkryerjes gjykata do të elaboroj tek analiza ligjore lidhur me elementet e veprës penale.

Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër të mbrojtësit av.Asdren Hoxha, se transkriptet e bisedave janë të paligjshme për arsye se të njëjtat nuk janë zbatuar-nxjerrë nga ana e zyrtarëve të IPK-së si organ i vetëm dhe kompetent për të hetuar zyrtarët policor, por nga zyrtarët policor-kolegët e tyre duke u thirrur në ligjin për IPK-në por pa saktësuar ndonjë dispozitë konkrete ligjore, sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim gjithashtu është i pa bazuar për shkak se sipas Ligjit nr.03/L-231 për IPK-në, përkatësisht nenit 17 paragrafit 11, përcaktohet se: *“Në pajtim me ligjin ne fuqi, policia dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit mund të bëjnë hetime dhe arrestime të punonjësve të policisë. Nëse përcaktohet se punonjësi i policisë ka kryer veprë penale, policia dhe institucionet tjera për zbatimin e ligjit janë të detyruar të njoftojnë IPK- në rastin e parë të mundshme pa i dëmtuar hetimet”* e që në rastin konkret gjykata ka ardhur në përfundim se IPK së bashku me policinë kanë qenë të përfshira në hetim pra IPK vetëm ishte e njoftuar për hetimin e zyrtarëve policor dhe po ashtu gjykata ka vlerësuar se qëndron edhe arsyetimi i dhënë nga Prokurori i shtetit nga PSRK – Burim Çerkini i cili në shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë pretendim ka deklaruar se në rastin konkret kemi pasur të bëjmë me persona fizik dhe persona zyrtar, pra kishte qenë hetim i përbashkët i kontabanduesve si persona fizik dhe zyrtarëve policor të cilët kishin lejuar kalimin e mallrave në mënyrë ilegale dhe ashtu që sipas dispozitës së lartpërmendur nuk kërkohet në mënyrë decitive që IPK duhet të zhvillojë hetim për shkak se në dispozitë përcaktohet se: *“policia dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit mund të bëjnë hetime... pra si obligim është përcaktuar se institucionet janë të detyruar të njoftojnë IPK- në, për çka në rastin konkret IPK ishte e njoftuar. Prandaj, sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim është i pabazuar* ashtu që provat që janë nxjerrë përmes aplikimit të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit janë prova të ligjshme dhe të pranueshme.

Ndërsa sa i përket pretendimit të mbrojtëses të akuzuarit Z B, av.Zehra Verbovci, të njëjtat gjykata i ka vlerësuar dhe ka ardhur në përfundim se të njëjtat pretendime kanë qenë të përgjithësuara duke theksuar se nuk është vërtetuar fajësia e të pandehurit Z B për shkak se e gjithë boshti i akuzës është mbështetur në trillime të pabazuara, paargumentuara dhe të paartikuluara dhe se i akuzuari Z B nuk ka mundësi të ketë kryer veprën penale, andaj sipas vlerësimit të gjykatës këto pretendime **janë të pabazuara** për arsye se lidhur me përgjegjësinë penale të akuzuarit janë vërtetuar nga transkriptet e bisedave që janë elaboruara më lartë në raport me këtë të akuzuar.

Ndërsa sa i përket pretendimit të mbrojtësit të akuzuarit A P, av.Vehbi Beqiri, lidhur me çështjen se nuk është vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve D1 dhe F2 dhe dëshmitarëve tjerë fajësia e të akuzuarit ngase nuk ishte përmendur emri i të akuzuarit A P dhe nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim **është i pabazuar** pasi që gjykata ka ardhur në përfundim se nuk ka dëshmuar ndonjë dëshmitar konkretisht lidhur me përgjegjësinë penale e të akuzuarit A P lidhur me veprimet e tij konkrete inkriminuese, por në mënyrë të përgjithësuar për fenomenin e kontrabandimit të mallrave dhe pranimin të parave nga zyrtarët policor dhe për disa të akuzuar konkret për të cilët gjykata i ka elaboruar edhe më lartë, mirëpo në raport me këtë të akuzuar përgjegjësia e tij penale është nxjerrë në bazë të transkriptave të bisedave të lartpërmendura që vërtetojnë veprimet inkriminuese të të pandehurit në raport me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, ndërsa sa i përket shpalljes si prova të papranueshme të transkriptave të bisedave, se transkriptet e bisedave të cilat janë administruar si provë në raport me të akuzuarin A P se janë të paligjshme, sipas vlerësimit të gjykatës të njëjtat

janë të pabazuara për shkak se rrethanat i ka ngritur mbrojtësi janë elaboruar nga ana e gjykatës në raport me pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A M, av.Naim Rudari dhe kjo gjykate konsideron se qëndrojnë arsyet e njëjta lidhur me këtë pretendim.

6.3 Lidhur me të akuzuarit në pikën III të aktgjykimit pjesa gjykuse A;

6.3.1 Për të akuzuarin B M;

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, i akuzuari B M, e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 lidhur me par.2, nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së të përcaktuar si në pikën II të aktakuzës, andaj trupit gjykues pas marrjes së mendimit nga mbrojtësi dhe Prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, ka marr aktvendimin me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit B M, për veprën penale për veprën penale të lartpërmendur për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së.

Gjatë pranimit të fajësisë trupi gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij avokaten Fatlume Korça – Sekiraqa nga Prishtina, dhe se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarit B M ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2, nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së.

6.3.1 Për të akuzuarit R K, V T dhe B L,

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit lartë përmendur, gjatë viteve 2017 deri në Maj 2019 kanë qenë zyrtar policor pranë Stacionit Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Zubin Potok, të njëjtit në cilësi të personave zyrtar kanë keqpërdor autorizimet e tyre në atë mënyrë që si zyrtar policor kishin bashkëpunuar me kontrabanduesit ku të akuzuarit ju kishin mundësuar dhe lejuar kontrabandimin e mallrave nëpër rrugë ilegale për çka më pas kishin përfituar materialisht shuma të ndryshme të parave duke pranuar shuma të ndryshme të parave nga kontrabanduesit për secilin kalim të mallrave në mënyrë ilegale, sipas tarifave të përcaktuara nga vet akuzuarit, ashtu që i njëjti me dashje nuk ka kryer detyrat të cilat i kishte si të domosdoshme t'i kryente e të cilat kanë qenë të përcaktuara me ligj, pra parandalimi-ndalimi i kontrabandimit të mallrave që ishte duke e bërë në këtë zonë dhe për me tepër në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare kishin pranuar shumatat e ndryshme të parave nga kontrabandusit.

Se e njëjti ka vepruar në këtë mënyre e vërtetohet nga transkriptat e bisedave të nxjerra në Bazën e SPMK Zubin Potok dhe në veturat (Defender 141-02 dhe Defender 134-02), ku nga biesat të cilët zhvillojnë të akuzuarit pa mëdyshje është vërtetuar bashkëpunimi në mes të akuzuarve pra mes njëri tjetrit dhe po ashtu është vërtetuar bashkëpunimi në mes të akuzuarve me kontrabanduesit, kalimi i mallrave nga kontrabanuesit dhe konfirmim mbi pranimin e parave nga kontrabanduesit pas kalimit të mallit në mënyrë ilegale sipas tarifave të përcaktuara nga vet të akuzuarit.

Nga transkripti i datës 17.02.2019 ora 19:33:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda e zhvilluar në mes të akuzuarit Z B, R M dhe J D, ku e akuzuara J D thekson se:” *Ato në mëngjes, a ja ke dhënë*”, i akuzuari Z B përgjigjet:” *Po, po A ja kam dhënë, ja kam dhënë A paratë*”, dhe në bisedë e akuzuara deklaronte se B e A u’a kam dhënë 50, ata më kanë dhënë. Nga kjo bisede vërtetohet se biseda që është zhvilluara mes të akuzuarve për ndarjen e parave në mes të akuzuarve Z B, R M, J D, A P, **R K**.

Nga transkripti i datës 18.02.2019 ora 15:55:42, dhe në intervale tjera gjatë asaj dite gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të akuzarës B T dhe një personi të cilin e thërret G, me të cilin bisedon dhe i thotë se “*ato janë për mua, po të them, a po më dëgjon*” si dhe në bisedën në mes të akuzares B T dhe **B L**, nga e cila bisedë B T është caktuar që të qëndroj si kujdestare në bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të kufirit-Zubin Potok në Mitrovicë të Veriut,

Nga transkripti i datës 26.02.2019 ora 19:01:03- 19:01:38, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes **B L, M M, B M, B N**, ndër të tjera e akuzuara B ju thotë të pranishmëve që “*nuk pranoj të ju mbrojt dhe të humbë punën, derisa lëshojnë kamionë dhe i marrin paratë*”.

Nga transkripti i datës 26.02.2019 ora 21:49:11- 21:49:54, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikëqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes të B N, N J dhe A H, ndër të tjera e akuzuara B N tregon për bisedën që ka pasur më **B L**, të cilit i ka thënë që nuk ka kolegialitet për derisa ata marrin para dhe në anën tjetër e njëjta me pas telashe, dhe ku e përmend K që i ka fut parat në xhep.

Nga transkripti i datës datës 23.03.2019, ora 19:51:04 – 19:52:00 dhe ora 20:02:00 – 20:04:30, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikëqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes **R K dhe B M**, të njëjtit bisedonin për një veturë Golf 5 që e kanë parë në Lluzhan dhe me siguri se ata do të jenë sonte në teren dhe se duhet të kenë kujdes të mos lëshojnë asgjë deri ne ora 4-5 e mëngjesit. R K tregon se ka folur me M(M R kontrabanduesin e mallrave), dhe i ka thënë se

nëse punon duhet me përcjell terrenin me veturë, po ashtu gjatë bisedës të njëjti flasin se si po flitet se janë duke u përcjell dhe se do të ketë arrestime.

Nga transkripti i datës datës 23.03.2019, ora 23:47:30 – 23:49:00, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes **B M**, **L V** dhe **R K**, në këtë bisedë **L V** nuk ka qenë e përfshire, ndërsa **B M** dhe **R K** bisedojnë për paratë që kanë marrë nga kontrabanduesit, përgjatë bisedës dëgjohen duke kalkuluar shumat që i kanë mbledhur dhe përmendet shuma prej 800 Euro, ku flitet për paratë që i kanë marr nga D (D I-kontrabandues lopëve dhe M R-kontrabandues i mallrave).

Nga transkripti i datës 28.03.2019, ora 07:04:00 – 07:04:50, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes **B T** dhe **V T**, ku fillimisht **V** i thotë **B** se është dashtë me i dhanë edhe nga 10 Euro më shumë bile me u ba 50 Euro dhe gjatë bisedës dëgjohet **B T** që nuk pranon të merr para, ndërsa **V T** e telefonin **R K** në të cilën bisedë e informon për **B** e cila nuk dëshiron që ti marrë paratë.

Nga transkripti i datës 28.03.2019, ora 07:44:49 – 07:45:22, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave të Stacionit Policor për Mbikqyrje- Zubin Potok në veturën (Defender 134-02), ishte incizuar biseda në mes **B T** dhe **V T**, ku në bisedë dëgjohet **V T** që i thotë **B** që “unë do ti kthej të mijat” që nënkuptohet për paratë, dhe **B T** në bisedë i thotë që të verifikoj nëse kanë kaluar më shumë që nga biseda nënkuptohet se flitet për automjete me mall të kontrabanduar.

Nga transkripti i datës 20.04.2019, ora 20:44:39– 20:49:10,, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes **R K** dhe **K S**, përgjatë bisedës telefonike bisedojnë për shumën prej 560 Euro të cilat i kanë marrë nga kontrabanduesit e mallrave, të cilat janë marrur nga **M** (**M R**) dhe nga personi me emrin **M**-djali i **Z V**-Ç, dhe në bisedë e sipër të njëjtat bisedojnë për mundësinë që ndokush prej zyrtarëve policor ti ketë marrë paratë nga kontrabanduesit dhe të mos i kenë deklaruar saktë shumën e parave që janë grumbulluar.

Nga transkripti i datës 12.04.2019, ora 21:38:25 – 21:39:17, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda në mes **R K** dhe personit që dyshohet të jetë **K S**, ku së bashku bisedojnë për koordinimin sa i përket kalimit të mallrave të kontrabanduesve nga Serbia për në Kosovë.

Nga transkripti i datës 12.04.2019, ora 23:01:22 – 23:01:45, gjykata ka vërtetuar faktin se përmes masës së fshehtë të monitorimit të bisedave në Bazën e Stacionit Policor për Mbikqyrje të Kufirit në Zubin Potok-(Zyra në DR-Mitrovicë e Veriut), ishte incizuar biseda e **R K** dhe një personi që dyshohet të jetë kontrabandues i mallrave, të cilët zhvillojnë bisedën për mundësinë e kalimit të mallrave dhe në bisedë e sipër **R K** e njofton se mund të kalojnë mallrat e kontrabanduara. Në ora 23:02:03 – 23:03:48, kjo bisedë vazhdon e incizuar atë ditë kur një kamion me mall të

kontrabanduar e i lëshuar nga zyrtarët e SPMK-Zubin Potok është zënë nga SHDPK sipas rastit 2019-YI-02, kamioni me mall ka qenë i tregtarit M R nga Zubin Potoku ndërsa në këtë kamion ka qenë duke vozitur Dalibor Djukic në të cilën atë ditë kanë folur disa zyrtar policor nga ky stacion. Ndërsa në ora 23:04:37 – 23:04:53, përsëri **R K** zhvillon bisedë me një person dyshohet të jetë kontrabandist i mallrave atë mënyrë që i akuzuari R K deklarohej rreth automjeteve me mallra të kontrabanduara e që e cek se janë në rrugë dy kombi që kanë për të kaluar mallrat e të cilët bisedojnë rreth mundësisë së kalimit të mallrave dhe i akuzuari R K e lajmëron përmes telefonit të dyshuarin për kontraband dhe se të do ta lajmëroj për çdo gjë.

Pretendimi e mbrojtjes lidhur me të akuzuarit në pikën 6.3.1

Lidhur me pretendimin e mbrojtësit të akuzuarit R K, Av. Isa Salihi, V T av. Mimoza Zabeli dhe B L av. Predrag Miljkovic se nga provat e administruara nuk është vërtetuar fajësia e të akuzuarve që kanë qenë pretendime të ngjajshme, kjo gjykatë vlerëson se këto pretendime **janë të pabazuara** për shkak se gjykata ka dhënë arsye të mjaftushme sa i përket gjetjeve të gjykatës në raport me të përgjegjësinë penale të secilit të akuzuar. Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër të ngritur nga mbrojtësit se transkriptet e bisedave të cilat janë administruar si provë në raport me të akuzuarin R K, V T dhe B L janë prova të paligjshme dhe si të tilla duhet të shpallën si prova të pa pranushme, sipas vlerësimit të gjykatës këto pretendime **janë të pabazuara**, për shkak se rrethanat e ka ngritura mbrojtja janë elaboruar nga ana e gjykatës në raport me pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit A M, av. Naim Rudari dhe qëndrojnë arsyet e njëjta lidhur me këto pretendimet edhe në raport mbrojtësit e lartpërmendur.

7. Elementet e veprës penale – Vlerësimi ligjor i veprës penale

- Në nenin 422 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar e kryen: *“Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.*

- Ndërsa në nenin 31 të KPRK-së, është parashikuar bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit ashtu që parashikuar që: *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”.*

- Ndërsa në nenin 81 të KPRK-së, është përcaktuar dënimi për veprat penale në vazhdim, në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: nënparagrafët: 1.1.viktimit të njëjtë të veprës penale; 1.2.objekti i njëjtë i veprës; 1.3.shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore; 1.4.vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe 1.5. dashja e njëjtë e kryesit”.*

Sipas nenit 21 paragrafi.2 të KPRK-së është përcaktuar dashja si element subjektiv i veprave penale, në cilin nen përcaktohet se: *“Kryesi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj, ndërsa sipas nenit 21 par.3 të KPRK kryesi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.* Rrjedhimisht për të akuzuarit të cilët janë shpallur fajtor në pikën I, II dhe III në pjesën gjykuese A, gjykata nuk pati dilemë se të njëjtit me dashje direkte e kanë kryer veprën penale. Të njëjtit jo vetëm që e kanë ditur se veprimet e tyre janë në kundërshtim me detyrat dhe autorizimet e tyre por e kanë ditur se edhe pasojat e këtyre veprimeve janë të rënda por janë pajtuar edhe i kanë dashtë apo i kanë pranuar ato. Pra, të akuzuarit kanë qenë të vetëdijshëm për qëllimin e njëri tjetrit çfarë dëshirojnë të arrijnë, kanë përkrahur njëri tjetrin, janë marrë vesh që të ndërmarrin veprime të caktuara, në drejtim të realizimit të qëllimit të cilin e kanë pranuar si të përbashkët dhe me këtë të njëjtit veç kanë hyrë në zonën inkriminuese.

Në lidhje me mënyrën e bashkëpunimit në mes të akuzurave përaktëisht bashkëkryerjes sipas nenit 31 të KPRK-së, gjykata pas administrimit të provave materiale gjeti se të akuzuarit të cilët janë shpallur fajtor në pikën I, II, III të pjesës gjykuese A, kanë bashkëpunuar mes veti sepse me prova është vërtetuar se ka ekzistuar marrëveshje dhe bashkëpunimi grupit të policëve që kanë qenë në ndërrim. Gjykata ka gjetur se secili ndërrim ka bashkëpunuar mes veti ndërsa ndërrimi A ka bashkëpunuar edhe me komandantin e stacionit Z S me udhëheqësen e ndërrimit B N, në format dhe mënyrat si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi të vërtetuara gjatë shqyrtimit.

Nga të lartpërmendurat është vërtetuar se të akuzuarit nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare me qëllim që të përfitojnë dobi pasurore për vete dhe për personat tjerë për çka me dashje nuk i kanë përcaktuar detyrat e tyre për të cilat ishin të obliguar me ligj dhe kishin bërë pranimin e parave sipas tarifave të cilat vet i kishin përcaktuar, e të cilat pa dyshim që ishin të kundërligjshme.

Andaj, në veprimet e të akuzuarëve **të cekur dhe të përshkruara në pikën I, II, III të pjesës gjykuese të aktgjykimit**, gjykata ka ardhur në përfundim se formohen elementet e veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së.

8. Gjetjet e gjykatës në raport me aktgjykimin për pikën IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit pjesa Liruese B.

Gjykata ka vlerësuar më shumë kujdes të gjitha provat që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerëson një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, ashtu që konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së gjeti se nuk është provuar-vërtetuar se të akuzuarit në pikën IV të aktgjykimit dhe atë të akuzuarit: O K, D S, D K dhe në pikën V të aktgjykimit dhe atë të akuzuarit: Z R, B T dhe L V, të kenë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar. Prandaj gjykata në vijim për pikën IV dhe V të aktgjykimit, do t'i elaborojë faktet dhe rrethanat se pse nuk është vërtetuar se të akuzuarit e lartpërmendur nuk e kanë kryer veprën penale për të cilën edhe janë liruar si në pikat e lartpërmendura të aktgjykimit.

Fillimisht gjykata në këtë çështje penale do ti sqaroj faktet e pa-kontestueshme që i ka vërtetuar edhe në raport me të akuzuarit e lartpërmendur, ashtu që si fakt i pa kontestueshëm, do të elaborohen si në vijim:

- Fakt i pakontestueshëm ishte të të akuzuarve në pikën IV dhe V të aktgjykimit i'u takon po ashtu cilësia e personit zyrtar që është përcaktuar me nenin 120 par.1 dhe par.2 nënpar.2.1 të KPRK-së, për shkak se në kohën për të cilin janë shpallur fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit, të akuzuarit ishin Zyrtarë Policorë pranë Stacionit Policor për Mbikqyrje Kufitare në Zubin Potok.
- Të akuzuarit si në pikën IV të aktgjykimit i ushtronin këto pozita: i akuzuari O K, ishte si Udhëheqës i ndërrimit (B), ndërsa të akuzuarit D S dhe D K ishin Zyrtarë Policor Patrollues.
- Të akuzuarit si në pikën V të aktgjykimit i ushtronin këto pozita: i akuzuari Z R, ishte si Udhëheqës i ndërrimit (C), ndërsa të akuzuarit B T dhe L V, ishin Zyrtarë Policor Patrollues.
- Po ashtu nuk ka qenë kontestuse fakti se Stacioni Policor për Mbikqyrje Kufitare në Zubin Potok, ku të akuzuarit ishin Zyrtarë Policorë, kishte nën mbikëqyrje një pjesë të kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës me Republikën e Serbisë, dhe të njëjtit si detyrë kishin mbikëqyrjen e kufirit, pra ishin përgjegjës ndër të tjera edhe për parandalimin dhe zbulimin e veprimtarisë së krimit ndërkufitar dhe kontrabandave të mallrave dhe kontrabandave tjera të ndaluara me ligj, pra parandalimin dhe ndalimin e lëvizjes së mallrave dhe bagëtive ilegale përmes kufirit shtetëror.
- Gjithashtu, nuk ka qenë kontestuse se gjatë kësaj periudhe kohore Komandant stacionit në SPMK në Zubin Potok, ka qenë Z S, ndërsa nën mbikëqyrjen e tij kanë qenë tre ekipe policore (A,B,C) të cilët kanë operuar me ndërrime dhe secili prej ndërrimit ka pas udhëheqësin e ndërrimit dhe zëvendës udhëheqësin e ndërrimit. Detyrë e ekipeve policore ka qenë mbikëqyrja e brezit kufitar dhe parandalimi i kontrabandimit të mallrave dhe njerëzve. Ndërsa detyrë e udhëheqësve të ndërrimeve ka qenë përpilimi i orarit të ndërrimeve si dhe mbikëqyrja e ekipit në terren duke iu dhënë udhëzime për vendosjen e pikave të kontrollit ose ndryshimin e tyre sipas nevojës.

Sipas aktakuzës, në pikën III dhe V të saj që në aktgjykim janë përcaktuar si pikat IV dhe V si veprime inkriminuese për të akuzuarit O K, D S, D K, Z R, B T dhe L V ngarkohen se: “*në cilësinë e personave i zyrtar, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me dashje nuk kanë kryer detyrat të përcaktuar me ligj dhe nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare të tyre me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër në atë mënyrë që....., kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare dhe autorizimet duke lejuar dhe mundësuar kontrabandimin e mallrave të ndryshëm si kafshë, derivate, pije alkoolike dhe joalkoolike dhe mallra ushqimor nga Serbia për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, nëpërmjet rrugëve ilegale derisa kanë qenë në detyrë zyrtare duke mbikëqyrë rrugët e brezit kufitar, ashtu që ju kanë mundësuar përfitimin pasuror të kundërligjshëm të pandehurve D I, Boban Radojković, D D , M R, M R, Z*

Vdhe persona të tjerë si transportues të mallrave, duke i'u shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit të mallrave, me çrast i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovë.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor më asnjë provë nuk është vërtetuar se të akuzuarit duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtarë me dashje nuk kanë kryer detyrat e përcaktuara me ligj dhe nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete apo personat e tjerë.

Pa dyshim që nuk ka qenë kontestuese fakti se të akuzuarit në pikën IV dhe V të aktgjykimit, kanë punuar në të njëjtin Stacion Policor përkatësisht në SPMK Zubin Potok, mirëpo me asnjë provë nuk është vërtetuar se të njëjtit në bashkëkryerje të kenë vepruar më të akuzuarit e tjerë që të ndërmarrin ndonjë veprim konkret të jashtëligjshëm duke mos kryer detyrën zyrtare me qëllim për të përfituar për vete apo për çfarëdo dobie për personat e tjerë, pra duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tyre zyrtarë. Pra për të ekzistuar kjo formë e bashkëpunimit duhet të plotësohen elementi objektiv, pra që si bashkëkryerës të jetë personi i cili së bashku me të tjerët ndërmerr veprimin e kryerjes së veprës penale të caktuar, si dhe elementi subjektiv pra si bashkëkryerës të jetë personi i cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale e ka dëshiruar pasojën dhe veprën penale e konsideron si të veten, e që në rastin konkret këto rrethana më asnjë provë nuk janë vërtetuar.

8.1 Lidhur me të akuzuarin O K, nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se i njëjti me dashje nuk kishte kryer detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj me qëllim që të përfitojë për vete apo për personin tjetër çfarëdo dobie pasurore.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit D1 dhe F2, por edhe dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues B M, të cilët në asnjë rrethanë nuk e kanë përmendur të akuzuarin O K, për ndonjë veprim lidhur me kontrabandën që ishte zhvilluar në këtë zonë.

Po ashtu, provat materiale përkatësisht transkriptet e bisedave të cilat ishin nxjerrë në bazën në SPMK në Zubin Potok dhe në veturat (defender 141-02 dhe defender 1340-02), të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor në raport me të akuzuarit e tjerë, mirëpo në raport me të akuzuarin O K, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate me numër PS.nr., 23/20 të datës 20.08.2020, janë shpallur si prova të pa pranueshme, pra nuk ka pasur ndonjë provë tjetër të cilën gjykata e ka administruar nga e cila do të vërtetohej përgjegjësia e të akuzuarit, pra nuk ka pasur ndonjë provë e cila e ndërlidh të akuzuarin në raport me veprimet për të cilat ishte ngarkuar me aktakuzë.

Prandaj edhe gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, se bashku më të akuzuarit e tjerë të cilët gjykata i ka shpallur fajtor.

8.2 Lidhur me të akuzuarin D S, nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se i njëjti me dashje nuk kishte kryer detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj me qëllim që të përfitojë për vete apo për personin tjetër çfarëdo dobie pasurore.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit D1 dhe F2, por edhe dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues B M, të cilët në asnjë rrethanë nuk e kanë përmendur të akuzuarin D S, për ndonjë veprim lidhur me kontrabandën që ishte zhvilluar në këtë zonë.

Gjykata në raport me të akuzuarin D S, ka vlerësuar edhe tri transkriptet e bisedave të datës 17.02.2019, ora 19:33:38, 20:36:19 dhe datës 13.03.2019 ora 20:09:24, të cilat biseda janë komunikime midis Z B, R M dhe J D, ku në dy bisedat e para të datës 17.02.2019, sipas vet transkriptit dyshohej se paratë prej 80 €uro të cilat ishin ndarë nga 20 €uro, ishin marrë edhe për D S, por edhe nga transkripti i datës 13.03.2019, lidhur me bisedën që ishte zhvilluar në mes të A P, B M dhe J D, dyshohej se paratë që ishin marrë nga të njëjtit nga 10 €uro ishin ndarë edhe për D S. Pra nga transkriptet e lartpërmendura nuk është vërtetuar se i njëjti të jetë përfshire drejtpërdrejt në veprimet që kishin ndërmarrë Z B, R M, J D dhe A P por nga transkriptet vetëm ishte konstatuar se paratë e marra nga të akuzuarit e tjerë dyshohej se ishin marrë edhe për të akuzuarin D S. Andaj dukë marrë për bazë faktin se në asnjë bisedë të transkriptave nuk ishte përfshirë drejtpërdrejt i akuzuari D S, dhe nga transkriptet e lartpërmendura të bisedave vetëm konstatohet se dyshohej se paratë ishin marrë për të njëjtin, gjykata konsideron se nuk është vërtetuar se i njëjti të ketë kryer veprën penale dhe se pretendimet e PSRK-së kanë mbetur vetëm në nivelin e dyshimit dhe jo në nivelin përtej dyshimit të bazuar mirë si standard për të cilin edhe të akuzuarit mund të shpallen fajtor nëse vërtetohet me prova konkrete dhe të drejtpërdrejta. Prandaj edhe gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, se bashku me të akuzuarit e tjerë të cilët gjykata i ka shpallur fajtor.

8.3 Gjithashtu në raport më të akuzuarin D K, nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se i njëjti me dashje nuk kishte kryer detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj me qëllim që të përfitojë për vete apo për personin tjetër çfarëdo dobie pasurore.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit D1 dhe dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues B M, të cilët në asnjë rrethanë nuk e kanë përmendur të akuzuarin D K, për ndonjë veprim lidhur me kontrabandën që ishte zhvilluar në këtë zonë.

Gjithashtu gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit F2, i cili ka deklaruar se: *“për D K, kishte njohuri se ka poseduar një lokal i cili ishte afër një pompe të vogël të benzinës, e cila i ka pasur kamerat e vendosura brenda dhe jashtë lokalit të cilat kanë qenë të vendosura me shikim nga pompa dhe kur e ka parë se kush ka kaluar, me vonë ka shkuar dhe i ka marrë paratë të cilat i kishin lënë kontrabanduesit, dhe ka shtuar se nuk e ka parë më sy këtë gjë por ka dëgjuar nga ndërrimet e policëve të tjerë”.*

Pra, nga vet deklarimi i këtij dëshmitari shihet se i njëjti vetëm e kishte të dëgjuar këtë rrethanë e jo të parë nga ai drejtpërdrejt, ashtu që për këtë rrethanë gjykata ka dëgjuar edhe dëshmitarët e mbrojtjes, përkatësisht dëshmitarin B Ja dhe dëshmitarin O B.

Dëshmitari B J ka deklaruar se: *“lokalin e mbante me qira dhe lokali nuk ishte i të akuzuarit D K, por i njëjti e kishte me qira nga O B dhe se kamerat ishin të vendosura në lokal mirëpo nuk kanë qene të lidhura askund dhe nuk kanë funksionuar, pra vetëm kanë qene kamera të rrejshme”.*

Po ashtu edhe dëshmitari O B, kishte deklaruar se lokalin ia kishte lëshuar me qira të akuzuarit Bosko Javniceviq dhe ky fakt është vërtetuar edhe nga kontrata për dhënie me qira të lokalit afarist e datës 12.06.2012, e cila ishte lidhur në mes të O B nga Zubin Potoku dhe B J nga Mitrovica e Veriut.

Pra nga të lartpërmendurat gjykata nuk mund të marrë besueshme deklarimin e dëshmitarit F1, se i akuzuari D K, kishte lokalin i tij për shkak se kjo është në kundërshtim me dy deklaratat e

dëshmitarëve të lartpërmendur por edhe me kontratën mbi qiranë, dhe po ashtu gjykata nuk ka mundur të vërtetojë faktin se kishte ndonjë incizim nga kamerat e lokalit që i përmend ky dëshmitar, prandaj gjykata mbi bazën e këtij deklarami nuk mundi të marr të besueshme se i njëjti pas shikimit të videove kishte shkuar që të marr paratë nga kontrabanduesit për shkak se nuk kishte ndonjë video incizim konkret e për më tepër që ishte vet dëshmitari Boosko Javniceviq kishte theksuar se këto kamera nuk ishin funksionale, prandaj edhe gjykata deklaramin e dëshmitarit F1 në këtë pjesë e mori si jo të besueshme dhe në rastin konkret gjykata ka ardhur në përfundim mbi bazën e kësaj deklarate të akuzuarit D K, nuk mund të shpallet fajtor për veprën penale që është ngarkuar me aktakuzë.

Gjithashtu, vlen të theksohet se, provat materiale përkatësisht transkriptet e bisedave të cilat ishin nxjerrë në bazën në SPMK në Zubin Potok dhe në veturat (defender 141-02 dhe defender 1340-02), të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor në raport me të akuzuarit e tjerë, edhe në raport me të akuzuarit D K, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate me numër PS.nr., 23/20 të datës 20.08.2020, janë shpallur si prova të pa pranueshme, pra nuk ka pasur ndonjë provë tjetër të cilën gjykata e ka administruar nga e cila do të vërtetohej përgjegjësia e të akuzuarit, pra nuk ka pasur ndonjë provë e cila e ndërlihd të akuzuarin në raport me veprimet për të cilat ishte ngarkuar me aktakuzë.

Prandaj edhe gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, se bashku më të akuzuarit e tjerë të cilët gjykata i ka shpallur fajtor.

8.4 Lidhur me të akuzuarin Z R, nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se i njëjti me dashje nuk kishte kryer detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj me qëllim që të përfitojë për vete apo për personin tjetër çfarëdo dobie pasurore.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit D1, i cili ka deklaruar se: *“sa i përket të akuzuarit Z R nuk kam dëgjuar asgjë, kanë qenë disa thashetheme që i njëjti ka marrë mito po për këto ai nuk ka besuar dhe nuk iu beson”*.

Po ashtu, gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit F2, i cili ka deklaruar se: *“për të akuzuarin Z R, asnjëherë nuk e kam thënë as nuk e kam parë se i njëjti ka marrë para nga kontrabanduesit dhe nuk e kam parë të këtë shpërndarë para me udhëheqësit e ndërrimeve”*.

Pra, nga dy dëshmitë e dëshmitarëve të lartpërmendur vërtetohet se i njëjti nuk kishte marrë ndonjë veprim që do të ishte në kundërshtim më detyrat e tij zyrtare, pra që me dashje të mos i ketë përmbushur detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj, pra të njëjtit nuk e kishin parë të akuzuarin të këtë bashkëpunuar me kontrabanduesit në ndonjë formë si udhëheqës i ndërrimit.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar edhe deklaramin e dëshmitarit bashkëpunues B M, i cili ka deklaruar se: *“sa i përket Z R, ka pasur raste që ka qenë në ndërrim me të dhe ka pranuar para dhe atë nga D I dhe se ato para i kanë ndarë mes vete dhe shumicën e punëve i ka kryer përmes të ndjerit K S, dhe se paratë kanë shkuar ose te K ose te B, këta dy kanë qenë që kanë marrë para si ndërrim”*.

Ky deklaram i dëshmitarit bashkëpunues, fillimisht është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarëve D1 dhe F2, pra ky deklaram është në kundërshtim me dy deklarata e dëshmitarëve të cilët kanë theksuar se nuk kanë parë dhe nuk kanë dëgjuar që i akuzuari Z R të këtë marrë para

nga kontrabanduesit. Ashtu që gjykata ka vlerësuar se deklarimi i dëshmitarit bashkëpunues nuk ndërlihet edhe me ndonjë provë tjetër të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në nenin 257 par.4 të KPP-së në të cilën përcaktohet se: *“Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues”*. Pra dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues ishte dëshmia e vetme sa i përket të akuzuarit Z R, për shkak se vlen të theksohet se provat materiale përkatësisht transkriptet e bisedave të cilat ishin nxjerrë në bazën në SPMK në Zubin Potok dhe në veturat (defender 141-02 dhe defender 1340-02), të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor në raport me të akuzuarit e tjerë, e që në raport me të akuzuarin Z R, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate me numër PS.nr.23/20 të datës 20.08.2020, janë shpallur si prova të pa pranueshme, pra nuk ka pasur ndonjë provë tjetër të cilën gjykata e ka administruar nga e cila do të vërtetohej përgjegjësia e të akuzuarit, pra nuk ka pasur ndonjë provë e cila e ndërlihet të akuzuarin në raport me veprimet për të cilat ishte ngarkuar me aktakuzë.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit V I, i cili në raport me të akuzuarin Z R, ka deklaruar se: *“nuk i kishte dhënë askujt para e as Z Rit dhe nuk e din faktin se a i është montuar ky rast Z Rit apo jo”*.

Prandaj edhe gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, se bashku më të akuzuarit e tjerë të cilët gjykata i ka shpallur fajtor.

8.5 Lidhur me të akuzuarën B T, nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se i njëjti me dashje nuk kishte kryer detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj me qëllim që të përfitojë për vete apo për personin tjetër çfarëdo dobie pasurore.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit D1 dhe F2, por edhe dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues B M, të cilët në asnjë rrethanë nuk e kanë përmendur të akuzuarën B T, për ndonjë veprim lidhur me kontrabandën që ishte zhvilluar në këtë zonë.

Po ashtu edhe nga provat materiale, gjykata ka konstatuar se e njëjta kishte punuar në bazën e SPMK në Zubin Potok, pra nuk kishte ndonjë dalje në teren, pra nuk kishte ndonjë kontakt te drejtpërdrejt me kontrabanduesit, pra nga provat materiale, gjykata nuk ka mundur të evidentoj ndonjë veprim inkriminues të cilën e kishte ndërmarrë e akuzuara gjatë ushtrimit të detyrës së saj si zyrtare policore në SPMK në Zubin Potok.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar edhe transkriptin e bisedes të datës 23.08.2019, në të cilën është komunikimi në mes të akuzuarës B T dhe të akuzuarit V T, nga e cila bisedë shihet se: *“i akuzuari V i thotë të akuzuares B se është dashur më ti dhënë edhe 10 Euro me shumë bile me u bo 50 Euro, me c’rast edhe B nuk i kishte pranuar këto para”*. Prandaj gjykata duke marrë për bazë faktin se kjo provë është provë e vetme për të akuzuarën B T, e cila provë nuk ndërlihet me ndonjë provë tjetër dhe nuk paraqet ndonjë veprim inkriminues për të akuzuarën se kishte vepruar në kundërshtim me detyrën e saj zyrtare, pra siç shihet nga përmbajtja, e njëjta nuk kishte pranuar që ti marrë paratë nga i bashkakuzuari tjetër V T, andaj duke u bazuar në nenin 257 par.1 të KPP-së në të cilën përcaktohet se: *“Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale”*. Prandaj gjykata nuk mund ti jap rëndësi vendimtare kësaj prove që

të njëjtën ta shpall fajtorë vetëm mbi bazën e kësaj prove edhe pse siç u theksua edhe më lartë e njëjta nuk paraqet ndonjë veprim inkriminues të të akuzuarës.

Prandaj edhe gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, se bashku më të akuzuarit e tjerë të cilët gjykata i ka shpallur fajtor.

8.6 Lidhur me të akuzuarin L V, nga provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se i njëjti me dashje nuk kishte kryer detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj me qëllim që të përfitojë për vete apo për personin tjetër çfarëdo dobie pasurore.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit D1 dhe F2, por edhe dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues B M, të cilët në asnjë rrethanë nuk e kanë përmendur të akuzuarin L V, për ndonjë veprim lidhur me kontrabandën që ishte zhvilluar në këtë zonë.

Po ashtu, gjykata në raport me të akuzuarin L V ka vlerësuar edhe provat materiale përkatësisht transkriptet e bisedave të cilat ishin nxjerrë në bazën në SPMK në Zubin Potok dhe në veturat (defender 141-02 dhe defender 1340-02), të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor, mirëpo në asnjërën prej këtyre bisedave nuk është përfshirë i akuzuari L V, çoftë në mënyrë të drejtpërdrejt si bisedues më të akuzuarit e tjerë apo i përmendur nga të akuzuarit tjerë për ndonjë plan për lejimin e kalimit të kontrabanduesve në mënyrë ilegale.

Prandaj edhe gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk ka kryer veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, se bashku më të akuzuarit e tjerë të cilët gjykata i ka shpallur fajtor.

Pretendimet e PSRK-së, se për të akuzuarit në pikën IV të aktgjykimit dhe atë: O K, D S dhe D K dhe në pikën V të aktgjykimit për të akuzuarit: Z R, B T dhe L V, se nga provat e administruara është vërtetuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, gjykata vlerëson se ky pretendim është i pa bazuar, për shkak se provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor nuk kanë vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se të njëjtit si zyrtarë policorë duke shfrytëzuar detyrën e tyre zyrtare apo autoritetin zyrtar me dashje kanë keqpërdorur detyrën zyrtare dhe nuk i kanë kryer detyrat e përcaktuara me ligj dhe nuk i kanë përmbushur autorizimet e tyre zyrtare me qëllim të përfutimit të çfarëdo dobie për vete ose personin tjetër, ngase provat në raport me këta të akuzuar siç janë elaboruar më lartë, nuk kanë provuar ndonjë element të veprës penale për të cilën ngarkohen, pra nuk kanë vërtetuar drejtpërdrejt veprimet inkriminuese - të kundërligjshme për të cilën janë akuzuar këta të akuzuar, por me këto prova gjykata vlerëson se vetëm është formësuar dyshimi jo i bazuar mirë, dhe të njëjtat nuk kanë vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se të njëjtit kanë kryer veprën penale, prandaj gjykata vlerëson se mëdyshjet lidhur me faktet vendimtare nuk mund të interpretohen në dëm të të akuzuarve, për shkak se kjo është në kundërshtim edhe me parimin *In Dubio Pro Reo* neni 3 par.2 të KPP-së në të cilin është përcaktuar se: “*Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës*”.

Prandaj, nga të lartpërmendurat gjykata ka ardhur në përfundim se nuk është vërtetuar se të akuzuarit në pikën IV dhe V të aktgjykimit kanë kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo

autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar.2.2 dhe 2.3 e lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së.

9. Gjetjet e gjykatës në raport me aktgjykimin për pikën VI, VII, VIII, IX dhe X të dispozitivit të aktgjykimit pjesa Refuzuse C.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 20.10.2023, para fjalës përfundimtare, prokurori i shtetit nga PSRK Burim Çerkini, ka deklaruar se është një fazë tjetër e procedurës ku kemi të bëjmë me ndryshimin apo plotësimin e aktakuzës dhe në si prokurori paraprakisht kemi dorëzuar një shkresë zyrtare në gjykatë përmes emalit, e që e njëjta ju ka shpërnda edhe avokateve mbrojtës e që ka të bëjë me ndryshimin e akuzës. Andaj deklaroj se konform nenit 348 të KPP-së në si Prokurori Speciale, duke u nisur nga rrjedhja e kësaj çështje penale dhe duke marrë parasysh rrethanat si në pjesën procedurale dhe materiale e që ka të bëjë me provat dhe rrjedhën kronologjike të këtij rasti, në bëjmë ndryshimin e aktakuzës, ashtu që pjesa që ka të bëjë me veprën penale Marrje ryshfeti në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, e që në aktakuzë është parapare në dispozitivet II, IV, VI dhe VIII janë me numra romakë, në si Prokurori tërhiqemi nga veprat penale të përcaktuara sipas pikave të akuzës për të gjithë të akuzuarit që janë akuzuar sipas këtyre pikave. Pra për pikën II lidhur me të akuzuarit: Z S, B N, M M, A M dhe A H, në pikën IV të saj që ka të bëjë me të akuzuarit: O K, R M, D S, D K, J D, Z B dhe A P, si dhe për pikën VI që ka të bëjë me të akuzuarit: Z R, R K, V T, B T, L V, B M dhe B L, të gjithë të akuzuar sipas pikave të lartpërmendura për shkak të veprës penale Marrje ryshfeti në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së.

Gjithashtu gjatë fjalës përfundimtare në të njëjtin shqyrtim prokurori i shtetit nga PSRK Burim Çerkini, ka deklaruar se për të akuzuarin N B pas vlerësimit të të gjitha provave materiale dhe jo materiale, si ato jo kontestuese por edhe ato kontestuese, dëshmime dhe deklaratave nga ana e dëshmitarëve dhe mbrojtjes së të akuzuarit e të cilat janë shtjelluar përgjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është provuar se në veprimet e të akuzuarit N B, ekzistojnë elementet e veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nën par.2.2 lidhur me par.1 dhe me nenin 81 të KPRK-së. Andaj, konform nenit 51 par.1 lidhur me nenin 262 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, në mungesë të provave tërhiqemi nga aktakuza dhe ndjekja penale për të akuzuarin N B, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në vazhdimësi nga neni 422 par.1 lidhur me par.2 nënpar. 2.2 dhe 2.3 e lidhur 81 të KPRK-së, i akuzuar në pikën VII të akuzës dhe për shkak të veprës penale Marrje ryshfeti në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, i akuzuar në pikën VIII të aktakuzës.

Duke pas parasysh se Prokurori i shtetit i PSRK-së, është tërhequr nga pikat e aktakuzës së lartpërmendura dhe nga ndjekja penale gjatë shqyrtimit gjyqësor kundër të akuzuarve të lartpërmendur, për shkak të veprave penale të lartpërmendura, Gjykata në kuptim të nenit 362 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, mori aktgjykim refuzues në këtë çështje penale të pikat VI, VII, VIII, IX dhe X të këtij aktgjykimi dhe vendosi si në dispozitivet e lartshënuara të këtij aktgjykimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitë ligjore.

10. Vendimet e trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë dhe në bazë nenit 364 par.1 dhe 2 të KPP-së, trupi gjykues ka vendosur që të akuzuarit në Pjesën Gjykuese A, në pikën I, II, III, ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre, duke i shpallur fajtor për veprën penale për të cilën janë ngarkuar me aktakuzë, ngase në veprimet e të akuzuarve të përshkruara në dispozitivin I, II, III, të pjesës gjykuese të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së.

Ndërsa, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë dhe në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, trupi gjykues ka vendosur që ti i liroi nga akuza të akuzuarit e cekur si në Pjesën Liruese B, në pikën IV dhe V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak se nuk është provuar – vërtetuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së.

Ndërsa, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë dhe në bazë të nenit 362 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, trupi gjykues ka vendosur që të refuzojë akuzën për të akuzuarit e cekur si në Pjesën Refuzuese C, të dispozitivit të këtij aktgjykimi në pikën VI, VII, VIII, për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, të cilët ishin akuzuar edhe për shkak të veprës penale: Marrje ryshfeti në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 81 të KPRK-së, gjithashtu edhe për të akuzuarit në pikën IX, X të dispozitivit të këtij aktgjykimi është refuzuar akuzuar akuza për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, për veprat penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në vazhdimësi nga neni 422 par.1 dhe par.2 nënpar.2.2 dhe 2.3 lidhur me nenin 81 të KPRK-së dhe Marrje ryshfeti në vazhdimësi nga neni 428 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

11. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve në pikën I, II, III të Pjesës Gjykuese A, me rastin e matjes së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana lehtësuese dhe rënduese.

Gjykata, gjatë vendosjes për dënimin, përveç ndaj të akuzuarit B M, për të akuzuarit tjerë në pikën I, II, III nuk gjeti ndonjë rrethanë tejet lehtësuese por si rrethana relativisht lehtësuese ndaj të akuzuarve mori për bazë këto rrethana:

- **Gjendjen materiale e akuzuarve**, ku gjendja e tyre materiale është nën mesatare, ku të akuzuarit para kryerjes së veprës - veprave penale, kishin gjendje të mesme ekonomike, ku me rastin e arrestimit të tyre është përkeqësuar edhe gjendja ekonomike e tyre;

- **Të akuzuarit janë mbajtës të familjes**, pra të njëjtin janë familjarë përkujdesën për familjen në veçanti për fëmijët e tyre.
- **Faktin se të njëjtit nuk kanë qenë të dënuar më herët për veprë penale**, në bazë të të dhënave që posedon gjykata për këta të akuzuar, por edhe të dhënave të ofruara nga organi akuzës, nuk është vërtetuar se këta të akuzuar kanë rënë ndesh me ligjin më herët, respektivisht nuk janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- **Sjellja e të akuzuarve gjatë gjykimit**, të gjithë të akuzuarit kanë pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, ku sjellja e tyre ka qenë korrekte ndaj gjykatës dhe palëve në proces gjyqësor, duke respektuar edhe rendin e procedurën në gjykatore.
- **Ndërsa të për të akuzuarin B M**, përveç rrethanave të lartpërmendura si **rrethana posaçërisht lehtësuese** gjykata ka vlerësuar rrethanat si në vijim:
- Bashkëpunimin e të akuzuarit me organet e ndjekjes penale dhe atë që në fazat e hershme hetimore, ku i njëjti në këtë rast nga ana e PSRK-së është shpallur si dëshmitar bashkëpunues, i cili edhe në gjykatë ka dëshmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, i cili ka ndihmuar në zbardhje të fakteve të së vërtetës lidhur me këtë rast.
- Pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor për veprën penale për të cilën për cilin ishte ngarkuar me akuzë dhe tani sipas këtij aktgjykimi është shpallur fajtor, të cilin pranim të fajësisë i njëjti e kishte bërë në të gjitha fazat e mëhershme të procedurës.

Si rrethana rënduese për të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë këto rrethana:

- **Shkallën e lartë të dashjes**, të akuzuarit kanë vepruar me një shkallë të lartë të dashjes duke bashkëpunuar dhe planifikuar kalimin ilegal të mallrave me kontrabanduesit, për çka siç rezultojnë edhe nga rrethanat faktike por edhe nga provat e kësaj çështje penale se qëllimi kryesor i të akuzuarave ishte përfitimi i dobisë pasurore për vete, duke lejuar kalimin e mallrave të ndryshme në mënyrë ilegale nga kontrabanduesit.
- **Të njëjtit kanë keqpërdoruar pozitën** e tyre zyrtare si zyrtar policor, duke abuzuar me pushtetin të cilin ju ishte besuar si policë për përfitime personale.
- **Faktin se të akuzuarit**, veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar e kanë kryer në vazhdimësi, pra kishe vepruar në periudha të ndryshme kohore me qëllim të realizimit të dobisë pasurore për vete.
- **Faktin se si zyrtarë i policor** ishin të thirrur të vendosin rend dhe siguri, qytetarët kanë pritur nga të njëjtit, që ta ndjekin krimin gjegjësisht kryesit e veprave penale në regjionin ku kanë shërbyer, ndërsa të njëjtit kanë vepruar në të kundërtën duke kryer vet vepra penale duke e keqpërdorë pozitën zyrtare e cila i ishte besuar, andaj jo vetëm që e ka humbur imazhin e institucionit ku kanë shërbyer në SPMK në Zubin Potok, por dhe gjithë

institucionit të Policisë së Kosovës. Pra veprimet e tyre dhe përfshirja e një grupi të oficerëve policor të njëjtit Stacion në korrupsion, kishte efekt negativ edhe për opinionin publik. Prandaj, gjykata këtë e ka vlerësuar si rrethanë rënduese.

Prandaj duke marrë për bazë të lartpërmendurat gjykata ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tyre, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

12. Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues

Duke u bazuar në nenin 62 par.1 dhe par.2 nënpar.2.3 dhe nenin 65 par.1 të KPRK-së, përveç dënimit me burgim ndaj të akuzuarve të cekur në pikën I, II, III në Pjesën Gjykyese A të aktgjykimit, iu është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit i funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej dy (2) vite, pas mbajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar si në këtë aktgjykim. Ky dënim plotësues i është shqiptuar të akuzuarve për faktin se të njëjtit kanë keqpërdorur detyrën zyrtare – ashtu që si zyrtar policor nuk kishin përmbushur detyrat e tyre zyrtare të përcaktuara me ligj, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e dënimit plotësues duke marrë për bazë dispozitat e lartpërmendura.

13. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenin 451 par.1 dhe nenin 453 të KPP-së, si dhe duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata ka vendosur që të akuzuarit në Pjesën Gjykyese A, në pikën I, II, III, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa për Pjesën Lirues B, si në pikën IV dhe V të dispozitivit të aktgjykimit, si dhe në Pjesën Refuzuese C, në pikën VI, VII, VIII, IX, X, gjykata ka vendosur që shpenzimet të bien në barrë të mjeteve buxhetore konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për pjesën Gjykyese A, konform nenit 364 par.1 dhe 2 të KPP-së, për pjesën Liruese B, konform neni 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, ndërsa për pjesën Refuzuese C, konfrom nenit 362 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI SPECIAL -
PS.nr.23/20, me datë 27.10.2023

**Bashkëpunëtori profesional,
Nazif Fetahu**

**Kryetari i trupit gjykues,
Mentor Bajraktari**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve, pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.